

Analizë për përcaktimin e

ZBRAZËTIRËS INSTITUCIONALE

në lidhje me
regjistrimin dhe përpunimin
e rasteve të gjuhës së urrejtjes në

Republikën e Maqedonisë së veriut

ANALIZË PËR PËRCAKTIMIN E ZBRAZËTIRËS INSTITUCIONALE NË LIDHJE ME REGJISTRIMIN DHE PËRPUNIMIN E RASTEVE TË GJUHËS SË URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Botues:

**Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut përfaqësuar nga kryetarja
Prof. Dr. Neda Zdraveva**

Redaktimi:

**Uranija Pirovska,
drejtoreshë ekzekutive e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut**

Autore:

prokurori publik Dr. Aleksandar Markoski

Dizajni grafik: Bojana Micevska

Shkup, 2023

**This publication was funded by the European Union. Its contents are
the sole responsibility of the Helsinki Committee for Human Rights
Skopje and do not necessarily reflect the views of the European Union.**



Funded by the
European Union



Зажакнување на националните
заштитни механизми против
говор на омрза во РС Македонија



PËRMBAJTJA

HYRJE 5

NOCIONI I GJUHËS SË URREJTJES 9

SPECIFIKA MË E RËNDËSISHME - MOTIVI 14

ELEMENTI I GJUHËS AGRESIVE 17

REAGIMET DHE AKTIVITETET E SEKTORIT JOQEVERTITAR NË VËND NË LIDHJE ME REGJISTRIMIN E AKTEVE TË GJUHËS SË URREJTJES 18

LIDHJET, KONSTELACIONET INSTITUCIONALE 25

MARnet 33

LEGJISLACIONI 37

VËSHTRIM PËR GJENDJEN ME MEDIAT NË MAQEDONI NË PRISMËN E LIGJIT PËR AGJENCINË PËR SHËRBIMET MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE DHE LIGJIT PËR MEDIAT 39

LEGJISLACIONI PENAL I VENDIT 43

LEGJISLACIONI VENDAS I KUNDËRVAJTJES 46

GJYQËSORI-AKTGJYKIMET 52

PRAKTIKA PENALE-JURIDIKE E GJYQËSORIT MAQEDONAS 54

PRAKTIKA CIVILE-JURIDIKE E GJYQËSORIT MAQEDONAS 56

**PËRGJIGJJA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE E SHTETIT: MPB,
PP, SEKTORI I PROBACIONIT 59**

**KORNIZA SISTEMORE KOMBËTARE, PROCEDURAT,
STATISTIKA 65**

**INTERNETI SI KARBURANT DHE SHKËNDIJË NË RRRITJEN E
GJUHËS SË URREJTJES DHE RËNDËSIA E BASHKËPUNIMIT
NDËRKOMBËTAR JURIDIK PËR TRAJTIMIN E VEPRAVE TË
KRYERA ONLINE 75**

**KONVENTA PËR KRIM KIBERNETIK (KOMPJUTERIK) E KËSHILLIT TË
EVROPËS 80**

**ASPEKTET KRIMINALISTIKE NË MBLEDHJEN E PROVAVE (DËSHMIVE)
PËR VEPRAT E GJUHËS SË URREJTJES TË KRYERA ONLINE 84**

SIGURIMI I PROVAVE (DËSHMIVE) NË FORMË ELEKTRONIKE 88

**SIGURIMI I PROVAVE NGA OPERATORËT E SHËRBIMEVE
TË INTERNETIT NGA SHBA-ja 96**


RUAJTJA E TË DHËNAVE 102

**MASAT DHE POLITIKAT E TJERA PËR LUFTIMIN E GJUHËS
SË URREJTJES NË INTERNET 103**

REKOMANDIME 110

BIBLIOGRAFIA 118

BURIMET ONLINE (INTERNET) 123



HYRJE

Një fjalë e bukur e josh njeriun. Përkundrazi, fjala e shëmtuar dhe për më tepër e pavërtetë ngjall shqetësim dhe konflikte. Njeriu është një qenie grupore dhe këtë e dëshmon nëpërmjet: faktit që nuk e toleron vetminë (e madje ka frikë prej saj); faktit që është më i ndjeshëm ndaj zhurmës së turmës se çdo tingulli tjetër, dhe faktit që është shumë i ndjeshëm ndaj udhëheqësit të turmës, por edhe ndaj mendimit të shokëve të tij. Edhe në rastin e asketëve dhe vetmitarëve fetarë, nuk mund të thuhet se e kanë izoluar veten në vetmi, sepse besojnë se në këtë mënyrë do të komunikojnë me një tjetër – me hyjninë e tyre. Ajo që është e lindur te njeriu, por edhe te një numër i madh i kafshëve, është sistemi i komunikimit apo i të folurit dhe ai mund të praktikohet vetëm në një grup të të njëjtit lloj.^[1]

Liria e fjalës si cilësi themelore demokratike nënkupton fjalën - në kuptimin e plotë të fjalës, por edhe lirinë e: shprehjes, shkrimit dhe publikimit. Sipas definicionit, liria është aftësia shoqërore për të vepruar, për të ecur në çdo drejtim, për t'u sjellë në përputhje me aq alternativa sa shoqëria lejon, e megjithatë për të mbetur i drejtë. Mund të thuhet se shoqëria është më e mira kur ajo ofron numrin më të madh

1. Supek, R., "Društvene predrasude: Socijalno-psihološka razmatranja", Radnička štampa, Beograd, 1973., fq.10, 31.

të alternativave.^[2] Liria kufizohet nga privimi i ndjenjave të brendshme, mungesa e dashurisë në fëmijëri dhe rini, represioni seksual ose politik dhe ndëshkimet pa bazë. Të gjithë këta faktorë pakësojnë alternativat. Edhe pse thuhet se liritë janë të lindura dhe të drejtat fitohen, pa trajtimin e duhur penal, liria rrezikohet. Dhe së pari kërcënohet liria individuale, e më pas liria shoqërore, sepse thelbi i lirisë është në tërësinë njerëzore dhe tërësinë e tij.

Një shoqëri e lirë është ajo që nuk debaton për problemin e lirisë, por lejon veprimin e fjalës së lirë.^[3] Por kjo liri mund të shpërdorohet. Më pas vjen gjuha e urrejtjes. Pas shqyrtimit të konstelacionit midis lirisë së fjalës si një e drejtë themelore e njeriut dhe kufizimeve legjislative për gjuhën e urrejtjes, është e qartë se për këto dy kategori emëruesi i përbashkët është “fjala”. Nuk bëhet fjalë për sinonime apo homonime. Këto janë sfera krejt të ndryshme që prekin në konkurrencë. E shprehur në mënyrë alegorike mund të thuhet se edhe zjarri është i gjallë sepse ka flakë “të gjalla”, por nuk do të thotë – jetë. Përkundrazi, do të thotë shkatërrim. Epo, pikërisht kështu janë vendosur gjërat mes lirisë së fjalës dhe gjuhës së urrejtjes, që në këtë rast do të barazohej me zjarrin.

Në kontekstin e Evropës Juglindore, në kriminalizimin e gjuhës së urrejtjes kanë ndikim të drejtpërdrejta: nacionalizmi, rëndësia gjeopolitike, propaganda strategjike e huaj dhe tensionimet politike. Ky është një rajon ku takohen fe dhe religjione të ndryshme, por edhe mentalitete (racionalizmi evropian kundrejt mospërfilljes mesdhetare), klima natyrore (mesdhetare kundrejt asaj kontinentale), por edhe shkenca dhe empirizmi përballë bestytive dhe mitologjisë. Gadishulli është një çelës gjeografik për tre kontinente. Është një mikrokozmos politik kompleks^[4], me politikë të paparashikueshme. Megjithatë, është kurioze që, sipas disa hulumtimeve relevante, në republikat e dala nga ish-Jugosllavia, racizmi është më pak

2. Wolfgang, M.E., “Freedom and violence”, ed.: “Violence in schools: Perspectives, Programs and Positions”, Lexington books, D.C. Heath and company, Lexington, Massachusetts, Toronto, 1975, p.35.

3. Burimi: Vujaçiq, V., „Dhuna dhe humanizmi“, Biblioteka – kritika, studime, ese -, Libri 2, Cetinje, 1975, fq.43.

4. Burimi: Janakos, S., A., „Konflikti etnik: feja, identiteti dhe politika“, Universiteti i Ohajos, 2002, fq.54.

i theksuar në krahasim me pjesën tjetër të Evropës^[5], ndërsa Kroacia^[6] konsiderohet më pak “islamofobe”.^[7] Por, për fat të keq, gjuha e urrejtjes mbulon një gamë më të gjerë të kategorive të mbrojtura, duke përfshirë përkatësinë etnike, fenë dhe përkatësinë politike. Këtu te ne, sa i përket Maqedonisë së Veriut, mjafton të themi se para disa vitesh doli lajmi se jemi “bombarduar” nga gjuha e urrejtjes.^[8]

Teorikisht, gjuha e urrejtjes është ende një zonë gri për shkak të mosmarrëveshjeve dhe polemikave rreth përkufizimit dhe fushështirjes së saj. Prandaj, në praktikë, ky term/nocion ende nuk e ka përkufizimin e vet të prerë para organizatave ndërkombëtare. Çdokush mund të jetë viktimë e krimit të gjuhës së urrejtjes, megjithëse pjesëtarët e komuniteteve pakicë janë viktimat më të shpeshta dhe më të zakonshme.^[9]

Në këtë punim do të bëhet një përpjekje për t’iu përgjigjur pyetjes komplekse të ndërtimit të një strategjie – një përgjigje sistematike ndaj parandalimit dhe sanksionimit të gjuhës së urrejtjes si në median tradicionale ashtu edhe në atë «online». Në veçanti, janë elaboruar aspektet kriminalistike «tokësore», të cilat duhet të merren parasysh gjatë ndërtimit të asaj strategjie. Por, për të krijuar një përgjigje efektive, dukuria dhe madhësia e saj duhet të njihen paraprakisht mirë. Në të kundërtën, përgjigja do të jetë e butë, e zbehtë, kurse gjuha e urrejtjes do të marrë përmasa mitike. Kjo është arsyeja pse statistikatat nevojiten si instrument.

5. <https://www.srbijadanas.com/vesti/drustvo/harvard-kaze-da-smo-najtolerantniji-narod-srbija-je-zemlja-sa-najmanje-rasizma-u-evropi-2020-06-05>

6. <https://www.islamska-zajednica.hr/naslovnica/intervju-uspjeli-smo-u-nastojanjima-da-u-hrvatskoj-ne-bude-islamofobije>

7. Islamofobia është një fenomen që është vënë në qendër të vëmendjes kohët e fundit, për shkak të përpjekjeve të kombinuara të disa vendeve të mëdha muslimane. Shih: <https://www.trtworld.com/turkey/cavusoglu-turkey-pakistan-to-develop-cooperation-in-defence-industry-43216> (23,05,2023).

8. <https://faktor.mk/bombardirani-sme-so-govor-na-omraza-nekolku-nastani-vo-zemjava-ja-zovrea-ovaa-pojava>

9. Edhe vendet më të pasura nuk janë imune ndaj trajtimit diskriminues të pakicave që kulmon me akte urrejtjeje (duke përfshirë aktet e gjuhës së urrejtjes). Për shembull, incidentet e tilla ndodhin ende kundër popullit Sami, i cili është një pakicë indigjene në Mbretërinë e Norvegjisë, e cila, nga ana tjetër, konsiderohet një vend me një nga BPP-të më të mëdha për frymë në Evropë. Shih: Minde, H., “Assimilation of the Sami – Implementation and Consequences”, Acta Borealia, Rutledge, Tromsø, 2003, pp.121-146. <http://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/08003830310002877>

Për të regjistruar dhe përpunuar gjuhën e urrejtjes, nëse kuptohet përpunimi elementar statistikor, së pari duhet të ekzistojë një realitet legjislativ i përshtatshëm dhe i favorshëm në shtet që do të autorizojë zyrtarët të regjistrojnë të dhënat që hasin duke punuar në ato institucione shtetërore që kanë autoritetin për të luftuar kundër gjuhës së urrejtjes si një fenomen. Më pas, në përputhje me aktet ligjore pozitive për punën administrative dhe arkivimin, çdo autoritet shtetëror ka për detyrë të kujdeset për këto të dhëna dhe sipas nevojës shteti t'i kanalizojë ato në një qendër të vetme. Ultima ratio nëse nënkuptohet "përpunimi" në kuptimin e veprimit dhe luftës kundër krimeve të tilla dhe nëse ekziston edhe një klimë e favorshme legjislative për këtë, në atë rast këta zyrtarë nuk duhet të qëndrojnë pasivë dhe vetëm të regjistrojnë këto raste, por duhet të veprojnë në mënyrë parandaluese ose represive në përputhje me Ligjin. Janë pikërisht këto gjëra që do të diskutohen në këtë analizë.

NOCIONI I GJUHËS SË URREJTJES

Me paragjykimet më intensive në një shoqëri bashkëkohore zakonisht duhet të përballen klasat e mesme, sepse ata janë më shpesh të frustruara që nuk i përkasin ende klasës së lartë në një shoqëri heterogjene.^[10] Lëvizjet dhe migrimet e popullsisë për arsye ekonomike kontribuojnë gjithashtu në forcimin dhe thellimin e paragjykimeve. Kështu, probabiliteti që të ndodhë një akt i gjuhës së urrejtjes varet drejtpërdrejt nga rritja e numrit të emigrantëve në numrin e përgjithshëm të popullsisë. Një faktor tjetër që nxit paragjykimet është fakti se në botë ende mbizotëron koncepti i krijimit të shteteve kombëtare, e jo koncepti i shteteve multietnike. Një faktor i rëndësishëm për rritjen e paragjykimeve është tendenca shumë e natyrshme e njerëzve për të thjeshtuar dhe përgjithësuar.

Paragjykimet janë të bazuara në stereotipe. Konkretisht, stereotipet quhen: paragjykime që lidhen me sjelljen e grupeve të njerëzve dhe kombinimi i këtyre paragjykimeve me paragjykimet e tjera.^[11] Ato janë imazhe mendore të cilëve u mungon përvoja dhe janë produkt i një mendësie të ngurtë, zakonisht të lidhur me etnocentrizmin. Stereotipet mund të jenë si pozitive ashtu edhe negative. Stereotipet negative shërbejnë për justifikimin e paragjykimeve.

Shpesh stereotipet janë produkt i ideologjive shtypëse që janë të pranishme kudo. Ato i kanë rrënjët në racizëm, homofobi, transfobi, seksizëm dhe diskriminim ndaj një individi ose grupi bazuar në moshën dhe aftësinë e kufizuar. Stereotipet janë dukuri kulturore, ndaj heqja e tyre mund të konsiderohet një luftë kulturore. Disa teoricienë i konsiderojnë

10. Rot, N., "Rasizam i etničke predrasude", Zbornik radova: "Rasizam, rase i rasne predrasude", posebna izdanja, sveska 2, Antropološko društvo Jugoslavije, Beograd, 1974, fq.109.

11. Inter Group, "Racism: What is and how to deal with it: A guide to talking about racism", Navreme Publications, vol.8, Kumanovo, 2007, fq.25.

mediat dhe institucionet arsimore si burimin kryesor të stereotipeve.^[12]
Tre gazetarë maqedonas do të thonë:

“Stereotipet janë ideale për komunikim mediatik. Të shprehurit në media kërkon shprehje të shkurtër dhe ekonomizim të gjuhës. Nga ky këndvështrim, përdorimi i një stereotipi e çliron autorin nga shprehjet e stërbushura dhe detajimet e tepërta.”^[13]

Nga ana tjetër, si partitë politike ashtu edhe autoritetet/institucionet mund të jenë gjeneratorë të stereotipeve dhe paragjytimeve, e si rrjedhim edhe emulsifikues të gjuhës së urrejtjes në debatet politike, madje edhe nëpërmjet shfaqjes dhe praktikës së ngathët të artit të “korrektësisë politike”. Nga e gjithë kjo mund të nxirret përfundimi se paragjykimet janë opinione jashtëzakonisht këmbëngulëse, kurse për zbutjen ose luftimin e tyre kërkohet një luftë e vazhdueshme dhe e qëndrueshme përmes mënyrave dhe metodave të ndryshme.

Thënë në mënyrë metaforike, fjala e shëmtuar që shqiptohet është si një fuzhnjë e lëshuar nënujore që godet objektivin. Mund të kthehet, por jo pa pasoja. Historikisht, para Luftës së Dytë Botërore gjuha e urrejtjes quhej “shpifje në grup”, kurse pas luftës fitoi emërtimin e sotëm, të cilin e mori në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përdorimi masiv filloi të zbatohet në vitet 1980. të shekullit të 20-të.

Veprat e gjuhës së urrejtjes janë një fenomen shumë kompleks shoqëror dhe kriminal dhe kanë specifika në raport me aktet e tjera. Para së gjithash, ato ndryshojnë në lidhje me motivin e kryerësit/autorit, pra sipas një elementi subjektiv që shpeshherë nuk përfaqëson një element përbërës të natyrës së veprës penale. Gjuha e urrejtjes ka dy veprime, përkatësisht: deklaratën që bëhet me të dhe performancën që shënon fillimin e diçkaje më të vështirë, më së shpeshti - një akt urrejtjeje. Gjuha e urrejtjes potencialisht shpie në krim të urrejtjes. Përdoret për të fyer një person përmes grupit të mbrojtur në të cilin ai person bën pjesë. Një fjalim i tillë në përgjithësi synon të dënojë ose dehumanizojë një individ

12. Shih: Kroli, N., „Lufta kundër stereotipeve, thashethemeve dhe diskriminimit“, Botim “16 NËNTORI dita ndërkombëtare e tolerancës: tekste të zgjedhura”, AMSHA-OSBE, Shkup, 2015, fq.37.

13. Trajanovski, ZH. dhe të tjerë., „Media, gjuha e urrejtjes dhe komunitetet e marginalizuara: udhëzues për media“, Koalicioni „Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara“, Shkup, 2013, fq.29.

ose grup ose të shprehë zemërim, urrejtje, dhunë ose përbuzje ndaj tyre. Ai përçon një mesazh inferioriteti për anëtarët e grupit përkatës.

Tashmë është thënë se nuk ka një përkufizim të pranuar botërisht të nocionit të “gjuhës së urrejtjes” në të drejtën ndërkombëtare, megjithëse Këshilli i Evropës tashmë ka ndërmarrë hapin e parë duke miratuar Rekomandimin CM/REC(2022)/16.^[14] Sipas teoricienëve, gjuha e urrejtjes përkufizohet si: “një akt komunikimi që shërben për të sulmuar grupe ose individë të caktuar në bazë të veçantisë/specificave, përkatësisë ose besimit të tyre”.^[15] Format e ndryshme të sulmit mund të përfshijnë nënçmimin, talljen, përçmimin, poshtërimin, deri në format më të ashpra si diskriminimi, dehumanizimi dhe satanizimi”.^[16]

Veprat penale të gjuhës së urrejtjes kanë për qëllim diskriminimin. Ato janë më së shumti akte dhune verbale ndaj individëve ose grupeve.^[17] Për të kryer identifikimin e saktë të këtyre akteve, gjatë identifikimit të sjelljeve të veçanta të dhunshme, duhet t'i kushtohet vëmendje karakteristikave të grupit si viktimë, si dhe veçorive që e dallojnë viktimën: të drejtat kolektive, veçoritë specifike. veçoritë natyrore ose

14. Shih nenin 1 paragrafi 2: Për qëllimet e këtij rekomandimi, gjuha e urrejtjes kuptohet si çdo lloj shprehjeje që nxit, promovon, përhap ose justifikon dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash ose që denigron, për shkak të karakteristikave ose statusit personal real ose të atribuar, të tilla si “raca”, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, moshë, paaftësia, seksi, identiteti gjinor dhe orientimi seksual.” E disponueshme në: https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-cm-rec-2022-16-1-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-combating-hate-speech (25,05,2023).

15. Sipas përkufizimeve më të gjera, gjuha e urrejtjes është komunikim verbal ose me shkrim ose formë tjetër e shprehjes publike të një qëndrimi në çfarëdo forme komunikimi (me veprime përfundimtare, gjeste, përdorim simbolesh etj.) me të tjerët që përmban një qëllim, bazuar në paragjykime, që: diskriminon, ngacmon, provokon një reagim ose nxit një qëndrim negativ, intolerancë, armiqësi ose dhunë ndaj individëve ose grupeve të njerëzve, bazuar në racën ose gjininë, moshën, përkatësinë etnike, kombësinë, besimin fetar, orientimin seksual, identitetin gjinor, aftësia e kufizuar, kombësia gjuhësore, prejardhja kulturore, pikëpamjet morale ose politike, statusi shoqëror, profesioni, karakteristikat mendore dhe fizike, ose çdo karakteristikë tjetër. Shih: Kambovski, V./Trajkovska, L., M., „Analizë juridike e konceptit të krimit të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes“, OSBE, Shkup, 2012. fq.37.

16. Cit. Xhigal, S., „Karakteristikat e gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale“, „16 Nëntori, Dita Ndërkombëtare e Tolerancës: tekste të zgjedhura“, AMSHA-OSBE, Shkup, 2015, fq.17.

17. Për sa i përket gjuhës së urrejtjes, më i përhapuri është fjalimi fyes ndaj romëve, i cili ndonjëherë maskohet duke thënë aforizma për “ciganët”. Të tilla dukuri sot në shkencat shoqërore njihen si anti-ciganizëm. Shih: <https://en.in-ius.cz/news/overwhelmed-by-anti-gypsism.html>. (10.09.2020).

të imagjinuara dhe etj. Në nenet e veçanta të Kodit Penal që përmbajnë inkriminime që përfshihen në korpusin e akteve të gjuhës së urrejtjes (ose të ashtuquajturat “të drejta” ose akte “të veçanta”), këto tipare të viktimës janë nxjerrë kryesisht nga Ligji ekzistues për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Më të zakonshmet në media janë format e teksteve të gjeneralizimit të rremë - kur nxirren përfundime që vlejné për një grup njerëzish ose kur një pjesë paraqitet në mënyrë të rreme si një e tërë.^[18] Ekspertët e vërtetë të gjuhës pas shumë vitesh praktikë mund të perceptojné ideologjinë reale që ka një person, dhe kjo përmes interpretimit të shenjave të ndryshme tekstuale ose kontekstuale, si: intonacioni, strukturat specifike sintaksore, gjestet, kuptimi i fjalëve në një kontekst tjetër ose shprehjet e fytyrës.

Motivi i kryerjes së veprës është i lidhur ngushtë me përcaktimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese – pa përcaktimin e motivit do të ishte e pamundur të zbatohet parimi i individualizimit të dënimit. Së fundi, përcaktimi i motivit është i nevojshëm edhe për vendosjen e saktë të cilësimit juridik të veprës,^[19] por është e rëndësishme për lëndën e punimit që motivet e akteve të gjuhës së urrejtjes t'i përkasin motiveve politike të motivimeve të ulëta, edhe pse ndonjëherë autorët gabohen për shkak të ideologjisë së tyre se motivet e tyre janë të një motivi fisnik, si për shembull kur dikush vepron në mbrojtje të grupit të vet etnik dhe dënon një grup tjetër etnik në mënyrë transgjenerative - për ngjarje nga historia e largët ose e afërt.

Si një problem real është edhe mosgatishmëria e viktimave të akteve të gjuhës së urrejtjes për t'i denoncuar aktet tek organet kompetente dhe rrjedhimisht nga kjo del edhe “numri i zi” i lartë i këtyre veprave penale. Shoqëria duhet të jetë në gjendje si një sensor të sinjalizojë siç duhet gjuhën e urrejtjes, duke e parandaluar atë të zhvendosë natyrën e vërtetë të diskursit. Shpërfillja nuk është asnjëherë një distancë e sigurt nga sulmi fizik që mund të pasojë. Lufta kundër gjuhës së urrejtjes duhet të bazohet në një qasje me tre drejtime: zhvillimi i politikave

18. Trajanovski, ZH. dhe të tjerë., Op. cit., fq.71.

19. Motivët klasifikohen në disa baza, kështu që para së gjithash janë: motive të forta dhe të lëkundura; motive me autonomi të plotë të vullnetit; dhe motivet e vullnetit vartës. Burimi: Dageľ, P., S./Kotov, D., P., „Суб’ективна́я сторо́на преступле́ния и ee устано́вlenie“, Izdateľstvo Voronežskogo universiteta, Voronež, 1974, fq.197.

pozitive; mbrojtja përmes ligjeve/procedurave administrative dhe civile dhe parashikimi i sanksioneve penale. Secila prej tyre është një hallkë e domosdoshme në përpjekjet e shoqërisë për të trajtuar gjuhën e urrejtjes dhe për të mbrojtur pluralizmin dhe diversitetin. Roli pozitiv i shtetit në krijimin e një ambienti mbështetës për pluralizmin dhe diversitetin është po aq i domosdoshëm sa edhe qasja e tij sanksionuese apo ndëshkuese. Gjithashtu, jo të gjitha llojet e shprehjeve brenda aspektit të “gjuhës së urrejtjes” kërkojnë zbatimin e dispozitave të ligjit penal. E gjithë kjo mund të çojë në kufizime tepër të gjera dhe të panevojshme në shprehje të tilla si: komente dhe debate politike, mosmarrëveshje fetare, komente ose kritika, si dhe shprehje artistike.^[20]

20. Mihajlova, E./Baçovska, J./Sheqerxhiev, T., „Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes“, OSBE, Shkup, 2013, fq.46.

SPECIFIKA MË E RËNDËSISHME – MOTIVI

Sipas ligjit, përgjegjësia subjektive ose faji mund të marrë formën e qëllimit ose të pakujdesisë. Veprat e gjuhës së urrejtjes janë veprime të paramenduara.

Si nënloj i përgjegjësive penale që rrjedh nga veprat kriminale të kryera me dashje janë veprat kriminale të kryera përmes mjeteve të komunikimit masiv (edhe pse shumica e teoricienëve i vendosin ato në një “rast të veçantë të përgjegjësive penale”,^[21] kurse disa i afrojnë ato me kampusin e veprave të kryera nga pakujdesia). Shkenca thotë se, teorikisht, përgjegjësia penale për veprat e kryera përmes mediave mund të jetë një përgjegjësi e varur nëse brenda atij mediumi kanë vepruar disa persona, si: pronari, redaktori, autori, botuesi ose printuesi, importuesi ose distributori i produkteve mediatike. Por kur tashmë ka kaq shumë protagonistë, të gjithë të ndërthurur profesionalisht me njohuritë e mëparshme të fushës së tyre, atëherë të paktën qëllimi i mundshëm duhet të jetë i rëndësishëm në veprimet e tyre dhe jo neglizhenca si një formë e fajit. Përndryshe, në vendin tonë nuk pranohet parimi i përgjegjësive kaskadë,^[22] që është shembull në disa legjislacione të huaja. Në rastin tonë, bëhet fjalë për aplikimin e “parimit të përgjegjësive subsidiare, por gjithsesi - subjektive”.^[23]

Qëllimi (sidomosai i drejtpërdrejtë) dhe urrejtja janë dukuri plotësuese. Aq më tepër, urrejtja zakonisht zien për një kohë të gjatë, kështu që krijon paramendim për të kryer një krim/vepër penale, planifikimin e saj të gjatë dhe të kujdesshëm. Urrejtja, nga ana tjetër, konsiderohet të jetë një organizim i qëndrueshëm i impulseve agresive kundër një personi ose një klase personash. Meqenëse urrejtja përbëhet nga ndjenjat ekzistuese të

21. Shih Marjanoviç, Kambovski, Buxhakoski.

22. Shih: neni 26, neni 27 dhe neni 27-a i KP.

23. Citim: Bavcon, Lj. - Šelih, A., “Kazensko pravo - splošni del”, Ljubljana, 1978, fq.245.>Marjanoviç, GJ., „E drejta penale maqedonase - pjesa e përgjithshme“, botimi i 5-të, Prosvetno Delo, 1998, Shkup, fq.197.

hidhura dhe mendimet e fajit, ajo është një strukturë kokëfortë në jetën mendore dhe emocionale të një individi. Në vetë natyrën e saj, urrejtja është ekstropunitive, që do të thotë se individi beson se faji për urrejtjen e tij është mbi objektin e urrejtjes së tij.^[24]

Ekzekutimi apo kryerja e veprës penale fillimisht fillon në procesin mendor, dhe perfeksionohet nga një veprim fizik që manifestohet në botën e jashtme. Në rastin e akteve të gjuhës së urrejtjes ky veprim është i natyrës verbale. Ligji përcakton që përgjegjësia penale të kushtëzohet nga një kuantitet/vlerë e caktuar e ndërgjegjes dhe vullnetit. Në fakt, përgjegjësia penale ekzistuese nënkupton përputhshmërinë e veprës penale dhe të fajit. Motivi vjen edhe nga faji. Motivi është ajo forcë e brendshme, njohuritë e së cilës kontribuojnë në shpjegimin se pse është ndërmarrë një veprim i caktuar dhe çfarë ka dashur të arrijë kryesi me atë veprim. Një motiv përkufizohet si një motivim/nxitje drejt një sjelljeje të caktuar.^[25]

Në praktikë, janë të rralla rastet që motivi të sqarohet përmes miratimit të aktvendimeve gjyqësore. Për zbardhjen e motivit është e nevojshme të merren parasysh rrethanat që i kanë paraprirë kryerjes së veprës penale, rrethanat e krijuara pas kryerjes së saj dhe të merret parasysh karakteri i autorit. Së fundi, duhet të merret parasysh mënyra e kryerjes së veprës penale dhe vetë lloji i veprës penale.^[26]

Në praktikën e operacioneve policore, gjatë hetimit të një ngjarjeje, ka të dhëna të shumta dhe për çdo pistë krijohen versione të shumta të ngjarjes. Versionet (hipotezat) si supozime të arsyetuara nuk janë procese, por aktivitete para-procesore. Ndërtimi i provave përfundon kur do të eliminoheshin të gjitha versionet, përveç njërit, i cili do të përthihej në aktakuzë dhe së fundi në aktgjykim.

24. Allport, "The Nature of Prejudice" fq.363, Burimi: Jacobs B. J./Potter, K., "Hate Crimes, Criminal Law & Identity Politics", Oxford University Press, Oxford, 1998, fq.12.

25. Karanović, M., "Utvrđivanje vinosti u krivičnom postupku", Privredna štampa, Beograd, 1982.fq.49.

26. Kriminalistika mëson se pa zbuluar motivin e një vepre penale të kryer, nuk është e mundur të zbulohet plotësisht e vërteta objektive. Por në kërkim të pyetjes "pse", nuk duhet harruar motivet patologjike, si në rastet e kleptomanëve apo piromanëve. Shih: Vodinelić, V, "Kriminalistika – udbenik za operativne radnike sluzbi JB I DB, vojnu policiju, javne tuzioce, istražne I raspravne sudije, advokate i druge pravnike, student pravnih fakulteta i aktiviste DSZ, šesto izmenjeno I prošireno izdanje, Naučna knjiga, Beograd, 1987, fq.33.

Në lidhje me ndarjen kriminale në bazë të mënyrës se si mund të kuptohet përgatitja apo ekzistimi i veprave penale, aktet e gjuhës së urrejtjes i përkasin grupit të parë – vepra penale të dukshme, me pasoja të dukshme (nëse përjashtohet bullizmi perfid me eufemizëm).

ELEMENTI I GJUHËS AGRESIVE

Agresiviteti i njeriut mund të jetë psikologjik dhe fizik. Agresioni fizik ka për qëllim integritetin fizik dhe trupor të personit kundër të cilit është drejtuar agresioni. Agresioni mendor, i cili është gjithashtu tipar i gjuhës së urrejtjes, zakonisht realizohet përmes kërcënimeve (vis moralis). Kërcënimi është detyrim/shtrëngim psikologjik. Duke pasur parasysh se agresioni është karakteristikë (karakteristikë instinktive e një personi, paaftësia e një personi për të kontrolluar impulsin e tij), ai e shndërron sjelljen e tij tek një person në të rrezikshme, kriminale dhe të papranueshme. Pra, njeriu është aq i qytetëruar aq sa është në gjendje të kontrollojë impulset e tij dhe në atë mënyrë agresionin që manifestohet pothuajse në të gjitha marrëdhëniet e jetës.

Agresioni shpesh paraprihet nga zhgënjimi/frustrimi. Nga ana tjetër, zhgënjimi interpretohet si privime të ndryshme, shterpësi, shqetësime apo inferioritet ndaj të cilave ekspozohet një individ apo një grup shoqëror gjatë jetës, nga fëmijëria deri në moshën madhore.^[27] Frustrimi mund të jetë gjithashtu i pavetëdijshëm. Mund të marrë formën e frikës dhe depresionit apo ankthit, por edhe ndjenja aktive të zemërimit dhe urrejtjes,^[28] por atëherë nevojitet edhe elementi i jashtëm i një personi apo grupi personash. Më pas zhgënjimi/frustrimi shndërrohet në agresion.^[29] Sipas disa mjekëve, agresioni mund të shkaktohet edhe nga zhgënjimi i impotencës intelektuale.^[30]

27. <https://en.wikipedia.org/wiki/Frustration>

28. Kjo shprehje do të kishte sinonimin e vet të ndërkombëtarizuar në shprehjen “inat” (urrejtje, zili e përkëdhelur prej kohësh).

29. Supek, Op. cit. fq.214.

30. <http://kapital.mk/intelektualnata-nemok-ja-aktivira-agresijata/>

REAGIME DHE AKTIVITETE TË SEKTORIT JOQEVERITAR NË VENDIN TONË NË LIDHJE ME REGJISTRIMIN E AKTEVE TË GJUHËS SË URREJTJES

Ligji i parë për shoqatat dhe fondacionet e qytetarëve është miratuar në vitin 1998.^[31] Ligji i fundit është miratuar në vitin 2010. Aktualisht, rreth 600 nga gjithsej 2800 organizata joqeveritare të regjistruara, konsiderohen të jenë aktive në vend. Në nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit parashikohej se themelimi i një organizate është i ndaluar nëse programi dhe veprimet e tij kanë për qëllim “nxitjen dhe thirrjen e agresionit ushtarak dhe nxitjes së urrejtjes ose intolerancës kombëtare, racore ose fetare...” Në vitin 2022 janë bërë ndryshime në ligj, kështu që paragrafi 2 i nenit 4,^[32] është ndryshuar (zgjeruar), dhe nenit 8 është shtuar një paragrafi i ri 4, me të cilin shoqatat e qytetarëve nuk mund të përdorin emrat, mbiemrat, shkurtesat, pseudonimet e tyre, titullin dhe inicialet e njerëzve që në çfarëdo baze ishin ose janë të lidhur me intolerancë racore, fetare, kombëtare, etnike dhe të tjera, intolerancë, urrejtje, gjenocid, shfarosje, përhapje ose mbështetje të fashizmit, nazizmit, nacionalsocializmit dhe Rajhut të Tretë.^[33] Me rëndësi është edhe neni 65, i cili përcakton se organizata do të ndalohet nëse veprimi i saj ka për qëllim “nxitje dhe thirrje

31. “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 31/98 e datës 02.07.1998.

32. “Ndalohet regjistrimi i organizatës dhe themelimi i organizatës nëse titulli, emri, emri i shkurtuar, programi, qëllimet, aktivitetet dhe veprimi i saj kanë për qëllim rrënimin e dhunshëm të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, nxitje dhe thirrje ushtarake, agresioni dhe nxitja e urrejtjes kombëtare, racore, fetare ose intolerancës tjetër, intolerancës, urrejtjes, gjenocidit, shfarosjes, përhapjes ose mbështetjes, nxitjes dhe miratimit të fashizmit, nazizmit, nacionalsocializmit dhe Rajhut të Tretë, ndërmarrjen e aktiviteteve që lidhen me terrorizmin, ndërmarrjen e aktiviteteve që janë në kundërshtim me Kushtetutën ose ligjin dhe ndërmarrjen e veprimtarive që cenojnë liritë dhe të drejtat e personave të tjerë.”

33. <https://m.mkd.mk/node/478350>

të agresionit ushtarak dhe nxitjes së urrejtjes ose intolerancës kombëtare, racore ose fetare” (shih nenin 65 paragrafi 1 pika 2). Me ndryshimet në vitin 2022, paragrafit 1 të këtij neni u fut një paragrafi i ri 6, kështu që tani ndalohet nëse “titulli, emri, emri i shkurtuar, programi, qëllimet, aktivitetet shkaktojnë intolerancë racore, fetare, kombëtare, etnike dhe të tjera. , intolerancës, urrejtjes, gjenocidit, shfarosjes, përhapjes ose mbështetjes së fashizmit, nazizmit, nacionalsocializmit dhe të Rajhut të Tretë.”

Disa prej këtyre organizatave joqeveritare gjithashtu merren me çështjen e zbulimit dhe luftimit të gjuhës së urrejtjes (por ato gjithashtu merren në parim me “edukimin mediatik në mesin e popullatës”).^[34] Në vitin 2022, në “Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut”^[35] (në tekstin e mëtejshëm: KMH) janë regjistruar gjithsej 145 raste të raportuara në lidhje me gjuhën e urrejtjes.^[36] Incidentet janë publikuar në portalin e internetit www.govornaomraza.mk.

Fondacioni për internet dhe shoqëri „Metamorphosis“ është tashmë një organizatë e themeluar dhe aktive.^[37] Në vitin 2018, ata publikuan një “Raport preliminar”^[38] i cili jep një pasqyrë të situatës në lidhje me kornizën ligjore dhe masat për luftimin e gjuhës së urrejtjes në Maqedoni në periudhën e kaluar dhe aktuale, përfundimisht me datën 31 dhjetor 2017.^[39] Disa nga rekomandimet e “Metamorfozës” ishin: Qeveria, në bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve, partitë politike, organizatat fetare, mediat dhe AMSHA-ën, të përgatisë një strategji afatgjatë për të luftuar gjuhën e urrejtjes (përfshi gjuhën e urrejtjes në internet); të ndërmerren masa specifike për rritjen e ndërgjegjësimit, përmes fushatave publike, për dëmet e gjuhës së urrejtjes dhe mekanizmave ekzistues për mbrojtjen nga

34. Shih doracakun: https://metamorphosis.org.mk/izdaniya_arhiva/so-kritichko-mislenje-dorazoblichuvanje-na-dezinformacii/

35. Në dhjetor të vitit 2018, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë filloi zbatimin e projektit “Monitorimi i gjuhës së urrejtjes në nivel lokal” i financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni. Kohëzgjatja e projektit ishte 12 muaj.

36. <https://mhc.org.mk/reports/vkupno-registrirani-prijavi-na-govor-na-omraza-vo-2022-godina/>

37. <https://fosm.mk/25-godini-temi/informacii/>

38. I disponueshëm në: <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2018/04/1.3-Preliminaren-izveshtaj-govor-na-omraza.pdf>

39. Ky raport ishte pjesë e një raporti më të gjerë mbi gjendjen e lirisë në internet, me fokus lirinë e shprehjes, privatësinë dhe sigurinë në botën dixhitale, si pjesë e projektit “Liria në internet” të zbatuar nga Fondacioni Metamorfozis në kuadër të projektit rajonal “Liria e Internetit në Evropën Lindore dhe Euroazi” të Shoqatës së Avokatëve Amerikanë (ABA ROLY).

gjuha e urrejtjes dhe të përgatitet një rishikim vjetor i të gjitha rasteve të gjuhës së urrejtjes që janë regjistruar nga Qeveria, Ministria e Brendshme, prokuroritë publike, gjykatat, Avokati i Popullit, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi, MARnet, Shoqata e Gazetarëve në Maqedoni, Këshillimi Etikës në Media në Maqedoni dhe Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Ai propozoi gjithashtu ndryshime specifike të Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. “Metamorfozis” ka propozuar edhe ndryshimin e Ligjit për Tubimet Publike me qëllim që të ndalohet thirrja dhe nxitja e dhunës apo nxitja e urrejtjes në të gjitha bazat. Gjithashtu kujton nevojën e domosdoshme për trajnimin e zyrtarëve dhe nëpunësve në institucionet kompetente për gjuhën e urrejtjes.

Nga organizatat e tjera joqeveritare në Maqedoni, interesante ishin edhe thirrjet e “Civil” për sanksionimin e gjuhës së urrejtjes,^[40] raportet mujore të “Nexus Civil Concept” për zbulimin e dezinformatave, gjuhës së urrejtjes në media dhe lajmeve të rreme, që është projekt i mbështetur nga Bashkimi Evropian,^[41] më tej: reagimi i “Këshilli Rinor Kombëtar” i Maqedonisë ndaj përmbledhjes me poezi nga projekti “Poetët e rinj” në vitin 2018, si dhe nisma e organizatës joqeveritare nga viti 2016 “Bëj tifo pa urrejtje”.^[42] Por më i rëndësishmi është roli i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Maqedonisë së Veriut dhe faqja e tyre e internetit e përmendur tashmë - www.govornaomraza.mk, e cila është e një rëndësie vendimtare, sepse deri vonë ishte instrumenti i vetëm për regjistrimin e ndonjë tendence statistikore për gjuhën e urrejtjes që ata publikojnë si pjesë e “[raporteve vjetore](#)”^[43] të tyre, si dhe në “raportet vjetore për krimet e urrejtjes” të OSBE-së - Misioni në Shkup. Bazuar në këto rezultate të tyre, mund të nxirren përfundime për shkallën dhe shtrirjen e gjuhës së urrejtjes, e cila në vendin tonë kishte tendencë rritjeje.

40. <https://www.webohid.com/civil-navivackite-grupi-da-ne-koristat-govor-na-omraza-ili-nasilstvo/>

41. <https://nexus.org.mk/papers-2/>

42. <https://akademik.mk/navivaj-bez-omraza-proekt-za-iskorenuvane-na-govorot-na-omraza-za-vreme-na-sportskite-natprevari/>

43. <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/annual-report-on-hate-crime-2019-mkd-final-1.pdf>

Në shoqëritë multietnike, media luan një rol vendimtar kur bëhet fjalë për ndërtimin e bashkëjetesës. Qasja gazetareske me të cilën media përfaqëson grupet individuale shoqërore, mënyra se si ato përqendrohen ose përshkruajnë fenomene dhe procese negative, mund të nxisin haptazi ose në mënyrë subjektive stereotipet dhe gjuhën e urrejtjes. Prandaj, nuk duhet të anashkalohet kontributi i Asociacionit të Gazetarëve të Maqedonisë, si strumbullar i vetërregullimit të gazetarisë në vendin tonë.^[44] “Qëllimi i vetërregullimit nuk është të jetë censurues apo të imponojë autocensurë, por të vendosë dhe mbrojë parimet e gazetarisë etike, të saktë, objektive që respekton të drejtat e njeriut, duke ruajtur plotësisht lirinë e politikës editoriale, çfarë dhe si do të prezantohet nga media”.^[45] Njoftimet e tyre të rregullta dhe disa manuale të krijuara mbi gjuhën e urrejtjes në media janë të rëndësishme. Po ashtu, autori i tyre është edhe Kodi i gazetarëve të Maqedonisë nga viti 2001, ku në nenin 10 të të njëjtit thuhet: “Gazetari me vetëdije nuk duhet të krijojë apo përpunojë informacione që kërcënojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk duhet të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të inkurajojë dhunën dhe diskriminimin mbi asnjë bazë (kombëtare, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, orientimi seksual, politik...)”.^[46]

Përveç kësaj, në kuadër të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) funksionon edhe një organ i specializuar “Këshilli i Nderit”,^[47] i cili është organi më i vjetër vetërregullues i gazetarëve në Maqedoni. Detyra e tij kryesore është të kujdeset dhe të promovojë parimet etike, kriteret dhe standardet e gazetarisë profesionale dhe të përgjegjshme të shënuara në Kodin e Gazetarëve të Maqedonisë. Çdo person apo organizatë që preket nga shfaqja e gazetarisë joprofesionale dhe joetike, mund t’i drejtohet atij. Bëhet fjalë për kontroll autonom të mediave, një mekanizëm i të ashtuquajturit -vetërregullim. Duke bërë ankesë për përmbajtje joprofesionale ose jo të sakta, qytetarët së bashku me

44. “Vetërregullimi nuk do të thotë censurë dhe as vetëcensurë. Ai i referohet vendosjes së standardeve minimale për etikën, saktësinë dhe mbrojtjen e të drejtave personale me ruajtjen e plotë të lirisë editoriale për të zgjedhur temat për të cilat do të raportohet dhe opinionin që do t’i prezantohet publikut. Vetërregullimi ndihmon median t’u përgjigjet ankesave legjitime nga publiku dhe ndoshta të korigjojë gabimet.”, Cit.: „Leksiku i termave mediatik dhe gjyqësor“, fq.54, Burimi: <https://jpacademy.gov.mk/leksikon-na-makedonski-mediumski-i-pravosudni-termini/>

45. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Priracnik-za-etika.pdf>

46. <https://znm.org.mk/kodeks-na-novinarite-na-makedonija/>

47. Në kohën e RSM, ky organ u emërua “Gjykata e Nderit”.

gazetarët marrin pjesë në përpjekjet për informim të saktë, në kohë dhe profesional, i cili mbron lirinë e medias, lirinë e fjalës dhe të drejtën e publikut për të vërtetën.^[48] Procedura fillon maksimumi brenda 10 ditëve nga dita e aplikimit. Këshilli i Nderit merr vendime të vlefshme me shumicë të thjeshtë, nëse në seancë janë të pranishëm të paktën 4 anëtarë – këshilltarë. Sesioni i Këshillit të Nderit nuk është publik. Këshilli i Nderit përbëhet nga 7 anëtarë të cilët zgjidhen nga anëtarët e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë në Kuvendin Zgjedhor. Së fundmi, ky Këshill ka filluar të marrë vendime për raste të gjuhës së urrejtjes dhe këto janë të regjistruara me kujdes dhe të disponueshme online.

Së fundi, grupi “Promedia” i formuar nga: SHGM-ja, Asociacioni për Zhvillimin e Mediave ONLIMIT MEDIA, Oda Ekonomike e Maqedonisë, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punëtorëve Medial dhe Këshilli i Etikës në Mediat e Maqedonisë (KEMM) si shoqatë e shtëpive më të mëdha private mediatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut (ajo nuk përfshin RTVM-në dhe MIA-n), në vitin 2020 krijoi me sukses “Regjistrin e mediave profesionale online”.^[49] Qëllimi ishte që të prezantohen ato media online që plotësojnë kriteret e detyrueshme të KEMM-it dhe të jenë pjesë e Regjistrit të mediave profesionale online. Kriteret janë të ndara në dy pjesë, ato janë të detyrueshme^[50] dhe jo të detyrueshme. Për momentin po shqyrtohet edhe zgjerimi i kriterëve të detyrueshme me një kriter të ri – të ketë pengesë për futjen në Regjistrë nëse ka një dënim ligjërish të plotëfuqishëm dhe të detyrueshëm për personin përgjegjës për median online – Ndalim për të ushtruar profesion, veprimtari ose

48. Burimi: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Priracnik-za-etika.pdf>

49. <https://semml.mk/soopshthenija/699-www-promedia-mk>

50. Kriteret e obligueshme:

1. Duhet të kenë specifikuar një impresum të besueshëm (redaktori, redaksia), të dhënat e kontaktit dhe adresa
2. Të respektojnë Kodin e Gazetarëve, Kartën e raportimit etik për zgjedhjet dhe Statutin e SEM
3. Anëtarët të jenë media online që publikojnë rregullisht përmbajtje informative me interes publik
4. Të ketë person juridik të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ta deklarojnë pronësinë në mënyrë transparente
5. Anëtarët duhet të kenë financim transparent, në përputhje me ligjin
6. Të publikojnë vendimet e SEMM dhe të përfshihen në procesin e ndërmjetësimit
7. Të vendosin një banderolë në faqen e tyre që premtim respektimin e parimeve të Kodit (dhe vetërregullimin)
8. Tekstet e publikuara duhet të nënshkruhen nga autori, dhe nëse janë marrë nga media të tjera, kjo duhet të tregohet, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit.

detyrë në përputhje me nenin 38-b të Kodit Penal.

Synimi ishte që ky regjistër të fitojë fuqi përmes bashkëpunimit të KEMM-it me Odat Ekonomike në Maqedoni, dhe përmes odave të ndikohen kompanitë që janë anëtare të atyre odave se ku dhe në cilën faqe interneti duhet të ofrojnë mbështetje duke paguar për reklama komerciale. Tani për tani, nuk është i dukshëm asnjë rezultat i qartë i kësaj strategjie të SHGM-së dhe KEMM-it. Përndryshe, për sa i përket KEMM-it, kjo organizatë ka edhe të ashtuquajturin “Këshilli i Etikës”, por anëtarët e tij (7 në numër) delegohen drejtpërdrejt nga personat përgjegjës të shtëpive të mëdha mediatike, në ndryshim nga Këshilli i Nderit i SHGM-së ku anëtarët zgjidhen me zgjedhje të drejtpërdrejta. Këshilli i Etikës deri më tani ka reaguar më së shumti me njoftime zyrtare në lidhje me kundërshtimet ndaj konceptit dhe përmbajtjes, kryesisht, programeve televizive, dhe më rrallë për artikujt, intervistat apo raportet individuale gazetareske në të cilat mbizotëron “gjuha e urrejtjes”, edhe pse statistikat tregojnë se raste të tilla kishte një numër jo të papërfillshëm (165).^[51] Në të ardhmen, kjo mund të ndryshojë dhe ata mund të jenë proaktiv, sepse Kodi i Gazetarëve i vitit 2014 siguron burim dhe legjitimitet edhe për ta.

Ana pozitive e vetërregullimit është se ai lejon fleksibilitet dhe shfaqet në rolin e një mekanizmi mbrojtës ndaj ndërhyrjeve të mundshme të qendrave të pushtetit në përmbajtjen mediatike, ndërsa dobësia është se mbart vetëm sanksione morale dhe nuk mund të detyrojë asnjë veprim pa pëlqimin vullnetar të mediave që kanë kryer veprën penale. Në të njëjtën kohë, është mirë që të shmanget termi “bashkërregullim”, i cili në mënyrë të përafërt nënkupton regjistrimin e thjeshtë të këtyre mediave nga shteti dhe taksimin e tyre. Kjo gjë përfaqëson një teknikë dhe është cilësisht e pamjaftueshme për t’i atribuar si mëkat shtetit për ndërhyrjen në këtë segment.

Ndryshe, nga ana procedurale, procedurat e zhvilluara nga KEMM-i parashikojnë ndërmjetësimin si shkallë të parë nëse ankimi është i bazuar, ndërsa kjo procedurë parasheh edhe falje dhe korrigjim nga media, pas së cilës Komisioni i Apelit i KEMM-it e konsideron çështjen të mbyllur. Në fushën e pranimit të vendimeve të Gjykatës së Nderit apo të KEMM-it, praktika është e ngjashme sikur në shumicën e vendeve të rajonit, kështu

51. <https://complaints.semm.mk/>

që në një numër të vogël rastesh vendimet pranohen nga media dhe publikohen në mënyrë transparente. Tendenca e pranimit të vendimeve në vitet e fundit ka shënuar rritje. Shkelësit më të shpeshtë të Kodit të Gazetarëve në bazë të të cilit funksionojnë të dy organet vetërregulluese janë mediat online. Por, shqetësues është edhe fakti që shumica e rasteve i referohen mosrespektimit të detyrimit për të kërkuar burim të dytë apo palë të dytë në raportim, që është një rregull bazë në gazetari.^[52]

52. Burimi: https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2019/03/BDT-medijumi_MK-FINAL.pdf

LIDHJET, KONSTELACIONET INSTITUCIONALE

Në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ekzistojnë një sërë institucionesh në organet ekzekutive dhe gjyqësore që kanë mundësi ligjore të veprojnë në luftën kundër gjuhës së urrejtjes, dhe për të thënë të vërtetën, shumica prej tyre tashmë po e bëjnë këtë, disa drejtpërdrejt, disa në mënyrë indirekte. Përveç kësaj, këto subjekte do të kontribuonin në regjistrimin e akteve të gjuhës së urrejtjes. Edhe nëse disa prej tyre nuk kanë kapacitete adekuate personale (siç mund të konkludohet nga teksti i mëposhtëm), atëherë autoritetet shtetërore do të mund të përdoren për shërbime të tilla edhe nga sektori privat. Një shembull i ngjashëm u publikua së fundi kur u bë e ditur se Instituti i Gjuhës Maqedonase “Krste Misirkov” dhe disa institucione shëndetësore publike kanë përdorur shërbime arkivimi nga një kompani private e Shkupit, kështu që nuk ka arsye pse ai bashkëpunim me autoritetet tjera relevante shtetërore të mos thellohet edhe në fushën e “regjistrimit dhe përpunimit të të dhënave” nga kompanitë që kryejnë një veprimtari të tillë.^[53]

Ata që e bëjnë këtë drejtpërdrejt janë organet e pushtetit gjyqësor (prokuroria publike si më e rëndësishmja sepse drejton procedurën para-hetimore dhe hetimore), kurse nga organet e pushtetit ekzekutiv është, para së gjithash, Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe organi i specializuar i themeluar me Ligjin për Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LASHMAA – Agjencia për SHMAA dhe organi i specializuar për luftimin e diskriminimit – Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të cilat organe do të flitet në tekstin e mëposhtëm.

53. https://sdk.mk/index.php/instagram/rakopisi-stari-po-500-godini-od-institutot-za-madeonski-jazik-so-digitalizatsija-se-spaseni-od-pozhar-i-voda/?fbclid=IwAR3BRYp10_LDd1iBW20bvKi_AJG_nhxs-uWHxsuhGnlqcLSffAsP_o8Wljw (25,05,2023).

Ndër ata që e bëjnë këtë në mënyrë indirekte veçohen: Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: MASH), MARnet, Avokati i Popullit dhe bashkësitë fetare.

Sa i përket Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, është e sigurt se në vitin 2019 ka bërë “Plan për të luftuar lajmet e rreme”. Në të vërtetë, “lajmet e rreme” si kategori janë pjesë e fushës së politikave të sigurisë të qeverive në mbarë botën, sepse ato kryesisht bien në domenin e “luftërave speciale”, të propagandës së “luftës hibride”.^[54] Këto janë informacione që më së shumti “përgatiten” në “kuzhinat” e shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë. Por gjithsesi, si fragment në atë korpus të “lajmeve të rreme” nuk ka dyshim që qarkullojnë edhe informacione që janë tipike dhe kanë elemente të “gjuhës së urrejtjes”.^[55] Gjëja tjetër që bëri Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ishte themelimi i Grupit të Veprimit për luftën kundër lajmeve të rreme në vitin 2019, por ai u shua para se të fillonte punën, përndryshe ishte i përbërë nga anëtarë - politikanë. Me këtë “Plani” praktikisht nuk mund të realizohej, por është ende aktual sepse ishte vendosur me zgjidhje të qëndrueshme dhe precize. Sa i përket “Planit”, Qeveria së fundmi paralajmëroi përpjekje të reja, të cilat do të realizohen këtë vit me mbështetjen e huaj nga Shtetet e Bashkuara,^[56] por edhe në bashkëpunim me sektorin joqeveritar.

Të krijohet përshtypja se në Qeveri mungojnë edhe kuadro të specializuara që do të merreshin me këtë aktivitet sepse edhe ata pak që janë nga i ashtuquajtimi sektor klasik për monitorimin e mediave, ata nuk e kanë krijuar ende të ashtuquajturin “Rapid alert system”,^[57] i cili ndër të tjera do të monitoronte edhe “lajmet e rreme” dhe do të krijonte një “Regjistër të informacioneve të përcaktuara dhe zhveshura”, e lëre më një organ që do të bënte diçka më shumë. Kjo situatë pritet të kapërcehet

54. Kështu, vitin e kaluar në SHBA u krijua “Bordi Qeveritar për Dezinformimin”, i cili pati sukses të ndryshueshëm, sepse e ndërpreu punën menjëherë pas themelimit. Burimi: <https://www.washingtonpost.com/technology/2022/05/18/disinformation-board-dhs-nina-jankowicz/> (23,05,2023).

55. Të tilla si një rubrikë e fundit në një media të shkruar të Autoritetit Palestinez se Republika e Izraelit e futi qëllimisht virusin korona në Palestinë. Shih: <https://www.algemeiner.com/2021/12/23/official-palestinian-newspaper-israel-infected-palestinians-with-covid-19/>

56. Shih: <https://www.mkd.mk/node/513338>

57. https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/ras_factsheet_march_2019_0.pdf (25,05,2023).

shpejt duke pasur parasysh zhvillimet gjeopolitike dhe luftën aktuale ndërmjet Federatës Ruse dhe Republikës së Ukrainës, si dhe reagimin e shpejtë dhe të koordinuar të vendeve të NATO-s, përfshirë Maqedoninë e Veriut, në kontekstin e identifikimit dhe bllokimit të “lajmeve të rreme”. Në një gjendje të tillë të ardhshme, gjuha e urrejtjes do të mbulohej vetëm pjesërisht, sepse në këto zhvillime, edhe pse është e natyrshme, ajo është ende e një rëndësie marginale në raport me temën kryesore – lajmet e rreme.

Potenciali i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut për të inkuadruar veten në luftën kundër gjuhës së urrejtjes është i madh, por idetë nuk kanë ardhur ende, dhe njëra prej tyre do të ishte përdorimi i shërbimit publik – RTVM (MRTV), i cili do të kishte programe të specializuara të rregullta për zbulimin e përmbajtjeve që përmbajnë gjuhë urrejtjeje dhe emisione të tipit “Fact Checkers” për sa i përket gjuhës së urrejtjes janë të ngjashme me ato që shfaqen në shërbime të mëdha publike (shtetërore) televizive evropiane si: Euronews, BBC, France 24 dhe që kanë fituar shikueshmëri në dy vitet e fundit. Në këtë mënyrë do të ndiqej trendi botëror për gazetari objektive dhe profesionale. Deri më tani, në vendin tonë veprojnë vetëm portalet e internetit që e kanë origjinën nga sektori i organizatave joqeveritare, për të cilët si duket interesi primar është gjeopolitika dhe të cilat nuk e kanë ndërtuar besueshmërinë dhe popullaritetin e tyre në opinion publik si: <https://vistinomer.mk/> dhe Shërbimi për kontrollin e fakteve të organizatës joqeveritare “Metamorfozis”.^[58] Përveç kësaj, RTVM-ja do të mund të kishte periodikisht edhe emisione kontaktuese ku do të raportoheshin akte të gjuhës së urrejtjes, e cila do të pasohej nga një debat publik me thirrje nga qytetarët, në mënyrën e programeve të mëngjesit të transmetuara nga televizionet e mëdha private në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Përtej temës së “lajmeve të rreme”, dhe pikërisht në temën “gjuha e urrejtjes”, lindi një problem për qeverinë kur erdhi kërkesa e papritur nga Republika e Bullgarisë në vitin 2020 që vendi ynë të merret me gjuhën e urrejtjes kundër Bullgarisë dhe bullgarëve,^[59] e gjithë kjo në

58. https://metamorphosis.org.mk/en/uslugi_arhiva/servis-za-proveka-na-fakti-od-mediumite/

59. <https://360stepeni.mk/zaharieva-bugarija-ja-blokira-s-makedonija-poradi-govorot-na-omraza/>

kontekstin e vetos bullgare për pranimin e Maqedonisë së Veriut si shtet anëtar i Bashkimit Evropian (hapja e negociatave për pranim).^[60] Në këtë drejtim, përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, Qeveria e Maqedonisë së Veriut krijoi një grup punues ndërmintor i ngarkuar me koordinimin politik të aktiviteteve në lidhje me masat e përcaktuara në “Protokollin e dytë dypalësh për përmbushjen e Marrëveshjes me Bullgarinë për Miqësi dhe Fqinjësi të mirë nga viti 2017”,^[61] si një nga kushtet për hapjen e negociatave të Maqedonisë së Veriut me BE-në për anëtarësim në krye me Ministrin e Punëve të Jashtme.^[62] Më tej, në mbështetje të punës së Grupit Ndërmintor të Punës, u formuan nëngrupe tematike në këto fusha: gjuha e urrejtjes, rehabilitimi i viktimave të represionit gjatë periudhës së regjimit komunist, zbatimi i rekomandimeve të miratuara nga Komisioni që punon në çështjet historike si dhe në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. Ministri i Punëve të Jashtme theksoi se në angazhimet e marra nga Republika e Maqedonisë së Veriut me “Protokollin” po punohet në mënyrë aktive dhe së shpejti do të prezantohen “rezultatet e arkivave, teksteve shkollore, gjuhës së urrejtjes dhe antidiskriminimit”.^[63] Për sa i përket Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), duhet theksuar projektin shumëvjeçar të kësaj ministrie për “Shkrim-leximin mediatik” i cili rezultoi në konceptin e ri për arsimin fillor kur në vitin 2021 “shkrim-leximi mediatik” u bë pjesë e këtij koncepti dhe u prezantua si bazë për të identifikuar se: cili është informacioni i saktë dhe çfarë është lajmi i rremë.^[64] Zbatimi fillimisht ishte me trajnime të mësimdhënësve në vitin

60. Edhe pse vetë Republika e Bullgarisë nuk i ka “mbaruar detyrat e shtëpisë” në drejtim të luftimit të gjuhës së urrejtjes. Shih: <https://bntnews.bg/news/ek-zapochva-procedura-sreshtu-balgariya-zaradi-borbata-s-razisma-i-ezika-na-omrazata-1096561news.html>

61. <https://sdk.mk/index.php/makedonija/tselosen-tekst-na-protokolot-so-bugarija-shtodeneska-go-potpishaa-osmani-i-genchovska/>

62. Në fillim të vitit 2023 u formua Grupi punues ndërmintor i përbërë nga përfaqësues të ASHMAA-ja, KPMD-ja, PPRMV-së, MPB-së dhe MPJ-së. Një prokuror publik dhe një përfaqësues nga Departamenti i marrëdhënies me publikun të PPRMV-së marrin pjesë aktive në të. Ata kanë takime të shpeshta në lidhje me problemin e lartpërmendur me Republikën e Bullgarisë (ndër të edhe rasti i famshëm “Pendikov”), prandaj është e dëshirueshme që interesimi i tyre të shtrihet edhe në raste të tjera të gjuhës së urrejtjes si veçer penale.

63. <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32120617.html>

64. Ndonëse në vitin 2008, në planprogramin e gjuhës maqedonase për arsimin fillor, tashmë ekzistonte një lëndë me emërtim të ngjashëm, por me përmbajtje të ndryshme, përkatësisht kultura mediatike. Në kuadër të kësaj lëndë ishin planifikuar të realizohen 10 orë për të mësuar rreth filmit, animacionit dhe arteve të tjera pamore.

2022,^[65] ndërsa tashmë në vitin 2023 “shkrim-leximi mediatik u bë pjesë e programit të lëndës së gjuhës maqedonase për klasën e VI-të me gjithsej 20 orë të planifikuara. Në zanafillën e këtij lajmi ishte problemi i ekspozimit të vazhdueshëm të të rinjve ndaj teorive informative-konspirative që ndodheshin në rrjetet sociale e në portale dhe në televizion gjatë kohës së pandemisë me COVID-19.”^[66]

Në realizimin e trajnimeve ndihmoi edhe institucioni shtetëror “Byroja për Zhvillimin e Arsimit”, e cila organizoi webinarë për njohjen e mësimdhënësve me temën, ndërsa më aktivë prej disa vitesh nga sektori i organizatave joqeveritare është “Instituti për Studime të Komunikimit”, i cili bëri kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e “shkrim-leximit mediatik” përmes portalit të tyre të internetit <https://medium.edu.mk>. Në vitin 2021/2022, organizata joqeveritare “Instituti për të Drejtat e Njeriut” realizoi një projekt në mesin e nxënësve me mbështetjen e Ambasadës Gjermane në Shkup, me qëllim njohjen dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes.^[67] Gjëja më domethënëse është se në programin e sipërpërmendur thuhet qartë dhe me vendosmëri se “standardet e vlerësimit” do të përfshijnë “njohjen e fyerjeve dhe shpifjeve personale në komunikimin online”, si dhe “njohjen e gjuhës së urrejtjes në media dhe në rrjetet sociale”. Ndër qëllimet e programit është si më poshtë: “Nxënësi të kuptojë dhe pranojë se në hapësirën digjitale është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e identitetit, privatësisë dhe sigurisë emocionale, të mos përdoret gjuhë e urrejtjes dhe dhunë kibernetike dhe të respektohen rregullat dhe normat e komunikimit në komunitetet digjitale.”^[68] Interesante janë edhe

65. <https://mim.org.mk/mk/novosti/1348-nad-100-nastavnici-od-osnovnite-uchilishta-go-zavrshija-prviot-del-od-obukata-za-mediumska-pismenost-3>

66. <https://skopjeinfo.mk/carovska-mon-raboti-na-voveduvanje-mediumska-pismenost-vo-nastavnite-sodrzhini>

67. <https://ihr.org.mk/mk/realizirani-proekti/zashtita-od-diskriminacija-buling-i-govor-na-omraza> (23,05,2023).

68. Fq.5 nga Programi.

metodat didaktike për realizimin e këtij qëllimi.^[69] Natyrisht, publiku pret që Ministria e Arsimit dhe Shkencës të reagojë me shpejtësi nëse në përmbajtjet mësimore ka “gjuhë urrejtjeje”, pra përmbajtje që mund të nxisin intolerancën apo urrejtjen dhe t’i heqë ato menjëherë. Përveç kësaj, për të pasur një pasqyrë të plotë, ndihmon edhe fakti që në vend filluan të festohen “Ditët e shkrim-leximit mediatik”, që vitin e kaluar ishte nga 25 tetori deri më 1 nëntor.^[70]

Ndër organet ku natyrshëm duhet të kanalizohen informacionet dhe të dhënat statistikore për aktet e gjuhës së urrejtjes, në krye është Enti Shtetëror i Statistikave.^[71] Enti Shtetëror i Statistikave është organizatë

69. Nxënësit, të ndarë në 5 grupe, vizatojnë një nga grupet e kartave në të cilat janë të shkruara (një në secilën kartë): RACA (të bardhët, zezakët dhe të tjerët), SEKSI/GJINIA (djalë, vajzë, grua, burrë), PROFESIONI (policë, mjekë, mësues dhe të tjerë), MOSHA (më i rritur, më i ri, adoleshentë), ANËTARËT E FAMILJES (vajza, djali, nëna, babai, gjyshja, gjyshi). Secili grup duhet, në një fletë të madhe letre, të përshkruajë (me fjalë dhe me një vizatim) se si njerëzit në kartën e zgjedhur janë paraqitur në media (në filma, seriale, reklama) - si duken, si sillen dhe çfarë cilësish kanë. Në një fletë tjetër, ata duhet të listojnë edhe shembuj nga media ku e kanë parë atë (cili film, serial, reklamë). Pas përfundimit të punës, secili grup (një nga një) varin në mur fletët e tij me përshkrimet dhe shembujt dhe ua prezanton punën e tyre të tjerëve. Pas çdo prezantimi, nxënësit nga grupet e tjera plotësojnë me shembujt e tyre dhe së bashku përcaktohet se çfarë përshkrimi dominon në media. Mësuesi/ja shkruan në tabelë të gjitha përshkrimet e listuara që përputhen me stereotipet e zakonshme për grupet (p.sh.: Zezakët janë kriminelë, shesin drogë; gjyshet kujdesen, bëjnë byrek, nuk vishen mirë; Djemtë janë të guximshëm, të fortë, nuk qajnë). Mësuesi/ja përdor përshkrimet e shkruara në tabelë për të përcaktuar termin stereotip (një karakteristikë që i atribuohet anëtarëve të grupeve të caktuara) dhe për të treguar llojet e stereotipeve që përcaktohen nga grupet të cilave u referohen (racore, gjinore, profesionale, të rritur). Në të njëjtën kohë, përshkrimet e anëtarëve të familjes lidhen me stereotipet gjinore dhe të moshës. Brenda secilit grup, secili nxënës duhet të japë një shembull të një personi specifik që ata e njohin, i cili është i ndryshëm nga stereotipi dhe të listojë karakteristikat e tij/saj që e bëjnë atë të ndryshëm nga stereotipi. Grupet prezantojnë shembujt e tyre. Në një diskutim të hapur, arrihet në përfundimin se media kryesisht na bën që të gjithë anëtarët e një grupi t’i shohim sikur janë të njëjtë (sipas stereotipit), edhe pse shumë prej tyre ndryshojnë nga stereotipi. Zhvillohet një diskutim i hapur për të shpjeguar se si stereotipet gjinore në media transmetohen edhe në rrjetet sociale: (1) Sa ndihet i lirë dikush (djalë apo vajzë) që është i ndryshëm nga stereotipi të prezantohet në dritën e duhur?; (2) Si do të reagonin të tjerët nëse portretizoheshin në një dritë tjetër; (3) Cilat janë pasojat nga kjo? Bashkarisht konkludohet për pasojat negative të përhapjes së stereotipeve gjinore dhe llojeve të tjera të stereotipeve nëpër media dhe rrjete sociale. Grupeve u kërkohet të përgatisin një paralajmërim që do të vendoset përpara filmit, serialit ose reklamës që nxit stereotipet ndaj një grupi të caktuar, sipas parimit të paralajmërimit për cigaren: Duhani vret - të dalë me një fjali tërheqëse që tregon pasojën nga prania e stereotipit specifik.

70. <https://mediumskapismenost.mk/denovi-na-mediumska-pismenost-2022/> (25,05,2023).

71. Enti Shtetëror i Statistikave e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin për Statistikat Shtetërore (1997, 2007, 2011, 2013, 2014, 2015, 2016, 2018 dhe 2020) së bashku me pjesëmarrësit e tjerë në sistemin statistikor të shtetit të përcaktuar nga Programi për Kërkime Statistikore, 2023-2027.

profesionale dhe e pavarur në kuadër të administratës shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Funkcionet themelore të institucionit janë mbledhja, përpunimi dhe shpërndarja e të dhënave statistikore për dukuritë demografike, sociale dhe ekonomike në shoqërinë maqedonase. Gjithashtu Enti Shtetëror i Statistikave është bartësi dhe koordinatori kryesor i sistemit statistikor të vendit, është institucioni përgjegjës për bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e statistikave, si dhe për përcaktimin e metodologjive dhe standardeve statistikore dhe për sigurimin e mbrojtjes së të dhënave individuale që grumbullohen nga personat fizikë dhe juridikë. Në kategoritë statistikore që mban Enti, përfshihet edhe sistemi gjyqësor, por fatkeqësisht aty, në të ashtuquajturat Baza elektronike e të dhënave “Makstat” nuk disponon statistika specifike për aktet e gjuhës së urrejtjes si grup veprash penale.^[72]

Edhe Avokati i Popullit nuk duhet të anashkalohe në grafikun e rrjetit të autoriteteve përkatëse që duhet të jenë në ndërlidhje me të tjerët, me qëllim të shtypjen/parandalimin dhe regjistrimin e gjuhës së urrejtjes. Avokati i Popullit i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së parimit të mosdiskriminimit dhe ka themeluar “Departamentin për mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi”. Megjithatë, përveç indikacioneve të rralla publike për praninë e gjuhës së urrejtjes, Avokati i Popullit në raportet vjetore nuk i trajton rastet e gjuhës së urrejtjes si formë diskriminimi. Përrjashtim nga kjo praktikë është raporti i vitit 2010 ku Avokati i Popullit tregon një rast të gjuhës së urrejtjes, pa hyrë në detaje të rastit.^[73] Fatkeqësisht, ky trend ka vazhduar edhe sot e kësaj dite, siç shihet edhe nga Raporti i fundit i Avokatit të Popullit për vitin 2022, ku thuhet se në vitin 2022 është shënuar një numër i shtuar i ankesave lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi (76), madje 33 më shumë se në vitin 2021, por nuk thuhet nëse në ato raste ka pasur edhe raste të gjuhës së urrejtjes.^[74]

72. https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Sudstvo__PrijaveniPolnoletniStoriteli/102_SK1_Mk_T3a_ml.px/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef

73. Burimi: „Raport paraprak mbi kornizat ligjore dhe masat për të luftuar gjuhën e urrejtjes“, Fondacioni për Internet dhe Shoqëri „Metamorfozis“, 2018, fq.14. LIDHJA: <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2018/04/1.3-Preliminaren-izveshtaj-govor-nanomraza.pdf>

74. Shih fq.82 nga Raporti. Burimi: <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Godisni%20izvestai/GI-2022/GI-2022.pdf>

Për sa i përket çështjes së reagimit, raportimit dhe regjistrimit në kohë të gjuhës së urrejtjes, as bashkësitë fetare nuk duhet të injorojnë këtë fenomen. Pozita e tyre në Republikën e Maqedonisë është e rregulluar me Ligjin për pozitën juridike të një kishe, bashkësie fetare dhe grupi fetar^[75] (pavarësisht se Maqedonia është shtet laik). Liria e besimit është gjithashtu një kategori kushtetuese. Që andej, bashkësitë fetare e kanë obligim moral të japin kontributin e tyre. Por për ta ka edhe një detyrim ligjor në nenin 4 të ligjit, i cili parashikon: “Nuk lejohet diskriminimi fetar. Bindja fetare nuk e liron qytetarin nga detyrimet që ka si qytetar sipas Kushtetutës, ligjeve dhe rregulloreve të tjera, përveç nëse me ligj apo rregullore tjetër është parashikuar ndryshe”. Në shtetet demokratike evropiane është bërë aktuale çështja nëse është e nevojshme të vendoset regjistrimi i detyrueshëm shtetëror i predikuesve fetarë, për të parandaluar predikimet e personave fetarë të mbushur me gjuhë urrejtjeje.^[76] Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të mendojë gjithashtu në këtë drejtim.

75. (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.113/07 dhe nr.81/08).

76. <https://www.dw.com/en/austria-calls-for-european-register-of-muslim-imams/a-56114597>

Rrjeti Maqedonas për Kërkime Akademike (në tekstin e mëtejshëm: MARnet) është institucion publik që kryen veprimtari me interes publik dhe është themeluar në vitin 2010.^[77] Ky institucion ka përgjegjësi të shumta në kuadrin e trafikut të internetit në vend,^[78] dhe deri më tani ka qenë mosmirënjohës neglizhimi dhe përjashtimi i tij nga rrjeti i autoriteteve shtetërore që kanë autoritetin të vepronë në luftën kundër gjuhës së urrejtjes, si dhe në aktivitetet e marrjes së të dhënave - për të regjistruar rastet e gjuhës së urrejtjes. Ndoshta për herë të parë ky organ doli në fokus të opinionit me vendimin e fundit të Gjykatës Themelore

77. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 124 e datës 20.09.2010.

78. MARnet kryen punët dhe detyrat e mëposhtme:

- menaxhon rrjetin e mbyllur të telekomunikacionit;
- inkurajon zhvillimin e rrjetit të mbyllur të telekomunikacionit;
- planifikon, organizon dhe menaxhon lidhjet ndërmjet përdoruesve të shërbimeve të telekomunikacionit;
- udhëheq, menaxhon dhe kryen prokurimin dhe dhënien me qira të softuerit, materialit dhe pajisjeve të nevojshme të komunikimit;
- organizon dhe zhvillon trajnime dhe ofron ndihmë profesionale për përdoruesit e shërbimeve të telekomunikacionit;
- menaxhon domenin maqedonas (domeni .mk)
- siguron anëtarësimin dhe bashkëpunimin me organizatat përkatëse ndërkombëtare;
- kryen veprimtari kompjuterike lidhur me kërkimin dhe zhvillimin eksperimental në shkencat natyrore dhe tekniko-teknologjike;
- kryen punë lidhur me softuerin (përgatit, nxjerr, ofron konsultime);
- kryen konsultime lidhur me harduerin;
- mban një bazë të dhënash dhe përpunon të dhënat;
- mban një regjistër të vetëm të nëndomaineve të regjistruara në domenin MK (në tekstin e mëtejshëm: Regjistri);
- mirëmban sistemet e telekomunikacionit në rrjetin e mbyllur të telekomunikacionit;
- kryen veprimtari botuese lidhur me ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit;
- kryen punë që kanë të bëjnë me riprodhimin e mediave kompjuterike;
- kryen shërbime në rrjetin e mbyllur të telekomunikacionit për realizimin e programeve të veprimtarive arsimore;
- kryen punime lidhur me lidhjen e rrjetit të mbyllur telekomunikues të përdoruesve të shërbimeve të telekomunikacionit;
- siguron lidhje profesionale dhe teknike me rrjetet përkatëse të telekomunikacionit jashtë vendit;
- vendos, mban dhe zhvillon bashkëpunim me rrjetet tjera telekomunikuese në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë saj dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Penale Shkup^[79] në rastin kundër Marjan Stamenkovskit, si përgjegjës i portalit “Dokaz.mk” për disa vepra penale, përfshirë edhe Përhapjen dhe shpërndarjen e materialeve raciste dhe ksenofobike nëpërmjet një sistemi kompjuterik nga neni 394-d paragrafi 1 i Kodit Penal, ku MARnet u ngarkua nga Gjykata të zbatonte dënimin - Ndalim të kryerjes së një profesioni, veprimtarie ose detyre nga neni 38-b i Kodit Penal, me të cilin të akuzuarit iu ndalua regjistrimi i një domeni dhe të paraqitet në cilësinë e regjistruarit ose pronarit të një portali të regjistruar në MARnet për 10 vjet.

MARnet punon jo vetëm në bazë të ligjit, por edhe në bazë të akteve nënligjore, si: Rregullorja për organizimin dhe menaxhimin e domenit të nivelit të lartë .MK dhe domenit të nivelit të lartë .MKD i datës 21 maj 2014, Vendimi për caktimin e kushteve të përgjithshme për punën e regjistruarit nga 27.11.2015 dhe Rregullorja për rregullat e përgjithshme për qasjen dhe shfrytëzimin e rrjetit të mbyllur telekomunikues të MARnetit dhe shërbimeve telekomunikuese nga viti 2017, në të cilin në nenin 2, neni 6 dhe neni 18 paragrafi 15 parashikohet shprehimisht se përbën “përdorim të paautorizuar” nëse një subjekt-institucion arsimor, siç është përdoruesi MARnet i Rrjetit të Mbyllur të Telekomunikacionit (aktualisht i përbërë nga një duzinë institucionesh të arsimit të lartë dhe instituteve shkencore, shprehet ekskluzivisht - në pronësi) “përhap diskriminim kombëtar, fetar, racor ose gjinor, urrejtje dhe intolerancë ose aktivitete të tjera që fyejnë, shpifin ose ngacmojnë individë ose një grup të tërë njerëzish, si kërcënime, dhunim i besimeve fetare, etnike, politike ose të tjera, etj.” Në atë rast, MARnet, me iniciativën e vet, ka të drejtë të përjashtojë përdoruesin nga përdorimi i shërbimeve në përputhje me nenin 6 të Rregullores. Deri më tani nuk ka pasur një shembull të tillë në praktikën e MARnet-it.

Por kjo nuk vlen për përdoruesit e domenit të rregullt maqedonas .mk dhe domenit kryesor maqedonas .mkd, llojet e nëndomaineve në domenet .mk dhe .mkd. Nga ana tjetër, regjistrimi i këtyre domeneve në përputhje me nenin 19 të Rregullores për organizimin dhe menaxhimin e domenit të lartë .MK dhe domenit të lartë .MKD nga data 21.05.2014 nga MARnet bartet te regjistruarit, të cilët janë rreth 15 kompani private që punojnë sipas parimit I pari vjen, i pari shërbehet dhe me të cilët MARnet

79. nr.429/23 e datës 04,04,2023.

lidh marrëveshje bashkëpunimi në përputhje me nenin 7 të Vendimit për përcaktimin e kushteve të përgjithshme për punën e regjistruarit të datës 27.11.2015. Në cilën marrëveshje mund t'u kërkohej regjistruarëve që të kërkojnë nga të regjistruarit që të paraqesin deklarata se nuk do të praktikojnë gjuhën e urrejtjes në faqet e tyre të internetit; se do të jenë proaktivë në fshirjen e komenteve të tilla brenda një kohe të arsyeshme dhe se do të përpiqen të arrijnë “Kriteret e detyrueshme” të “Regjistrit profesional të mediave online” të përmendur më lartë. Por kjo gjë është një masë që do të ishte e dobishme në aspektin e parandalimit të gjuhës së urrejtjes, dhe sa i përket procesit të regjistrimit të gjuhës së urrejtjes, nuk ka asnjë detyrim ligjor të drejtpërdrejtë që MARnet të bëjë të njëjtën gjë edhe pse është i detyruar të “mbajë një bazë të dhënash dhe të përpunojë të dhëna” pa një përcaktim specifik se me çfarë lloji të dhënash duhet të merret. Në këtë pjesë, ndoshta duhet të ketë udhëzime dhe ndihmë nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe, e cila mbikëqyr punën e MARnet në përputhje me nenin 19 të Ligjit për MARnet, sepse është ende një organ shtetëror që ka një numër të vogël të personelit (7 punonjës) dhe ku ka mungesë të stafit teknik.

Në fund, sa i përket pjesës hyrëse kushtuar këtij institucioni publik, kontributi i padyshimtë i rëndësishëm që jep MARnet në sanksionimin e gjuhës së urrejtjes dhe planit të parandalimit të veçantë dhe të përgjithshëm, si dhe në funksion të detyrimit ligjor nga neni 29 i Rregullores për organizimin dhe menaxhimin me domenin e lartë .MK dhe domenin e nivelit të lartë .MKD nga data 21.05.2014, i cili përcakton: “MARnet ka të drejtë të modifikojë çdo informacion domeni ose të fshijë një domen në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë ose në bazë të një vendimi të organeve kompetente”. Kur është e nevojshme, për të ruajtur qëndrueshmërinë teknike të internetit, MARnet, pasi të njoftojë regjistruarët, mund të çaktivizojë përkohësisht domenin deri në eliminimin e shkakut.

Në lidhje me të gjitha organet e përmendura shtetërore, më i rëndësishmi është detyrimi i përcaktuar me nenin 273 të Kodit të Procedurës Penale për kallëzimin e krimeve në detyrë zyrtare, përfshirë format e veçanta të “gjuhës së urrejtjes”. Në të njëjtin nen parashikohet detyrimi shtesë i organeve shtetërore për të deklaruar provat dhe për të marrë masa për ruajtjen e gjurmëve të krimit dhe sendeve që janë

përdorur në ekzekutimin e tij ose që rezultojnë nga ekzekutimi dhe prova të tjera.

LEGJISLACIONI

Kushtetuta e Maqedonisë garanton lirinë e besimit, bindjes dhe mendimit dhe të shprehjes publike të mendimit, lirinë e fjalës, performancës publike, informimin publik dhe themelimin e lirë të institucioneve për informim publik, qasjen e lirë në informata, lirinë e pranimit dhe transmetimit të informacionit, si dhe si e drejta për mbrojtjen e burimit të informacionit në mjetet e informimit publik. Në Maqedoni, liria e medias është një e drejtë e pacenueshme.^[80] Në mënyrë të çuditshme dhe periferike për temën e gjuhës së urrejtjes, i vetmi vend në Kushtetutë ku gjendet termi “urrejtje” është neni 20.^[81]

Për sa i përket akteve më të gjera ligjore, Kodi Penal dhe Kodi Zgjedhor janë gjithashtu të rëndësishëm për gjuhën e urrejtjes. I pari do të diskutohet më shumë më poshtë, por përsa i përket Kodit Zgjedhor është domethënës fakti se ai del në pah menjëherë para se të zhvillohen zgjedhjet në vend në fushata dhe kur në fakt vërehet një gjuhë e intensifikuar e urrejtjes. Megjithatë, ai nuk i kushton vëmendje të veçantë gjuhës së urrejtjes, megjithëse media është e rregulluar fort për të krijuar një “përfaqësim të balancuar mediatik” të partive politike që luftojnë për pushtet (Shih nenin 75 të Kodit), dhe gjuha e urrejtjes është sigurisht diametrisht kundër “përfaqësimit të balancuar”. Përndryshe, kompetencat për mbikëqyrjen e mediave, Kodi ia ka caktuar Agjencisë për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e cila do të diskutohet në vijim (Shih nenin 76–c). Këtu duhet theksuar se roli i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve duhet të jetë më aktiv në rastet e vërejtura të gjuhës së urrejtjes ndërmjet partive nëpër fushata politike. Pak vite më parë, në një nga vendet tona fqinje (Bosnjë dhe Hercegovinë), pikërisht

80. Neni 16 i Kushtetutës përcakton normat në lidhje me gazetarinë. Ato interpretohen në atë mënyrë që gazetarët të kenë një rol për të përcjellë informacione, ide dhe opinione dhe për të komentuar me vërtetësi. Ata duhet të jenë të ndershëm, objektivë dhe të saktë dhe të respektojnë vlerat etike dhe standardet profesionale. Burimi: „Shpifja dhe fyerja në procedimet penale kundër gazetarëve“, Koalicioni Të gjithë Për Gjykim të Drejtë, Dhjetor, 2006, Shkup, fq.11.

81. “Programet dhe veprimet e shoqatave të qytetarëve dhe partive politike nuk mund të synojnë përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues të Republikës dhe nxitjen apo thirrjen për agresion ushtarak apo nxitjen e urrejtjes apo intolerancës kombëtare, racore apo fetare”.

ky organ (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve) u paralajmëroi partive politike se do të trajtojë të gjitha rastet e përdorimit të retorikës nacionaliste dhe antishtetërore në fushatën parazgjedhore tek autoritetet kompetente. Kjo rezultoi në një fushatë “më të butë”.^[82]

Një akt tjetër i natyrshëm i pluralizmit është domethënës, dhe ai është Ligji për Partitë Politike.^[83] Në nenin 3 paragrafi 3 i të njëjtit parashikohet se “Programi, statuti dhe veprimi i partive politike nuk mund të synojnë nxitjen e urrejtjes apo intolerancës kombëtare, racore apo fetare, intolerancës etnike, intolerancës, urrejtjes, gjenocidit, shfarosjes, përhapjes apo mbështetjes së fashizmit, nazizmit, nacionalsocializmit dhe Rajhut të Tretë ose referenca ndaj personave dhe ngjarjeve të së kaluarës që lidhen me fashizmin, nazizmin, nacionalsocializmin dhe Rajhun e Tretë.” Për të njëjtën është paraparë edhe përgjegjësia penale për partinë politike si person juridik (gjobë në shumë prej 800.00 deri në 4.800.00 euro), sipas nenit 40 të Ligjit. Procedura për ndalimin e partisë politike nëse shkel dispozita e nenit 3 të Ligjit është e rregulluar në nenet 33–37 të Ligjit, dhe inicohet nga prokurori publik, por në procedurë civile (shih nenin 33 të ligjit). Në lidhje me statutet e partive politike janë të përcaktuara kufizimet në atë drejtim dhe në përputhje me nenin 16 paragrafi 5 i ligjit: “Emri dhe simbolet e partisë politike nuk duhet të përmbajnë simbole, fjalë, shkurtesa që shkaktojnë intolerancë racore, fetare, kombëtare, etnike dhe të tjera, urrejtje, gjenocid, shfarosje, përhapje ose mbështetje të fashizmit, nazizmit, nacionalsocializmit dhe Rajhut të Tretë”.^[84]

Edhe ligjet “e vogla” janë të rëndësishme në luftën kundër gjuhës së urrejtjes, si: Ligji për Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji për Kundërvajtjet kundër rendit dhe qetësisë publike, Ligji për parandalimin e dhunës dhe sjelljes së pahijshme në garat sportive, Ligji për Probacion dhe Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, por më shumë për të gjithë këto ligje do të flitet më poshtë.

82. Burimi: Radosavljevic, P., “Govor mrznje u Bosni i Hercegovini”, Anali poslovne ekonomije, br.13, 2015, fq.68, E disponueshme në: <https://doisrpska.nub.rs/index.php/APEPIMBL/article/view/5818> (25,05,2023).

83. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.76/2004.

84. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për partitë politike, data 02.11.2022.

VËSHTRIM PËR GJENDJEN ME MEDIAT NË MAQEDONI NË PRISMËN E LIGJIT PËR AGJENCINË PËR SHËRBIMET MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE DHE LIGJIT PËR MEDIAT

Sipas teoricienëve, nën termin “media dhe hapësirë mediatike” nënkuptohen: portalet e internetit, shtypin, emisionet e lajmeve në radio dhe televizion dhe rrjetet sociale.^[85] Në përgjithësi në Republikën e Maqedonisë nuk ka një ligj të veçantë që rregullon në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjen e gjerë të informimit publik, por ai bëhet pjesërisht. Memiratin e Direktivës për Shërbimet Mediatike Audiovizuale, Bashkimi Evropian ka ndërmarrë veprime konkrete për trajtimin e gjuhës së urrejtjes në shërbimet mediatike audiovizuale. Neni 6 i Direktivës thotë se autoritetet në çdo shtet anëtar “**duhet të sigurojnë, me mjetet e duhura, që shërbimet e medias audiovizive të ofruara nga ofruesit e shërbimeve mediatike nën juridiksionin e tyre të mos përmbajnë asnjë nxitje urrejtjeje të bazuar në racë, seks, fe ose kombësi**”. Kjo do të thotë gjithashtu veprim kundër kanaleve që përdorin një lidhje satelitore (uplink) në një vend të BE-së dhe kapaciteteve satelitore që përdoren për të transmetuar gjuhën e urrejtjes nga kanale të licencuara në vende të tjera të BE-së. Në dhjetor të vitit 2013, Direktiva për Shërbimet Mediatike Audiovizuale

85. Poljak, M./ Hadžić, J./ Martinić, M. “ Govor mržnje u hrvatskom medijskom prostoru”, In Medias Res, Zagreb, 2020, fq.2716. E disponueshme në: <http://www.centar-fm.org/inmediasres/index.php/marko-poljak-jelena-hadzic-i-masa-martinic-govor-mrznje-u-hrvatskom-medijskom-prostoru> (22,05,2023).

u transpozua në Ligjin e ri të Republikës së Maqedonisë së Veriut për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAA). Përndryshe, në raportin e BE-së për progresin e Maqedonisë nga viti 2018, nënvizohet se “korniza ligjore është gjerësisht e harmonizuar me legjislacionin evropian dhe standardet ndërkombëtare” (Këtu nënkuptojmë edhe Ligjin për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Ligjin për Media).

Në nenin 4 të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale (në tekstin e mëtejshëm: “LSHMAA”) thuhet se “[organ kompetent për çështjet që i nënshtrohen këtij ligji është Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale](#)” (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).

Në nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit^[86] janë rregulluar ndalesat e veçanta për “gjuhën e urrejtjes”. Në këtë dispozitë thuhet:

Shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale nuk duhet të përmbajnë programe që kërcënojnë sigurinë kombëtare, inkurajojnë përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, thirrje për agresion ushtarak ose konflikt të armatosur, inkurajojnë ose përhapin diskriminim, intolerancë ose urrejtje në bazë të racës, ngjyrës, origjinës, origjinës kombëtare ose etnike, seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, anëtarësimit në një grup të marginalizuar, gjuhës, kombësisë, origjinës sociale, arsimit, fesë ose besimit fetar, besimit politik, besimi tjetër, paaftësisë, moshës, familjes ose gjendjes martesore, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, gjendjes personale pasurore dhe shoqërore, ose çdo bazë tjetër të parashikuar nga ligji ose një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar”.

Neni 48, paragrafi 2, thotë se: “[Ndalimet e veçanta nga paragrafi \(1\) i këtij neni do të jenë në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.](#)” Kjo dispozitë autorizon Agjencinë të përdorë të drejtën precedente të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çdo vendim që merr.

86. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 247 e datës 31.12.2018).

Më tej, në nenin 6, përcaktohet se Agjencia ka kompetencë, ndër të tjera, “të marrë masa në përputhje me këtë ligj në rastet kur ka shkelje të dispozitave të këtij ligji ose të rregulloreve të miratuara në bazë të saj dhe kushtet dhe detyrimet e lejeve.”

Vetë agjencia në “Udhëzuesin e saj të monitorimit të gjuhës së urrejtjes” deklaroi se “Kjo i jep autoritet të qartë Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencisë) për t’iu përgjigjur shkeljes së çdo neni të ligjit, përfshirë nenin 48 dhe identifikimin e “gjuhës së urrejtjes”.^[87] Kjo është plotësuese e dispozitës kundërvajtëse të nenit 147 të Ligjit e cila është futur relativisht vonë në ligj nga ligjvënësi dhe kurtani në paragrafin 1 është paraparë gjobë në shumë prej 1.000.00 deri në 5.000.00 euro në denarë nëse subjekti “transmeton dhe krijon programe që kërcënojnë sigurinë kombëtare, nxisin përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, thirrje për agresion ushtarak ose konflikt të armatosur, nxit ose përhap diskriminim, intolerancë ose urrejtje në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës, kombëtare ose origjina etnike, seksi, gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor, përkatësia në një grup të marginalizuar, gjuha, kombësia, origjina sociale, arsimi, feja ose besimi fetar, besimi politik, besimi tjetër, paaftësia, mosha, gjendja familjare ose statusi martesor, statusi pasuror, gjendja shëndetësore, cilësia personale dhe statusi social, ose ndonjë bazë tjetër”.^[88] Gjithashtu, në Ligjin ka një nen saktësisht të rregulluar për marrjen e masave për ndalimin e menjëhershëm të transmetimit dhe pranimit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale nga vendet e treta në territorin e Republikës së Maqedonisë, në pajtim me nenin 45 të këtij Ligji.

Përkundër statusit të marrë ligjërisht të Agjencisë si organ shtetëror publik dhe transparent, nuk ka të dhëna publike se sa procedura penale ka filluar Agjencia për shkak të shkeljes së nenit 48 të Ligjit dhe si do të jetë epilogu pas tyre. Në përputhje me nenin 7 të Ligjit, “puna e Agjencisë rregullohet më ngushtë me Rregulloren e Punës së Agjencisë”. Në bazë të pikës 5 të paragrafit 2 të këtij neni, Agjencia mund të zhvillojë procedurën për miratimin e akteve nënligjore dhe akteve të tjera që dalin nga ky ligj,

87. Udhëzues për monitorimin e “gjuhës së urrejtjes”, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Shkup, fq.19.

88. Neni 147 paragrafi 1 pika 10 nga Ligji (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr.248/2018).

i cili përsëri mund të jetë akt nënligjor për regjistrimin shtesë të “gjuhës së urrejtjes” dhe përpunimin e të dhënave të tyre, si dhe të krijohet një departament i veçantë për mbajtjen e statistikave, i cili për momentin nuk është në dispozicion.^[89] Ndryshe, sipas nenit 23 të Ligjit, Agjencia përveç propozimit për fillimin e procedurës kundërvajtëse, disponon edhe lloje të tjera të sanksioneve si: 1) dhënien e vërejtjes publike, 2) heqjen e lejes ose 3) zbatimin e procedurës së fshirjes nga regjistri i ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale ose nga regjistri i subjekteve radiodifuzive (transmetuesve).

Problemi me të cilin ballafaqohet Agjencia është pasiviteti i saj. Vërejtjet e forta të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut janë ende të vlefshme, kur në Parathënien e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale nga shkurti i vitit 2018 thuhej: “...nuk ka pluralizëm politik në media, është shtuar fjalimi i urrejtjes në media, ndërsa Agjencia e Medias është vetëm dëshmitare e heshtur e këtyre dukurive negative”.

Por nëse asgjë tjetër, atëherë të paktën neni 48 i lartpërmendur i Ligjit (LSHMAA) është në përputhje me nenin 4 paragrafi 1 i “Ligjit për Mediat” i cili ndalon publikimin, dmth transmetimin e përmbajtjes në media, për të rrezikuar sigurinë kombëtare, të nxisë përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, të thërrasë për agresion ushtarak ose konflikt të armatosur, si dhe nxit ose përhap diskriminim, intolerancë ose urrejtje në bazë të racës, gjinisë, fesë ose kombësisë.^[90] Ligji nuk parasheh përgjegjësi për kundërvajtje për vepër në kundërshtim ose gjobë. Por, ky Ligj nuk i trajton mediat online si media. Ky është një problem në praktikë dhe krijon një hapësirë të madhe për përhapjen e gjuhës së urrejtjes në internet, siç është rasti me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, i cili rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e transmetuesve, ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive sipas kërkesës dhe operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik që transmetojnë ose ritransmetojnë shërbimet programore të transmetuesve.

89. <https://avmu.mk/strucna-sluzba>

90. Paragrafi 2 i nenit përcakton: “Ndalimet e veçanta nga paragrafi 1 i këtij neni do të jenë në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së”.

LEGJISLACIONI PENAL I VENDIT

Analiza trajton gjuhën e urrejtjes si dukuri kriminale. U përmendën aspektet kriminalistike të tij, por duke marrë parasysh se është një fenomen i ri, pritët që së shpejti këto aspekte të zgjerohen. Edhe pse një fenomen i ri, autoritetet gjyqësore ndërkombëtare tashmë kanë zhvilluar një qëndrim dhe praktikë për trajtimin e gjuhës së urrejtjes, dhe kjo vlen veçanërisht për Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.^[91] Për më tepër, kjo praktikë ka ndihmuar në klasifikimin e gjuhës së urrejtjes, si sipas të mirave të mbrojtura, ashtu edhe sipas modus operandi. Kështu, nuk është e njëjta gjë nëse gjuha e urrejtjes është plasuar në kafene apo në publik - përmes mediave tradicionale ose rrjeteve sociale online.

Në legjislacionin maqedonas ka dispozita që e kriminalizojnë fjalën për shkak të përmbajtjes së veçantë. Ndalimet penale për gjuhën e urrejtjes janë të fokusuara në kriminalizimin e abuzimeve të lirisë së shprehjes që konsistojnë në: nxitjen e dhunës ose shkelje të tjera të lirive dhe të drejtave të barabarta; ose duke shprehur një qëndrim diskriminues ndaj të tjerëve. Veprat penale me të cilat gjuha e urrejtjes inkriminohet në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë janë: Rrezikimi i sigurisë nga neni 144 paragrafi 3 dhe paragrafi 5, “Ekspozimi i talljes me popullin maqedonas dhe pjesëtarët e komuniteteve” nga neni 179, “Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose intolerancës për arsye kombëtare, racore, fetare dhe të tjera diskriminuese” nga neni 319, “Pjesëmarrja në ushtri të huaja, polici, formacione paraushtarake ose parapolicie” nga neni 322–a paragrafi 4, “Përhapja e materialit racist dhe ksenofobik nëpërmjet një sistemi kompjuterik” nga neni 394–d, “Miratimi ose justifikimi i gjenocidit, krime kundër njerëzimit ose krime lufte” nga neni 407–a dhe “Diskriminimi

91. Por në mesin e teoricienëve ka edhe kritikë të respektuar të punës së Gjykatës të cilët sulmojnë veçanërisht “standardet e dyfishta” të Gjykatës kur vendoset për rastet e gjuhës së urrejtjes, veçanërisht kur sulmoheshin subjektet që simbolizojnë pushtetin shtetëror dhe për shkak të interpretimit plastik të “prirjes së keqe” apo “rrezikut të dhunës fizike” si kriter. Shih më shumë në: Sottaux, S., “Conflicting conceptions of hate speech in the ECtHR’s case law”, German law journal (2022), fq.1193-1211.

racor dhe diskriminimi tjetër” nga neni 417 paragrafi 3 i Kodit Penal.^[92] Krahas Kodit Penal si kodifikim në fushën e së drejtës penale materiale, ekzistojnë ligjet procedurale që mishërojnë rregullimin juridik lëndor, si: Ligji i Procedurës Penale, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe Ligji për Probacionin, për të cilët më detajisht do të diskutohet më poshtë.

Legjislacioni i brendshëm përfshin edhe aktet ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me ligjin, dhe si më e rëndësishmja ndër to në fushën e gjuhës së urrejtjes të kryer online, është Konventa e Këshillit të Evropës për krimin kibernetik, e cila përmban norma materiale, procedurale dhe norma për bashkëpunim ndërkombëtar. Dispozitat janë të përfshira edhe në legjislacionin material maqedonas, kryesisht në seksionin e Pjesës së përgjithshme të Kodit Penal ku përcaktohen termat bazë për këtë lloj krimi, si dhe veprat konkrete penale, por për të cilat do të diskutohet më poshtë.

Korniza ligjore vendase që rregullon fushën e krimit kompjuterik përfshin: Kodin penal, Ligjin e Procedurës Penale, Ligjin për Komunikimet Elektronike,^[93] Ligjin për Monitorimin e Komunikimeve,^[94] Ligjin për Tregtinë Elektronike,^[95] Ligjin për Menaxhimin Elektronik,^[96] Ligjin për Procedurën Kontestimore,^[97] Ligjin për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrimi elektronik^[98] Deklarata për një internet më të sigurt.

Në botë ekzistojnë disa parime të inkorporimit të këtyre normave në legjislacionin vendas, për shembull në Rumani dhe Tahiti,^[99] ku rregullimi i këtij problemi bëhet me ligj të veçantë që përmban dispozita materialo-juridike dhe procedurale-juridike, tërësisht të ndara nga ligjet konvencionale penale. Legjislacioni i brendshëm ruan qasjen kontinentale dhe normat që rregullojnë këtë çështje janë të inkorporuara në ligjet ekzistuese. Dispozitat materiale për veprat penale në fushën e

92. Ka ende një mosmarrëveshje midis teoricienëve nëse ky grup veprash duhet të përfshijë veprat nga neni 178 dhe neni 181 i Kodit Penal.

93. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.13/2005, 14, 55/2007, 98/2008, 83/2010, 13, 59, 123/2012, 23/2013.

94. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.121/2006, 110/2008, 4/2009, 116/2012.

95. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.133/2007, 17/2011.

96. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.105/2009, 47/2011.

97. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/2005, 110/2008, 83/2009, 116/2010.

98. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.34/2001, 98/2008.

99. Doracak për praktikantë ̑Krimi kompjuterik̑, Op. cit., fq.8.

krimit kompjuterik përmbahen në Kodin Penal dhe i referohen rreth 20 veprave penale,^[100] si dhe nenit 122 – Përcaktimi i segmenteve bazë të krimit kompjuterik, me këto pika: pika 15 – kartat e pagesave,^[101] pika 24 – pornografia e fëmijëve,^[102] pika 26 – sistemi kompjuterik^[103] dhe pika 27 – të dhënat kompjuterike.^[104]

100. Neni 144 - Rrezikimi i sigurisë, Neni 147 - Shkelja e konfidencialitetit të letrave ose dërgesave të tjera, Neni 149 - Keqpërdorimi i të dhënave personale, Neni 149-a - Parandalimi i aksesit në një sistem informacioni publik, Neni 157 - Shkelja e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, Neni 157-a - Shkelja e së drejtës së shpërndarësit të një sinjali satelitor të mbrojtur teknikisht, Neni 157-b - Pirateria e një veprave audiovizive, Neni 157-c - Pirateria e një fonogrami, Neni 193 - Tregimi i materialit pornografik për një fëmijë, Neni 193-a – Prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë për fëmijë, Neni 193-b – Joshja e tradhtisë bashkëshortore ose veprimtarisë tjetër seksuale të të miturit që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, Neni 251 – Dëmtimi ose aksesi i paautorizuar në një sistem kompjuterik, Neni 251-a – Krijimi dhe futja e viruseve kompjuterike, Neni 251-b – Mashtrimi kompjuterik, Neni 271 – Krijimi, prokurimi ose tjetërsimi i mjeteve të falsifikimit, Neni 274-b – Krijimi dhe përdorimi i një karte pagese false, Neni 279-a – Falsifikimi kompjuterik, Neni 286 – Shkelja e të drejtës së shpikjes dhe topografisë së regjistruar ose të mbrojtur të qarqeve të integruara, Neni 394-g – Përhapja e materialit racist dhe ksenofobik nëpërmjet një sistemi kompjuterik.

101. Kartat e pagesës nënkuptojnë çdo lloj mjeti pagese të lëshuar nga banka ose institucione të tjera financiare që përmbajnë të dhëna elektronike për persona dhe numra të gjeneruar elektronikisht që mundësojnë kryerjen e çdo lloj transaksioni financiar.

102. Pornografia e fëmijëve nënkupton material pornografik që përshkruan vizualisht akte të hapura seksuale me një të mitur ose një të rritur që duket të jetë i mitur, ose përshkruan një të mitur ose një të rritur që duket të jetë i mitur në një pozicion seksual të hapur, ose imazhe realiste që përshkruajnë veprime të dukshme seksuale me një të mitur ose përshkruan të miturin ose një të rritur që duket të jetë i mitur në një pozicion seksual të hapur.

103. Sistem kompjuterik nënkupton çdo pajisje ose grup pajisjesh të ndërlidhura, një ose më shumë prej të cilave kryejnë përpunim automatik të të dhënave sipas një programi specifik.

104. Me të dhëna kompjuterike nënkuptohet paraqitja e fakteve, informacioneve ose koncepteve në një formë të përshatshme për t'u përpunuar nga një sistem kompjuterik, duke përfshirë një program të përshatshëm për t'u vënë në funksionim nga sistemi kompjuterik.

LEGJISLACIONI VENDAS

I KUNDËRVAJTJES

Duke e shtjelluar tashmë Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, akti i radhës që është i rëndësishëm për t'u përmendur në aspektin e lirisë së fjalës është [Ligji për Qasje të Lirë në Informacion](#) nga viti 2019.^[105] Paraprakisht ka qenë në fuqi Ligji për Qasje të Lirë në Informata Publike.^[106] Në ligjin e ri, parashikohet se në veprimtarinë e poseduesve të informacionit sigurohet publiciteti dhe hapja dhe u mundësohet personave fizikë dhe juridikë të ushtrojnë të drejtën e aksesit të lirë në informacione me karakter publik. Mbjatësit e informacionit (autoritetet shtetërore), nga ana tjetër, janë të detyruar t'i ofrojnë publikut informacion për punën e tyre (shih nenin 2 të Ligjit). Vetëkuptohet se ka informacione të klasifikuara dhe informacione që për nga natyra e tyre nuk duhet të ndahen, por për këtë arsye neni 37 i ligjit përcakton se: “Punonjësi i poseduesit të informacionit që jep informacion të mbrojtur, nëse është i rëndësishëm për zbulimin e keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe sjelljeve korruptive, si dhe për parandalimin e kërcënimeve serioze për shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe rrezikimin e mjedisit.”

Gjuha e urrejtjes është e specifikuar në nenin 9 dhe nenin 10^[107] të [Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi](#) i vitit 2020 dhe është i ndaluar me dispozitat kundërvajtëse të nenit 41 të Ligjit: “Paragrafi (1) Gjobë në shumë prej 400 deri në 10.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik për të cilin organi kompetent ka konstatuar se ka kryer diskriminim në pajtim me

105. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 101/2019).

106. („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 13/2006, 86/2008, 6/10, 42/14, 148/15, 55/16 dhe 64/18).

107. “Neni 9 (Thirrja, nxitja dhe udhëzimi për diskriminim)

Thirrja, nxitja dhe udhëzimi i diskriminimit është çdo aktivitet që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë fton, inkurajon, udhëzon ose nxit për të diskriminuar mbi baza diskriminuuese.

Neni 10 (Ngacmimi)

(1) Ngacmimi është trajtim i padëshiruar i një personi ose grupi personash mbi baza diskriminuuese që ka si qëllim ose pasojë cenimin e dinjitetit ose krijimin e një mjedisi, qasjeje ose praktike kërcënuese, armiqësore, poshtëruese ose frikësuese.”

Opinion Research & Communications nga viti 2013, ku metodologjia ishte anketa telefonike me 800 qytetarë, me përfundimin se 97.3% e të anketuarve besojnë se gjuha e urrejtjes ndërmjet partive politike përfaqësohet në televizion si medium, kurse vetëm 48.7% prej tyre atë e kanë vërejtur edhe në rrjetet sociale.^[142] Në këndvështrimin e sotëm, pas 6–7 vitesh kjo përqindje me siguri do të rritej dhe për faktin se është rritur edhe numri i qytetarëve që përdorin rrjetet sociale në internet. Ndryshe, të anketuarit ishin nga bashkësitë etnike maqedonase dhe shqiptare dhe nganjëherë përgjigjet e tyre ishin në mospërputhje, por përqindja (rreth 72%) e të anketuarve nga grupet e ndryshme që besonin se niveli i gjuhës së urrejtjes ndërmjet partive politike është në rritje është pothuajse identike. Kur bëhet fjalë për sektorin e organizatave joqeveritare, në disa vende perëndimore (Itali) tashmë ka organizata joqeveritare që kanë përvojë në përdorimin e një mjeti ndërveprues rrjeti për mbledhjen, analizimin dhe vizualizimin e diskursit dhe reagimit të qytetarëve ndaj emigrantëve.^[143]

Gjuha e urrejtjes mund të interpretohet gjithashtu si një formë diskriminimi. Tashmë është thënë se Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi prek edhe temën e gjuhës së urrejtjes, për të cilën janë parashikuar dispozita penale. Ajo procedurë kundërvajtëse është paraparë në pajtim me nenin 27 të Ligjit, e cila inicohet para gjykatës kompetente me kërkesë të Komisionit për parandalimin e diskriminimit, si organ origjinal, i specializuar dhe i parashikuar me Ligj. Procedurë për kundërvajtje dhe sanksion për kundërvajtje zhvillon dhe shqipton gjykata kompetente për kundërvajtje (shih nenin 44). Shuma e gjobës llogaritet në përputhje me Ligjin për kundërvajtje (neni 43). Në vitin 2022 janë iniciuar 14 procedime për kundërvajtje^[144], ndërsa KPMD-ja ka dërguar njoftime në Prokurorinë Publike kompetente kur ka vërejtur në funksionimin vijues se në atë “rast” ka indikacione për kryerjen e veprës penale. Në kuadër të KPMD-së ekziston Departament i veçantë për analiza kërkimore, si dhe Sektori për analitikë, bashkëpunim kombëtar ndërinstitucional dhe bashkëpunim

142. Prezantim: „Hulumtim për gjuhën e urrejtjes ndërmjet përkrahësve të partive politike dhe politikanëve në Republikën e Maqedonisë“, Opinion research & Communications, Dhjetor 2013.

143. Poljak, M./ Hadžić, J./ Martinić, M. “ Govor mržnje u hrvatskom medijskom prostoru”, In Medias Res, Zagreb, 2020, fq.2714.

144. Raporti vjetor për vitin 2022, fq.38. Burimi: <https://kszd.mk/wp-content/uploads/2023/05/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD-%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98-2022.pdf>

ndërkombëtar. KPMD-ja mban një faqe interneti përmbledhëse ku publikohen raportet tremujore dhe vjetore për punën e tyre.^[145] Ndryshe, me Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, ekziston edhe mundësia e mbrojtjes gjyqësore-civile me padi në gjykatën civile të paraqitur si nga personi i diskriminuar, ashtu edhe me padi për mbrojtje nga diskriminimi në dobi të interesit publik (actio popularis). Kjo padi ngrihet nga shoqata, fondacione, sindikata apo organizata të tjera të shoqërisë civile dhe grupe joformale që kanë interes të ligjshëm.

Kur bëhet fjalë për Gjykatën Kushtetuese, në praktikën e mëparshme gjyqësore kushtetuese, mund të konstatohet një numër shumë i vogël i rasteve ku gjykata ka vendosur për mbrojtjen nga diskriminimi dhe të cilat më parë janë renditur në mënyrë kronologjike, dhe për gjuhën e urrejtjes si formë diskriminimi.^[146] Gjykata Kushtetuese deri më tani nuk ka deklaruar shprehimisht asgjë lidhur me këtë çështje.

Ligji për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale është relevant nëse nuk ka marrëveshje tjetër dypalëshe ose shumëpalëshe të ratifikuar nga shteti dhe që rregullon këtë materie. Ndiham juridike ndërkombëtare nga Kapitulli II i Ligjit është veçanërisht e rëndësishme si: ekzekutimi i veprimeve procedurale; dërgimi i informacionit spontan; shkëmbimi i informacionit dhe njoftimeve të caktuara; dorëzimi i kontrolluar; monitorimi i komunikimeve; bastisja e lokaleve dhe personave; sigurimi i përkohshëm i sendeve, pasurisë ose fondeve që kanë të bëjnë

145. <https://kszd.mk/%d0%b3%d0%be%d0%b4%d0%b8%d1%88%d0%bd%d0%b8-%d0%b8%d0%b7%d0%b2%d0%b5%d1%88%d1%82%d0%b0%d0%b8/>

146. “Në thelb, në terminologjinë kushtetuese nuk ka asnjë referencë të drejtpërdrejtë në kuptimin konceptual të gjuhës së urrejtjes, i vetmi drejtim në lidhje me këtë kategori juridike është referimi indirekt përmes mbrojtjes nga diskriminimi si formë e pjeshme gjatë zbulimit të gjuhës së urrejtjes... nga fryma e përcaktimit kushtetues, është padyshim e qartë se akti themelor legjislativ është krijuar në drejtim të nxitjes së bashkëjetesës, respektit të ndërsjellë, lirisë për vetëvendosje dhe ruajtjes së përcaktimit të identitetit individual të secilit në një tërësi bashkëjetese kohezive me një tendencë të qartë për të ndërtuar një shoqëri civile dhe demokratike; Gjë që sipas pasojës logjike të interpretimit do të nënkuptonte edhe mospërputhje kushtetuese në rastet e gjuhës së urrejtjes, që shprehet veçanërisht në vendin tonë, mbi bazën e përkatësisë kombëtare, fetare dhe/ose etnike.. Cit. Kuzmanovska, F., Aspektet ligjore- liria e shprehjes në lidhje me gjuhën e urrejtjes- mekanizmat ligjorë të disponueshëm për mbrojtje dhe parandalim”, Shoqata e Disleksisë - Ajshtajni, Shkup, 2018, fq.17-18. E disponueshme në: <http://disleksija.org.mk/wpcontent/uploads/2021/03/%D0%9F%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B0%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%82%D0%B8-%D0%BD%D0%B0-%D0%B3%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%80%D0%BE%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%BE%D0%BC%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%B0.pdf> (25,05,2023).

me një vepër penale. Instrumenti që duhet të përdorë organi i akuzës është një fletëthirrje (lutje). Dispozitat përkatëse janë: nenet 16 - 37, të vendosura në kreun II të ligjit.

Nga pikëpamja e Ligjit të Procedurës Penale ka rëndësi kapitulli ku parashikohen masat e posaçme hetimore. Megjithëse mundësia e përdorimit të PIM për krime të tilla është e kufizuar (sepse përveç akteve: Miratimi ose justifikimi i gjenocidit, krimet kundër njerëzimit ose krimet e luftës nga neni 407-a paragrafi 2 i KP dhe Pjesëmarrja në ushtri, polici të huaj, formacionet paraushtarake apo parapolicore nga neni 322a paragrafi 4 i Kodit Penal, shumica e tyre nuk janë krime për të cilat është paraparë dënim me burg prej së paku katër vjet, që është kusht ligjor për aplikimin e PIM dhe hipotetikusht mund të përgatiten, të jenë në ekzekutim e sipër ose që do të kryhet nga një grup i organizuar, bandë apo shoqatë tjetër kriminale), megjithatë, është e rëndësishme dispozita e Kodit Penal që lejon që provat e marra në këtë mënyrë të përdoren në procedura të tjera me lidhje subjektive ose objektive. Sipas Ligjit të Procedurës Penale, ruajtja e të dhënave bëhet ose me ruajtjen e përmbajtjes së tyre (pavarësisht formës) ose me ruajtjen e dëshmimeve nga të dhënat e transmetuara, që paraqet ruajtjen e trajektorës nëpër të cilën janë transmetuar të dhënat. Dispozitat përkatëse janë: neni 184, neni 198, neni 252 paragrafi 1, 4, 5 dhe 6.

Masa PIM më e rëndësishme - Monitorimi i komunikimeve kryhet nga një organ shtetëror. Realisht, pavarësisht dëshirës së ligjvënësit për pavarësinë e OTA-s si organ më vete nga Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e specializuar e Sigurisë Kombëtare e Ministrisë së Brendshme është ende një filtër për informacionin me interes të organit OTA. Në fakt, në reagimin sistematik të shtetit ndaj veprave të gjuhës së urrejtjes, rolin më domethënës duhet ta ketë policia. Gjegjësisht, sistemi i “butonit të kuq” për denoncimin e nxitësve të dhunës, duke përfshirë dhunën verbale për shkak të urrejtjes, funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kallëzim penal mund të dorëzohet edhe në mënyrë elektronike në departamentin e specializuar të MPB-së për krime kibernetike dhe forenzikë digjitale nëse bëhet fjalë për gjuhë të urrejtjes online, në adresën elektronike: cybercrime@moi.gov.mk.

Për të analizuar efektivitetin e dispozitave penale dhe për të përcjellë

mesazhin institucional se krimet e gjuhës së urrejtjes do të ndëshkohen, është e nevojshme të zhvillohen indikatorë përmes të cilëve do të matet vetë efektiviteti, kurse të njëjtat do të shërbejnë edhe për përcaktimin e politikave kombëtare për luftën kundër kriminalitetit të tillë. Treguesit në vetvete janë tregues cilësorë për të parë nëse është arritur qëllimi i normave juridike, por edhe sasiorë për të parë nëse shtrirja e normave juridike është ajo që duhet të ishte arritur, në përputhje me synimin e ligjvënësist. Duke marrë parasysh se çështja e krimeve të gjuhës së urrejtjes është specifike, treguesit duhet të jenë edhe përshkrues, gjë që mundëson vlerësimin nëse policia i përpunon në mënyrë adekuate raportet fillestare të krimeve të urrejtjes,^[147] si dhe nëse Prokuroria Publike i konverton ato në mënyrë adekuate në akuza për të mundësuar që gjyqtari të marrë një vendim meritator në masën e besimit të bazuar se krimi është kryer për shkak të disa paragjykitimeve.

Pothuajse çdo vepër e paramenduar penale mund të përbëjë një krim urrejtjeje. Por në një rast të tillë është i rëndësishëm elementi subjektiv – motivi. Nga ky aspekt penal juridik, reagimi institucional ndaj këtyre veprave penale do të ishte trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë për njohjen e këtyre krimeve dhe përdorimin e zgjidhjeve ligjore në mënyrë që autorët e këtyre veprave penale të ndëshkohen më rëndë. Ai përfaqëson një koncept të veçantë të reagimit të së drejtës penale ndaj akteve të urrejtjes me një potencial të madh parandalues.^[148]

Puna me tregues presupozon mbajtjen e statistikave për kriminalitetin e gjuhës së urrejtjes. Por nga pikëpamja e statistikave, është e nevojshme që softueri dhe të dhënat e krimeve të urrejtjes të gjenden kryesisht në gjykatë dhe jo në prokurori, sepse sipas Kodit Penal (shih nenin 106) dhe Ligjit të Procedurës Penale (shih nenin 543 - 546) është pikërisht

147. Prandaj është e nevojshme të hartohen rekomandime për Ministrinë e Brendshme që do të theksojnë qartë dallimin në gradimin e veprave të gjuhës së urrejtjes, në mënyrë që policia të dallojë kundërvajtjet nga veprat penale dhe nga raporti civilo-juridik i diskriminimit apo fyerjes dhe shpifjes.

148. Në vitin 2013 dhe 2014, Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë organizoi disa ngjarje me temën e luftës kundër krimit të urrejtjes. Fillimisht u organizuan trajnimet për trajnerët, më pas 4 trajnime kaskadë dyditore për çdo rajon gjyqësor të apelit, në të cilat merrnin pjesë më shumë se 80 pjesëmarrës në vit dhe në vitin 2015 u organizua një trajnim shtesë për trajnerët. Burimi: Arnaudova, A., „Ligje efektive dhe profesionistë të kualifikuar në përgjigje të gjuhës së urrejtjes“, Botim „16 Nëntori, Dita Ndërkombëtare e Tolerancës: tekste të zgjedhura“, AMSHA-OSBE, Shkup, 2015, fq.81.

gjykata ajo që mban evidencën penale. Mirëpo, shumë raste në të cilat ka punuar Ministria e Punëve të Brendshme dhe Prokuroria Publike nuk përfundojnë në Gjykatë, pasi procedura penale është ndërprerë për shkak të pengesave faktike apo ligjore për ndjekjen penale. Prandaj është e rëndësishme që edhe Ministria e Punëve të Brendshme edhe Prokuroria Publike të mbajnë shënime për aktet e gjuhës së urrejtjes dhe të ndajnë statistikatat e tyre. Në atë drejtim, me ndërmjetësimin e OSBE-së, vëmendje e veçantë i është kushtuar trajnimit të policëve për njohjen e krimit nga urrejtja, dhe si nënloj i këtij lloji të krimit - gjuha e urrejtjes, kështu që për momentin është parashikuar rubrika e veçantë për të regjistruar aktet e urrejtjes në formularin: “Procesverbal për pranimin e aplikimit”. Në të ardhmen do të jetë e nevojshme të futet edhe rubrika për - aktet e gjuhës së urrejtjes, duke marrë parasysh se ka një dallim të qartë ligjor me aktet e urrejtjes. Sa i përket krimit të gjuhës së urrejtjes, në bashkëpunim me sektorin joqeveritar dhe Qendrën për trajnimin e policisë në Shkup janë planifikuar të zhvillohen trajnime më të gjera për policët. Ligjëratat e para fillestare janë mbajtur qysh në vitin 2019.

Megjithatë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka një boshllëk në lidhje me regjistrimin dhe përpunimin e të dhënave për aktet e gjuhës së urrejtjes. Sa i përket organostrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme ka gjithashtu një departament të specializuar për mbajtjen e statistikave që merr të dhëna si nga Njësia e Analizës së Inteligjencës së Krimit në Shkup (ECRA) dhe nga departamentet e analizës së inteligjencës kriminale nga qytetet në brendësi. Problemi është se këto autoritete regjistrojnë të gjitha veprat e veçanta kundër rendit dhe qetësisë publike dhe veprat penale në aspektin e kohës, vendit, mënyrës, por më e rëndësishmja – edhe në aspektin e kualifikimit juridik. Megjithatë, ata fillimisht nuk e kanë idenë se cilat vepra penale janë të një lloji të veçantë të gjuhës së urrejtjes, në mënyrë që t'i shënjestrojnë ato dhe të japin raporte vjetore, dhe më pas, ata nuk regjistrojnë pikëpamjet e ndryshme të anëtarëve sipas të cilave janë normuar veprat penale në Kodin penal. Ky paraqet një problem real që mund të zgjidhej thjesht duke futur teknikisht parafratë (pikat) si grafikë të veçantë në tabelat elektronike në të cilat mbahen shënimet e akteve të kryera nga këto autoritete. Kualifikimet specifike dhe të sakta ligjore sigurisht që duhet të konfirmohen dhe vërtetohen nga prokuroritë publike gjatë procedurës penale, kështu që paraqitet si domosdoshmëri

në të ardhmen që të ketë një komunikim më aktiv ndërmjet Prokurorisë Publike, nga njëra anë, dhe ECRA (nga njëra anë përpunon 80 % të krimit në shtet) dhe OKRA nga ana tjetër. Kjo deri diku është përmbushur sepse ka obligim ligjor që Prokuroria Publike ta njoftojë Ministrinë e Punëve të Brendshme, nëse është parashtruese e kallëzimit penal, për epilogun e procedurës penale – vendimin meritore të prokurorit publik, dhe e cila shpresë gjithashtu përmban informacion për kualifikimin e saktë ligjor.

Ndër obligimet që i përmbush Prokuroria Publike në planin e regjistrimit dhe përpunimit të të dhënave për aktet e gjuhës së urrejtjes, bazë ka qenë futja e sistemit elektronik të “case management” në përputhje me Ligjin për Shërbimin Prokurorial^[149] dhe Rregulloren për punët e brendshme të prokurorive publike.^[150] Konkretisht, në vetë sistemin, analoge me AKMIS-in gjyqësor, ekziston një rubrikë e veçantë që duhet të aktivizohet kutiza nga ana e prokurorisë Publike kompetente nëse bëhet fjalë për vepër penale nga urrejtja. Në mënyrë të ngjashme, si me sistemin gjyqësor, por edhe me “procesverbalin e pranimit të aplikimeve” të Ministrisë së Punëve të Brendshme, do të jetë e nevojshme të ndërhyhet dhe të vendoset një rubrikë për aktet e gjuhës së urrejtjes, duke qenë se ekziston një dallim i qartë ligjor me aktet e urrejtjes. Gjithashtu, do të duhet të ndryshohet edhe Protokollin i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Prokurorisë Publike dhe Policisë Financiare nga viti 2014, i cili do të parashikojë detyrimin për njoftim të menjëhershëm verbal nga autoritetet ekzekutive drejt Prokurorisë Publike për ngjarje të një akti të kryer dhe zbuluar të gjuhës së urrejtjes,^[151] pavarësisht nëse ajo vepër cilësohet si “e rëndë” (Sipas Ligjit të Procedurës Penale, autoritetet e kanë këtë detyrim vetëm nëse është zbuluar një vepër penale që sjell dënim me burgim më të lartë se 4 vjet). Në vitin 2023 vërtet është nënshkruar një tjetër Protokoll për bashkëpunim mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut,^[152] por që ka të bëjë me thellimin dhe sqarimin e Protokollit fillestar të vitit 2014 dhe është domethënëse që në të është bërë një kategorizim i veprave penale, pra është konstatuar edhe kategoria e “veprave penale

149. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.62 e datës 20.04.2015.

150. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.190/2021 e datës 29.07.2021.

151. Shih nenin 8 të Protokollit.

152. https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2023/04/protokol-za-sorabotka-%D1%98ormsmvr_1.pdf

komplekse” për të cilat njësia organizative e Ministrisë së Punëve të Brendshme është e obliguar që menjëherë ta njoftojë Prokurorinë Publike për kallëzimin e pranuar. Këtu nuk thuhet nëse me krime të tilla do të trajtoheshin edhe format më të rënda të veçanta të krimeve të gjuhës së urrejtjes, kështu që ka vend për përsosje të Protokollit në atë drejtim, veçanërisht sepse me Protokollin e fundit u krijua një komision tetë anëtarësh. e cila do të trajtojë në mënyrë specifike “ndryshimet dhe plotësimet” e Protokollit. Në kuadër të këtij Komisioni dhe me të njëjtin qëllim dhe detyrë do të interpretohej edhe harmonizimi i metodave për regjistrimin dhe përpunimin e veprave të gjuhës së urrejtjes.

Për të punuar me efikasitet, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut urdhëroi të gjitha Prokuroritë Publike në vend që nga data 01.01.2023 të përditësojnë rregullisht dhe pa përjashtim lëndët në sistemin informativ “case management” duke ngarkuar vendimet e Prokurorisë Publike, të cilin sistem në veçanti prokuroritë e kanë përdorur që nga viti 2016, por trajnimi i të gjithë stafit për përdorimin e tij ka qenë i ngadaltë. Kjo gjë mori jetë dhe është vënë në praktikë.

Është e rëndësishme të kihet parasysh se është e mundur gjithashtu që edhe autoritetet dhe institucionet e tjera të grumbullojnë të dhëna dhe informacione të ndryshme. Për shembull, shërbimet shëndetësore dhe sociale mund të mbledhin informacione për viktimat dhe shërbimet që u ofrohen atyre, institucionet e arsimit mund të kenë të dhëna për veprat penale ose incidentet e gjuhës së urrejtjes në shkolla, kurse shërbimet e strehimit mund të kenë të dhëna për shkeljet e veprës penale të urrejtjes në zona të caktuara ose komplekse banimi. Është gjithashtu e nevojshme që qarqet shkencore të përcaktojnë korrelacionin ndërmjet faktorëve ekonomikë dhe kulturorë dhe gjuhës së urrejtjes në bazë të këtyre statistikave.^[153] Koordinimi i ngushtë ndërmjet ministrive dhe autoriteteve/institucioneve mund të çojë në zhvillimin e një qasjeje të gjerë strategjike nga autoritetet/institucionet, ku shumë autoritete/institucione qeveritare do të ishin të bashkuara në angazhimin e tyre për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive akteve të gjuhës së urrejtjes. Konkretisht,

153. Një studim i tillë është bërë edhe në R. e Italisë. Burimi: Poljak, Ibid, fq.2715. E disponueshme në: <http://www.centar-fm.org/in medias res/index.php/marko-poljak-jelena-hadzic-i-masa-martinic-govor-mrnje-u-hrvatskom-medijskom-prostoru> (22,05,2023).

në Republikën e Maqedonisë së Veriut tashmë funksionon Komisioni ndërministror i lartpërmendur në kuadër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili në të ardhmen mund të koordinojë ndërmjet institucioneve përkatëse për trajtimin e akteve të gjuhës së urrejtjes dhe që do të kryejë edhe rolin parësor para publikut me synim parandalimin dhe veprimin parandalues.

Tashmë është thënë se nga pikëpamja penologjike, probacioni (mbikëqyrja me kusht) dhe parandaluese janë mjete të mira për kontrollin e shkelësve të mëparshëm, por, për fat të keq, ende të pa praktikuar në një shkallë të konsiderueshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.^[154] Nga aspekti viktimologjik, pavarësisht ndryshimeve të bëra në procedurën penale^[155] që futi termin “viktimë”, në praktikë shteti ende nuk ka ngritur rrjetet institucionale për mbrojtjen dhe satisfaksionin në kohë të këtyre personave.

Nga pikëpamja e iniciativave qytetare, përvojat amerikane janë interesante dhe mund të aplikohen në mjedisin maqedonas. Në SHBA që 30 vjet më parë ka pasur praktika të organizimit të klubeve të darkës miqësore ku çdo pjesëmarrës është i detyruar të ftojë në restorant një mysafir i cili është i një race të ndryshme (ngjyra e lëkurës). Klube të tilla janë iniciativa të grupeve të shumta antiraciste.^[156] Ata janë të njohur për veprimet e tyre të fshirjes së grafiteve fyese nga muret e ndërtesave, praktikë që tashmë ka filluar në Maqedoni përmes organizatave të majta joqeveritare si “Solidarnost” dhe “Lenka”.

154. Legjisllacioni i BE-së i referohet edhe përdorimit të tyre, konkretisht Rekomandimi i Komitetit të Ministrave (2014) 3 i datës 19.02.2014 në Këshillin Europian në lidhje me trajtimin e kriminelëve të rrezikshëm “kur ka shumë mundësi që personi të kryejë përsëri një vepër të rëndë penale.”

155. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.120/2010.

156. Klanwatch, “Focused community action can help reduce hate crimes”, “Hate groups: Opposing viewpoints”, Greenhaven press, San Diego, California, 1999, p.150.

INTERNETI SI KARBURANT DHE SHKËNDIJË PËR RRITJEN E GJUHËS SË URREJTJES DHE RËNDËSIA E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR JURIDIK PËR TRAJTIMIN E VEPRAVE TË KRYERA ONLINE

Interneti është një sistem i gjerë i njësive kompjuterike të ndërlidhura, i përbërë nga miliona rrjete qytetare, private, publike, akademike, biznesi dhe qeveritare të lidhura me një sërë teknologjish të rrjeteve elektronike, pa tela dhe optike. Këto lidhje ekzistojnë në sajë të një sërë protokollelesh globale, ndër të cilët më i rëndësishmi nga pikëpamja e së drejtës penale është Protokollin i Internetit (IP). Rrjeti Global i Internetit (www) është një hapësirë informacioni, ku skedarët dhe burimet janë të disponueshme përmes Internetit.^[157] Baza e komunikimit përmes internetit është procesi i caktimit të një adrese për çdo pajisje të lidhur në internet. Kjo adresë e lejon pajisjen të lidhet dhe të komunikojë me çdo pajisje tjetër të lidhur në internet që përdor këtë skemë. Ky model (cilësim) zakonisht quhet adresë IP dhe mund të krahasohet me sistemin postar. Ai i lejon një personi të

157. Në kohën kur “web” po zhvillohej, tre specifika u përcaktuan për teknologjitë e Uebit: Uniform Resource Locator (URL), Hypertext Transfer Protocol (HTTP) dhe Hypertext Markup Language (HTML).

adresoje një paketë dhe ta lëshojë atë në sistem.^[158]

Interneti bëri të mundur krijimin e të ashtuquajturave rrjete sociale ose media për komunikim dhe ndërveprim të drejtpërdrejtë ndërmjet përdoruesve. Rrjetet e hershme të mediave sociale si AOL Chat Rooms, LiveJournal dhe MySpace u shfaqën në fund të viteve 1990. Faqet aktuale të internetit, të njohura sociale përfshijnë: Facebook, Twitter, LinkedIn, Instagram, Snapchat, YouTube, Google+, WeChat, Pinterest, Snapchat, Tumblr, Viber, WhatsApp, Wikipedia, TikTok, Reddit, V Kontakte në Rusi, Weibo në Kinë dhe të tjerë. Nxitja më e madhe për mediat sociale erdhi me prezantimin e telefonave inteligjentë, të cilët vitet e fundit kanë mundësuar komunikimin dhe publikimin^[159] për 3 miliardë përdorues, nga të cilët rreth 2 miliardë njerëz kanë një llogari në Facebook.^[160]

Popullarizimi i internetit quhet ndryshe edhe procesi i “digjitalizimit”. Përveç faktit që mediat sociale të internetit janë më të aksesueshme se mediat tradicionale, ato kanë shumë burime të përmbajtjes dhe shumë marrës të asaj përmbajtjeje, ndërsa mediat tradicionale si radio apo gazeta kanë vetëm një burim dhe shumë marrës. Dallimi më i madh midis mediave tradicionale dhe sociale është se mediat sociale i lejojnë të gjithë të krijojnë dhe të ndajnë përmbajtjen e tyre, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për një blog, foto, video ose përditësim statusi.

Por digjitalizimi jo vetëm që ka ndryshuar mënyrën se si njerëzit komunikojnë, por gjithashtu ka transformuar ndjeshëm dhe në mënyrë të pakthyeshme natyrën e gazetarisë dhe etikës. Ndryshimi i prizmit mediatik, nga një numër më i vogël subjektsh të mëdha në një numër

158. Pjesa tjetër e protokollit të komunikimit quhet Protokollit i Kontrollit të Transmisionit (TCP). TCP është një nga protokollet kryesore në rrjetet TCP/IP. Dhe ndërsa IP trajton vetëm paketat e të dhënave, TCP lejon dy host të krijojnë një lidhje dhe të shkëmbejnë rrjedhat e të dhënave. TCP garanton dërgimin e të dhënave dhe se kjo do të bëhet në të njëjtin rend në të cilin janë dërguar të dhënat. Shih më shumë në: Doracak për Akademitë për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë në EJI, „Luftëtarët e huaj terroristë“, Zyra e OKB-së kundër drogës dhe krimit, Vjenë, 2017, fq.31.

159. „Udhëzime praktike për përdorimin e mediave sociale nga gjyqtarët, Op. cit., fq.25.

160. Kjo është arsyeja pse qëndrimi i disa teoricienëve është shqetësues se është Facebook si një kompani që ka vetëm një qëndrim deklarativ ndaj “Rregullave të Sjelljes” të tij, ndaj ata akuzojnë kompaninë vetëm se ka një “qëndrim profitar” dhe i anashkalon këto rregulla kur ajo vjen deri te gjuha e urrejtjes. Burimi: Poljak, I bid, fq.2714. Kjo gjë mbështetet edhe nga informacionet nga të ashtuquajturit “cicëruesit”: <https://a1on.mk/world/haugen-fejsbuk-znae-kako-da-shiri-omraza-na-internet/>

të madh subjektsh të vogla që kanë një rol aktiv në informimin publik, reflektoi edhe në profesionalizmin dhe kuptimin e komunikimit publik nga gazetarët, veçanërisht në kontekstin e komunikimit digjital. Redaksitë bëheshin gjithnjë e më të vogla, pa një organizim të qartë dhe me kapacitete të kufizuara, gjë që çoi në një akumulim dhe transferim të kufizuar njohurish. Kështu që sot ka një numër të madh mediash online ku nuk ka asnjë gazetar profesionist. Roli universal i medias, për të edukuar, madje u degradua deri në atë pikë sa disa media filluan të dezinformojnë përmes “lajmeve të rreme”.^[161]

Pra, interneti është një medium shumëfishues shumë i fuqishëm për të mbetur “i paprekur”. Disa nga performancat e tij si “lajmet e rreme” mund të radikalizojnë sjelljen njerëzore, t’i bëjnë njerëzit të sillen më destruktivisht se zakonisht.^[162] Kjo u dëshmuua edhe me zgjedhjet e fundit presidenciale amerikane kur pas fushatës pati një sulm në Capitol Hill (Kongresi amerikan), kështu që në janar 2021 Twitter, Snapchat, Instagram dhe Facebook pezulluan profilet e kandidatit për president - Donald Trump (Twitter e bëri këtë me një “pezullim të përhershëm”, por e ndryshoi vendimin pas vetëm një dite)^[163] i cili dyshohej se ishte nxitësi i ngjarjeve të dhunshme.^[164] Për këtë gjest (Bill Gates) pati kritika publike dhe në drejtim të mbrojtjes së kohezionit në shoqërinë amerikane.^[165] Përndryshe, ka teoricienë që janë të mendimit se kufizimi i gjuhës së urrejtjes mund të rrisë legjitimitetin demokratik.^[166] I tillë ishte rasti me Reddit kur ndaloi/mbylli dy nga nën-plattformat e tij në vitin 2015 për zbatimin e politikës së re “kundër ngacimit”. Kjo dha rezultate pozitive, pasi gjuha e urrejtjes u reduktua deri në 80%, pavarësisht faktit se disa nga komentuesit kishin emigruar në nën-platforma të tjera të Reddit, ku

161. Burimi: Riçliev, Z. „Rekomandime për rritjen e integritetit dhe profesionalizmit të medias online”, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, 2016, fq.1

162. Psikologjia si shkencë thotë se njerëzit adoptojnë dhe shprehin qëndrime radikale për shkak të dëshirës së tyre të brendshme për të qenë më të pëlqyeshëm dhe sepse në botën dixhitale janë bërë më të guximshëm. Njerëzit në shfaqje të tilla demonstrojnë një ekzagjerim në bindjet e tyre për besueshmërinë e tyre si burim informacioni dhe pikëpamjesh politike. Pason një garë thirrjesh dhe bindjeje. Ky fenomen njihet gjithashtu si polarizim grupor. Burimi: Citron, K., D., “Hate crimes in cyberspace”, Harvard University Press, 2014, fq.63.

163. E disponueshme në: <https://www.bbc.com/news/technology-55569604> (23,05,2023).

164. E disponueshme në: <https://www.dailymail.co.uk/news/article-9120399/Donald-Trump-BANNED-Twitter-12-hours.html> (23,05,2023).

165. <https://www.livemint.com/news/world/bill-gates-says-social-media-bans-aren-t-answer-to-divisiveness-11613970373747.html> (23,05,2023).

166. Shih: Poljak, Op. cit., fq.2728.

me sa duket kishin adoptuar një “stil” të ndryshëm shprehjeje.^[167]

Në hapësirën kibernetike është më e lehtë të gjesh “shpirt binjakë” me bindje të ngjashme dhe nëse ka dallime mes tyre, ato minimizohen. Polarizimi në grup është më i dukshëm në aktivitetet e turmave kibernetike. Në nivel global, statistikat nga studimet dhe monitorimi i shkencëtarëve thonë se numri më i madh i komenteve “të papranueshme” (lexo: gjuha e urrejtjes) gjendet në Facebook,^[168] dhe numri më i madh i komenteve të tilla në raport me totalin e komenteve në atë rrjet social është në YouTube.^[169]

Kur bëhet fjalë për gjuhën e urrejtjes mes bashkëqytetarëve tanë në rrjetet sociale, nga hulumtimi i bërë në kuadër të një punimi shkencor,^[170] është konstatuar se kjo gjuhë e përdorur është e pranishme në të gjitha format dhe ndikon në krijimin e parakushteve për shfaqjen e krimit nga urrejtja. Mungesa e rregullimit dhe vetërregullimit kontribuon që gjuha e urrejtjes të përdoret veçanërisht në kushtet e mobilizimit intensiv politik, por edhe në komunikimin e përditshëm të përdoruesve të rrjeteve të tilla. Nga veçoritë e grupeve të mbrojtura si referenca, në rrjetet sociale në Maqedoni janë të pranishme: gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë fetare dhe etnike, gjuha e urrejtjes në bazë politike, për më tepër, në bazë të orientimit seksual, por edhe gjuha e urrejtjes mbi bazën e orientimit profesional, si dhe ndaj komuniteteve migrante. Gjuha tradicionale e urrejtjes shpesh sintetizohet dhe ka baza të shumta në të njëjtën kohë. Forma më eksplicite e gjuhës së urrejtjes shfaqet në bazë të orientimit seksual dhe si formë e re e gjuhës së urrejtjes është ajo e drejtuar ndaj migrantëve që kanë kaluar tranzit nëpër Maqedoni gjatë viteve të fundit.

Është e pamohueshme që teknologjia (lexo: interneti) i ka dhënë “krahë” gjuhës së urrejtjes. Prandaj, për të kuptuar modus operandi për kryerjen e akteve të gjuhës së urrejtjes në internet, duhet të ketë njohuri paraprake për atë teknologji, për mënyrat e komunikimit nëpërmjet

167. Ibid, fq.2714.

168. Rregullimi dhe vetërregullimi u krijua nga Facebook në vitin 2018 kur prezantoi mundësinë që çdo përdorues të shënonte një postim si “gjuhë urrejtjeje”, dhe në të njëjtin vit filloi të publikonte të dhëna për numrin e postimeve të hequra që njiheshin si “ gjuhë e urrejtjes”. Burimi: Ibid, fq.2726.

169. Ibid, fq.2713.

170. Punimi shkencor: „Gjuha e urrejtjes në rrjetet sociale në Republikën e Maqedonisë“ i Dejan Marolov dhe Strashko Stojanovski nga Universiteti @Goce Dellçev në Shtip.

internetit, respektivisht: Çfarë është “Gazetaria dembele”?; Çfarë është “Efekti i topit të borës?”; Çfarë janë “lajmet-qepë”?; Cili është efekti “ekodhoma” (hyrja në një rreth vicioz)?; Cili është fenomeni i “bombardimit me informacione online”? Përndryshe, ekzistojnë kategori të ndryshme të lajmeve të rreme që duhet të njihen nga praktikuesit.^[171]

171. Disa kategori lajmesh janë të rreme (dezinformata), ndërsa të tjerat i atribuohen informacionit të njëanshëm (lajme të pasakta). Ata të gjithë kanë një lidhje shumë të lirshme me të vërtetën dhe në thelb vazhdimisht synojnë të mashtrjnë. Kjo vlen si për lajmet konfuzive që mund të përmbajnë gjysmë të vërteta, ashtu edhe për “lajmet e qëllimshme mashtruese” që janë shpikur qëllimisht për të fituar para përmes numrit të klikimeve, për të shkaktuar konfuzion ose pakënaqësi, ose për qëllime të propagandës sensacionale. Këto histori zakonisht shpërndahen përmes faqeve të lajmeve mashtruese të krijuara për t’u dukur si marka “të vërteta” (ang. Imposter news sites) ose përmes faqeve të internetit të lajmeve të rreme. Ata shpesh përdorin imazhe video dhe grafike që në një farë mënyre janë të manipuluar. Burimi: „Udhëzime praktike për përdorimin e mediave sociale nga gjyqtarët, Op. cit., 28, 29.

KONVENTA PËR KRIM KIBERNETIK (KOMPJUTERIK) E KËSHILLIT TË EVROPËS

Baza për harmonizimin global të normave thelbësore dhe procedurale në fushën e krimit kompjuterik dhe provave elektronike është bërë nga Konventa për krimin kibernetik të Këshillit të Evropës IST182 e datës 23.11.2001.^[172] Ky akt është një nga të paktët që ka pasur shtrirje rajonale (për kontinentin e Evropës^[173] nga janë shtetet anëtare të organizatës ndërkombëtare - Këshilli i Evropës), një akt që ka shërbyer si frymëzim, madje edhe burim i ligjeve në vende të tjera të botës. Edhe pse më herët ka pasur përpjekje për të përcaktuar normat materiale që rregullojnë bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në fushën e luftimit të krimit kompjuterik,^[174] Konventa, për shkak të gjithëpërfshirjes, fleksibilitetit dhe mundësisë së inkorporimit të lehtë në legjislacionet kombëtare, është bërë një mekanizëm i njohur për komunikim të lehtë ndërmjet shteteve.

Siç u tha më parë, dispozitat procedurale në legjislacionin kombëtar në fushën e grumbullimit të provave në formë elektronike bazohen në Konventën për krimin kibernetik. Kështu, dispozitat procedurale që janë të përcaktuara aty janë pasqyruar në masë të madhe në procedurën tonë penale dhe në Ligjin për bashkëpunim ndërkombëtar në çështjet penale, si dhe në një sërë ligjesh të tjera që rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me komunikimet elektronike.^[175]

172. <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/0900001680081561>

173. Këshilli i Evropës miratoi Konventën për Krimin Kompjuterik në Budapest më 23 nëntor 2001. Gjithsej 58 vende janë nënshkruese të Konventës, nga të cilat 28 e kanë ratifikuar. Konventa u nënshkrua nga Republika e Maqedonisë më 23 nëntor 2001, u ratifikua më 15 shtator 2004 dhe hyri në fuqi më 1 janar 2005.

174. Shih: Doracak për praktikantë “Krimi kompjuterik”, Zvrlevski/Andonova/Millosheski, OSBE, Shkup, 2014, fq.7.

175. Shih më shumë në: Koneska, M./Millosheki, V./Markoski, A., „Bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet penale: Doracak për praktikantë“, OSBE, Shkup, 2016, fq.32.

Ajo që është edhe më e rëndësishme, në vitin 2003 Këshilli i Evropës miratoi “Protokollin Shtesë të Konventës për krimin kibernetik, lidhur me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike të kryera nëpërmjet një sistemi kompjuterik (ETS Nr. 189)”.^[176] Me këtë Protokoll Shtesë, u përcaktua se çfarë përbën material racist ose ksenofobik (shih nenin 2 paragrafi 2). Neni 8 i Protokollit Shtesë, i titulluar: “Marrëdhëniet ndërmjet Konventës dhe këtij Protokollit” përcakton se: “Nenet: 1, 12, 13, 22, 41, 44, 45 dhe 46 të Konventës do të zbatohen, mutatis mutandis, të këtij protokollit të Konventës. Në pjesën tjetër, ky Protokoll Shtesë është në shumë aspekte i ngjashëm me Vendimin Kornizë të Bashkimit Evropian për luftimin e formave të caktuara të shprehjes së racizmit dhe ksenofobisë me ndihmën e të drejtës penale të 28 nëntorit 2008, 2008/913/JHA.^[177] Ashtu si në atë akt dhe me Protokollin Shtesë, shtetet anëtare marrin përsipër të kriminalizojnë veprime të shumta të motivuara nga nxitja racore ose ksenofobike, sipër shembull: “kërcënimi i motivuar racor ose ksenofobik”.^[178]

Dispozitat procedurale të Konventës për krimin kibernetik janë të përcaktuara në nenin 14 deri në nenin 22, përkatësisht: fushështrirja e dispozitave procedurale, kushtet dhe garancitë për ruajtjen e shpejtë të të dhënave kompjuterike të ruajtura, për dhënien e urdhërit për bastisjen dhe sekuestrimin e të dhënave të ruajtura kompjuterike, për mbledhjen e të dhënave kompjuterike në kohë reale, për të përgjuar të dhënat e përmbajtjes dhe juridiksionin.^[179]

Bashkëpunimi ndërkombëtar sipas Konventës trajtohet në 6 nene, përkatësisht: parimet e përgjithshme lidhur me bashkëpunimin

176. <https://edoc.coe.int/en/cybercrime/6559-convention-on-cybercrime-protocol-on-xenophobia-and-racism.html>

177. Konventa e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik së bashku me Protokollin Shtesë përfaqësojnë themelin në bazë të së ciit Bashkimi Evropian ka miratuar disa direktiva që rregullojnë këtë çështje.

178. Neni 4 parashikon: “Çdo palë duhet të marrë masa ligjore dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar si vepra penale sipas legjislationit kombëtar të palës, nëse vepra është kryer me dashje dhe në mënyrë të paligjshme, sjelljet e mëposhtme: kërcënimet nëpërmjet një sistemi kompjuterik, me praninë e tipareve juridike të një vepre të rëndë penale të përcaktuar në legjislationin e saj të brendshëm, kundër: (i) personave për shkak të përkatësisë në një grup, të dalluar nga raca, ngjyra, origjina ose origjina kombëtare ose etnike, si dhe përkatësia fetare, nëse përdoret si justifikim për ndonjë nga këta faktorë, ose; (ii) një grup personash që dallon nga cilado prej karakteristikave të lartpërmendura.”

179. <https://rm.coe.int/1680081561>

ndërkombëtar; ekstradimi; parimet e përgjithshme të ofrimit të ndihmës së ndërsjellë; informacion spontan; procedura në lidhje me kërkesën për ndihmë të ndërsjellë në mungesë të instrumenteve të vlefshme ndërkombëtare; dhe konfidencialitetin dhe kufizimin e përdorimit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në përputhje me Konventën për krimin kibernetik zbatohet në bazë të disa parimeve:

1. “Parimi i ruajtjes ekspeditive të të dhënave të ruajtura kompjuterike.”

Kjo do të thotë që të dhënat që kërkohen duhet të ruhen menjëherë, sepse ato i nënshtrohen kontaminimit të shpejtë, kryesisht duke i fshirë nga sistemi në përputhje me rregulloret kombëtare. Diapazoni kohor i ruajtjes varion nga 6 muaj deri në 2 vjet;

2. “Parimi i zbulimit të shpejtë të të dhënave të ruajtura të transmeteshme”. Ky është një nga parimet më të rëndësishme mbi bazën e të cilit mund të kryhen me sukses procedurat para-hetimore dhe hetimore në një çështje penale të caktuar. Gjegjësisht, zbulimi i shpejtë i të dhënave të ruajtura - adresa IP është me përfitim të madh për zhvillimin e suksesshëm të hetimit, veçanërisht kur komunikimi vazhdon përmes një operatori tjetër për të marrë lehtësisht dhe shpejt pozicionin apo vendndodhjen gjeografike përfundimtare të adresës IP të fundit të përdorur;

3. “Parimi i ndihmës së ndërsjellë në lidhje me aksesin në të dhënat e ruajtura kompjuterike me pëlqimin paraprak ose kur ato janë të disponueshme publikisht”; (Këtu nuk nevojitet ndonjë shpjegim i veçantë).

4. “Parimi i aksesit ndërkufitar në të dhënat e ruajtura kompjuterike me pëlqimin paraprak ose kur të dhënat e tilla janë të disponueshme publikisht”. Shpesh, krijuesi i të dhënave ndodhet në territorin e një vendi, kurse vetë të dhënat në territorin e një vendi tjetër, kështu që nëse ato të dhëna janë të disponueshme publikisht (ato nuk i përkasin kategorisë së të dhënave të mbrojtura), autoritetet e vendit domicil mund të kenë akses të drejtpërdrejtë në ato të dhëna. Si shembull i kësaj janë telefonat celularë inteligjentë të cilët janë futur në një llogari të caktuar të postës elektronike në ueb ose në një llogari të rrjetit social, kështu që nëse janë të hapura, atëherë është e mundur të kërkoni nëpër to dhe të mblidhni prova edhe pse ato prova nuk ruhen në memorien e telefonit, por ruhen

në një bartës të dhënash jashtë vendit. Në rastin e kundërt, për mbledhjen e provave do të nevojitej pëlqimi paraprak nga shteti ku janë të ruajtura këto të dhëna;

5. “Parimi i ndihmës së ndërsjellë në mbledhjen e të dhënave të transmetueshme në kohë reale”. Marrja e të dhënave të transmetueshme në kohë reale është një mënyrë për të gjurmuar menjëherë dhe në kohë reale personin e kërkuar dhe;

6. “Parimi i ndihmës së ndërsjellë në lidhje me përgjimin e të dhënave përmbajtësore”. Kjo dispozitë lidhet me aplikimin e masave PIM nga Ligji i Procedurës Penale (LPP), përkatësisht neni 252 paragrafi 1 pika 4 i LPP-së, e cila mundëson inspektimin dhe kërkimin e fshehtë në një sistem kompjuterik në një situatë ku ai është ende aktiv dhe kur mund të shihet lehtësisht se cili person krijon, përpunon ose merr të dhënat.

Dispozita të rëndësishme të Konventës janë nenet 16 dhe 17 sepse ato i referohen instrumentit special, të ashtuquajturit “Rrjeti 24/7”, i krijuar nga neni 35 i Konventës. Sipas këtyre dispozitave, shtetet nënshkruese janë të detyruara të caktojnë një person - pikë kontakti, i cili do të jetë i disponueshëm 24/7 dhe në raste emergjente do të veprojnë me kërkesë të një shteti tjetër që synon ngrirjen e shpejtë të të dhënave brenda 90 ditëve, si dhe zbulimin e tyre të pjesshëm tek pala e interesuar në mënyrë që të mund të ndjekë rrugën e informacionit dhe të ofrojë asistencë tjetër teknike të nevojshme. Një ndihmë e tillë do të përfshijë lehtësimin ose, nëse lejohet nga ligji dhe praktika e brendshme, zbatimin e drejtpërdrejtë të masave të mëposhtme: 1) ofrimin e këshillave teknike; 2) ruajtjen e të dhënave në përputhje me nenet 29 dhe 30 të Konventës; 3) mbledhjen e provave, sigurimin e informacioneve ligjore dhe 4) gjetjen apo lokalizimin e të dyshuarve. Me këtë instrument, dispozitat e Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale^[180] nuk derogohen, por vetëm përfitohet në kohë që këto të dhëna të ruhen.

180. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 77/2021 (06.04.2021)

ASPEKTET KRIMINALISTIKE NË MBLEDHJEN E PROVAVE (DËSHMIVE) PËR VEPRAT E GJUHËS SË URREJTJES TË KRYERA ONLINE

Jetesa moderne e varur nga teknologjia shkakton gjurmë elektronike. Kjo do të thotë se nëse do të duhej të sigurohen prova të tilla, atëherë është e nevojshme të zbulohen burimet e tyre dhe vendi ku janë dërguar. Qëllimi është që të përcaktohen me saktësi marrëdhëniet subjektive dhe prania e personave të përfshirë në komunikimin elektronik, dhe cilët persona janë në interes të organeve ligjzbatuese për zbardhjen e ngjarjes penale juridike, respektivisht përcaktimin e roleve të tyre si autorë të veprave penale, ndihmës, nxitës, viktima apo dëshmitarë. Këtu lindin dy probleme themelore, së pari - cila është përmbajtja e të dhënave dhe si të arrihet tek ato; dhe së dyti - ku ruhen ato të dhëna. Përmbajtja e të dhënave është faktikisht provë në çështjen penale.^[181]

Një mbledhje e shpejtë dhe efikase e provave është thelbësore. Sa më shumë zvarritet procedura, aq më shumë ka rrezik që të mos gjenden provat e kërkuara. Duhet të nisemi nga fakti se fshirja e përmbajtjes së dorëzuar ose e ndonjë postimi tjetër nuk do të thotë që këto të dhëna nuk janë përgjithmonë të disponueshme për të tjerët, ose se ato nuk mund të gjenden ose gjurmohen nga operatori i shërbimit të internetit, ose nga një përdorues tjetër në formë origjinale ose të modifikuar. Është e rëndësishme të thuhet më shumë për operatorët e shërbimeve të internetit (ISP) në mënyrë që të kapet tabloja e përgjithshme e asaj se çfarë përballen hetuesit në një procedim penal në të cilin duhet të merren prova elektronike.

181. Koneska/Milosheski/Markoski, Op. cit., fq.31.

Operatorët e shërbimeve të internetit (ISP) fillimisht filluan të shfaqen në fund të viteve 1980 dhe fillim të viteve 1990. Këto janë kompani private që u ofrojnë përdoruesve akses në internet dhe shërbime përmes internetit.^[182] Ekzistojnë disa lloje të ndryshme të operatorëve të shërbimeve të internetit në varësi të shërbimit që ata ofrojnë, gjegjësisht nëse është akses në internet, e-mail, hosting i shërbimit të internetit, shërbimi i informacionit, rrjetet sociale dhe shërbime të tjera të internetit.^[183]

Ofruesit e shërbimeve hosting ofrojnë shërbim online për transferimin e skedarëve të postës elektronike përmes protokollit FTP, shërbime hosting në internet, makina virtuale, Cloud (Re)dhe serverë fizikë. Operatorët e shërbimeve të Transferimit mundësojnë shërbimet e internetit që ofrojnë sasi të mëdha të gjerësisë së brezit të nevojshëm për të ndërlikuar operatorët e hostingut dhe operatorët e shërbimeve të internetit.^[184] Operatorët e shërbimeve virtuale të internetit (VISP), nga ana tjetër, ofrojnë për të blerë shërbime nga operatorët e tjerë të shërbimeve të internetit në mënyrë që t'u ofrojnë përdoruesve qasje në internet. Operatorët e internetit falas (freenets) ofrojnë shërbim falas të aksesit në internet dhe shpesh shfaqin reklama ndërsa përdoruesit janë të lidhur.^[185]

Fotografia e madhe është se hapësira kibernetike nuk është më një enklavë ligjore në të cilën mund të veprohet lirshëm dhe në mënyrë të pakontrolluar. Gjuha e urrejtjes, e cila shpesh është një prelud i akteve

182. Këta operatorë interneti i lejojnë klientët të lidhen me internetin dhe të aksesojnë shërbimet në internet. Shpesh herë, operatorët e shërbimeve të internetit janë kompani që ofrojnë shërbime telekomunikacioni, duke përfshirë komunikimin në internet, aksesin e të dhënave dhe lidhjen telefonike. Shumica e kompanive telefonike tani operojnë si operatorë interneti, të cilat mund të jenë komerciale, jofitimprurëse, private ose në pronësi të përbashkët. Disa nga shërbimet e operatorëve të internetit përfshijnë aksesin në internet, regjistrimin e domenit, hostimin e emrit të domenit, aksesin me telefon, aksesin në linjën me qira dhe bashkëvendosjen.

183. Operatorët e lidhjeve në internet ofrojnë shërbimet e tyre nëpërmjet teknologjive që ofrojnë lidhje interneti. Lidhja në internet ose akses në internet mund të sigurohet nëpërmjet kabllove me fibra optike (FIOS), DSL (Digital Subscriber Line) ose satelitit. Një numër i ofruesve të aksesit në internet gjithashtu ofrojnë e-mail dhe shërbime shtesë për hostimin e shërbimeve të caktuara. Burimi: Udhëzues (i shkurtër) për prokurorë „Sigurimi i provave në formë elektronike nga operatorët ndërkombëtarë dhe vendas të shërbimeve të internetit“, Stoilkovski, M./ Cvetanovski, J., Shoqata e Prokurorëve Publikë të R. së Maqedonisë dhe OSBE - misioni në Shkup, Shkup, 2017, fq.9.

184. Njësoj.

185. Njësoj, fq.10.

të urrejtjes, është tashmë e jashtëligjshme nga Konventa e Këshillit të Evropës për krimin kibernetik. Në parim, çdo gjë që është e ndaluar në hapësirën reale tani është e ndaluar në hapësirën virtuale.^[186]

Kriminologu Karanović do të thotë: “Përgjegjësia penale është termi suprem sintetik i së drejtës penale, por në përcaktimin e saj duhet të njihet mirë përmbajtja e brendshme psikike dhe kjo pasi të jetë perceptuar veprimi fizik dhe pasoja e shkaktuar. Për këtë qëllim, si provë përdoren deklaratat e dëshmitarëve, deklaratat e autorit, të dhënat për atë person, përcaktimi i faktorëve objektivë dhe provat materiale”.^[187] Pyetja është se si të përdoret interneti për të siguruar ato prova? Për këtë do të flitet më shumë në kapitullin vijues.

Zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë dhe përdorimi i gjerë në të gjitha sferat e jetës shoqërore e gjeti artikullimin e saj në ekzekutimin e veprave kriminale. Mënyra e komunikimit është duke u transformuar, po digjitalizohet. Në procesin e përcaktimit të përgjegjësisë penale, provat rrethore janë shpesh më të rëndësishme, dhe kjo vlen veçanërisht për aktet e gjuhës së urrejtjes si vepra-produkt i ideologjive dhe “akteve mesazhore”.^[188] Domethënë, se çfarë diçka në një rast konkret e ka nxitur dhe aktivizuar veprimtarinë njerëzore dhe në cilin drejtim është drejtuar, mund të konstatohet duke analizuar rrethanat që i kanë paraprirë kryerjes së veprës penale, si dhe ato pas kryerjes së veprës penale dhe baza e tipareve të karakterit të autorit të krimit. Ekzekutimi i veprës penale ndodh në proceset mendore, dhe perfeksionohet nga veprimi fizik që manifestohet në botën fizike jashtë.

Bazimi i së drejtës penale në veprën penale nuk nënkupton anashkalimin e atyre elementeve subjektive që ngrenë kuptimin objektiv dhe peshën e veprës penale, siç janë qëllimi i veçantë, motivi (motivimi) apo qëllimi i kryerësit. Ato nuk përfaqësojnë elemente thjesht subjektive të fajit të autorit,

186. Zhivanovski, N., „Disa aspekte të filozofisë juridike evropiane dhe amerikane në lidhje me lirinë e fjalës dhe gjuhës së urrejtjes dhe reflektimet e tyre në internet“, “16 NËNTORI dita ndërkombëtare e tolerancës: tekste të zgjedhura“, AMSHA-OSBE, Shkup, 2015, fq.14.

187. Karanović, Op. cit., fq.31.

188. Ato janë krijuar për të përcjellë një mesazh jo vetëm për viktimën, por edhe për një grup të tërë, i cili në sytë e autorit të krimit është i varur në shoqëri. Mesazhi, nga ana tjetër, duhet të shkaktojë një ndjenjë shqetësimi, cenueshmërie dhe tensioni midis anëtarëve të atij grupi. Burimi: Chakraborti N./Garland, J., “Hate crime: Impact, Causes and Responses”, SAGE, Los Angeles, 2008, fq. 14.

por shndërrohen në elementë të padrejtësisë objektive të krimit.^[189]

Ekzistojnë gjithashtu një sërë opsionesh të softuerëve në posedim dhe teknikash “online” në dispozicion të terroristëve për të mbrojtur sigurinë e të dhënave dhe aktiviteteteve të tyre. Disa kërkime kanë treguar se komunikimi përmes kanaleve “normale” (e-mail, etj.) duke përdorur teknika të fshehta të enkriptimit, si steganografia^[190] dhe filigrani i fshehur, është ende një opsion. Këto teknika, kur zbatohen me enkriptim, krijojnë sfida serioze për inteligjencën, organet e zbatimit të ligjit dhe autoritetet prokuroriale. Një teknikë tjetër është Tor,^[191] e cila është një shfletues uebi i referuar shpesh si “web i thellë” ose “web i errët”. Është një pjesë e internetit që nuk është e indeksuar nga motorët e kërkimit, si p.sh. - Google. Tor kodon lidhjet për të penguar mundësinë e gjurmimit të aktivitetit në Internet. Në situatat kur enkriptimi nuk është i mundur, si p.sh. në një kanal të pasigurt, terroristët përdorin teknika të tilla si “chaffing” (ngacmim, shaka) dhe “winnowing” (zgjedh, depërton).^[192]

189. Fenomeni kriminologjik i „Luftëtarëve të huaj terroristë – LHT” do të merrej si shembulli i parë i abuzimit me mjeshtëri të internetit për shkak të urrejtjes. Në lidhje me metodikën kriminalistike për kryerjen e hetimeve për krimet e LHT, është e nevojshme të merrret parasysh ndikimi i internetit në gjeneratën e fundit të luftëtarëve të rekrutuar. Sa i përket ndikimit të internetit në krimet e gjuhës së urrejtjes, u përmend më lart, por duhet shtuar se përhapja e radikalizimit në mediata sociale është diçka që shqetëson gjithnjë e më shumë, kështu që në vitin 2020 flitej për një numër prej rreth 90 mijë llogarish në Twitter, të kontrolluara nga organizata terroriste - ISIS për të profilizuar dhe rekrutuar të rinj për të shkuar në luftë ku “hashtags” janë armët e reja. Ashtu si me grupet e tjera, është dëshmuar e vështirë në praktikë për hetimet “online” që të gjurmohen anëtarët e ISIS-it për shkak të mjeteve teknologjike që ata përdorin si: aplikacionet e kriptomit, platformat e mediave sociale dhe platformat e mesazheve të menjëhershme të koduara. Rreth 10 vjet më parë, disa media raportuan se ISIS kishte prodhuar një manual për luftëtarët e tij të titulluar “Si të postoni në Twitter në mënyrë të sigurtë pa i dhënë vendndodhjen tuaj sekrete Agjencisë së Sigurisë Kombëtare të SHBA”, i cili shpjegon se si të shmangët survejimi. Shih: <http://securityaffairs.co/wordpress/47243/terrorism/covert-communications-terrorists.html>.

190. Steganografia është të dhëna të fshehura brenda të dhënave - për shembull, fshehja e një skedari teksti brenda një imazhi. Steganografia është një teknikë enkriptimi që mund të përdoret në lidhje me kriptografinë si një metodë jashtëzakonisht e sigurt për mbrojtjen e të dhënave.

191. Shkurtesa nga gjuha angleze për “The Onion Router”.

192. Në komunikimet digjitale, këto teknika i lejojnë dërguesit të dërgojë një mesazh pa enkriptim, si tekst i thjeshtë, me marrësin dhe dërguesin që ndajnë një çelës të përbashkët sekret që ata përdorin për verifikim. Me këtë metodë, konfidencialiteti i mesazhit sigurohet nga një palë e tretë, e cila njëkohësisht dërgon një mesazh të krijuar qëllimisht përmes të njëjtit kanal si dërguesi. Burimi: Doracak për Akademitë ..., „Luftëtarët e huaj terroristë”, Op.cit., fq.30.

SIGURIMI I PROVAVE (DËSHMIVE) NË FORMË ELEKTRONIKE

Zhvillimi dinamik i mjeteve teknologjike kërkon në mënyrë të pashmangshme një gatishmëri specifike të organeve ligjzbatuese në procesin e zbulimit të autorëve të krimeve. Sigurimi i të dhënave kompjuterike që mund të përbëjnë prova në një procedim penal të caktuar nuk është gjithmonë i thjeshtë. Përkundrazi, në shumicën e rasteve, ajo që mund të jetë prioritet për autoritetet vendase, mund të mos jetë kështu për operatorin e huaj të shërbimeve të internetit nga ku duhet të sigurohen të dhënat.^[193] Për më tepër, secili prej këtyre operatorëve ka rregulloret dhe protokollet e veta që përputhen me kornizën ligjore të vendit në të cilin janë regjistruar dhe vepronë.

Por, para se të futemi në temën e procedurave tek operatorët e huaj të internetit, fillimisht, siç u tha, duhet të merret informacioni për faktin se ku ka nisur komunikimi dhe ku ka përfunduar komunikimi ndërmjet pajisjeve elektronike. Kjo realizohet në dy mënyra. Së pari, me zbulimin fizik të pajisjes elektronike, e cila është një mënyrë më e ndërlikuar dhe ka më pak gjasa për t'u zbuluar, sepse duhet të respektohen procedurat e Ligjit të Procedurës Penale për konfiskimin e sendeve me të cilët është kryer vepra penale, dhe më pas - kryerja e ekspertizës së telefonit nga ana e departamentit të specializuar pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa gjithmonë mbetet vështirësia për të përcaktuar nëse kjo pajisje elektronike, e cila hipotetikisht i është marrë autorit, është përdorur realisht nga autori në momentin kritik. Mënyra e dytë është duke zbuluar të dhënat e paracaktuara të adresimit IP të ofruara nga operatori përkatës i telekomunikacionit përmes të cilit operator, autori i veprës hyn në rrjet ose në të ashtuquajturën “adresa MAS”. Atëherë prokuroria Publike është e sigurt se një telekomunikacion ose transferim i të dhënave është bërë përmes një pajisjeje të caktuar elektronike.^[194]

193. Stoilkovski/Cvetanovski, Op. cit., fq.41.

194. Koneska dhe të tjerë., Op. cit., fq.31.

Pra, një nga fazat e para të hetimit në përcaktimin e autorëve që janë përgjegjës për krimet e gjuhës së urrejtjes të kryera “online” është gjurmimi i adresave IP. Këtu duhet të merret parasysh edhe dukuria e “forum-shopping”, kur autorët zgjedhin në mënyrë strategjike vendndodhjen për vendosjen e një informacioni të tillë, të cilat vendodhje digjitale paraqesin një “host”, në vendet me legjislacion të favorshëm për “mosndëshkim”.^[195]

Ndoshta dëshmia më e rëndësishme në mbledhjen e provave digjitale është vetëm në formën e të dhënave jo të përhershme të përfshira në memorien RAM të kompjuterit (Random Access Memory).^[196] Nëse kemi të bëjmë me një rast “cybermob”, monitorimi i adresave IP ndonjëherë duhet të jetë më i gjerë në fushëveprim dhe i sinkronizuar. Gjegjësisht, format e internetit përmes të cilave ekstremistët komunikojnë, të ashtuquajturat “chat room” nga vitet 1990 ku numri i korrespondentëve mund të ishte me dhjetëra persona. Në këto forume ekzistonte një hierarki e qartë. Më i larti ishte personi që zotëronte forumin dhe tek i cili ishte regjistruar domeni. Ai kishte de facto kontroll mbi aspektet teknike të faqes së internetit, duke përfshirë fuqinë për të fshirë mesazhet dhe postimet e njerëzve të tjerë dhe për të pranuar anëtarë të rinj. Nën drejtimin e tij ishin administratorët, ose moderatorët. Ata kishin shumicën e kompetencave të pronarit, përveç aftësisë për të fshirë plotësisht forumin. Mund të ketë edhe një hierarki midis administratorëve, kështu që administratorët më të rëndësishëm mund të kenë zëvendësit e tyre.^[197] Hetuesi në Ministrinë e Punëve të Brendshme apo në “Qendrën Hetimore” të Prokurorisë Themelore Publike do të duhet të hedhë dritë mbi atë strukturë.

195. McGonagle, T., “The Council of Europe against online hate speech: Conundrums and challenges, EXPERT PAPER”, University of Amsterdam, 2013, p.27.

196. Qasja tradicionale e “fikjes së energjisë” humbet në sasi të mëdha të të dhënave jo të paqëndrueshme të vendosura në memorie, të cilat mund të humbasin. Sot, hetuesit përballen në mënyrë rutinore me realitetin e kriptimit të sofistikuar të të dhënave, si dhe me mjetet e hakerimit dhe malware që mund të ekzistojnë vetëm në memorie. Nëse një kompjuter është i kyçur, maksimalisht rekomandohet që të përdoren njohuritë e ekspertëve të mjekësisë ligjore kompjuterike (forenzika), pasi mbyllja e kompjuterit mund të rezultojë në humbjen e çdo prove të aktivitetit kriminal. Megjithatë, nëse kompjuteri është i ndezur, por ka softuer shkatërrues (formatim, fshirje, heqje ose pastrim të informacionit), kompjuteri duhet të fiket (të fiket nga energjia elektrike) menjëherë për të ruajtur atë që ka mbetur në pajisje. Doracak për Akademitë për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë në EJJ: „Luftëtarët e huaj terroristë“, Op.cit., fq. 50.

197. Stern, J./Berger, J.M., “ISIS the state of terror”, Harper Collins Books, NY, 2015, fq.129.

Historikisht, për arsyet se në SHBA është më efektive të kesh një server të sigurt, madje edhe Al Kaeda ka krijuar forume të bazuara në serverët amerikanë. Por forumet ekstremiste kanë gjithashtu rrethet e tyre të brendshme. Disa fusha kryesore janë të kufizuara vetëm për anëtarët e besuar, të cilët janë të përfshirë si në planet sekrete, ashtu edhe në planet e ardhshme të organizatës. Pavarësisht kësaj strukture, forumet rezultuan të jenë shumë të cenueshme dhe lehtësisht të depërtuara nga shërbimet e inteligjencës dhe sigurisë, të cilat depërtuan në to dhe zbuluan informacione të dobishme, ose mbyllën forumet. Për këto arsye, kohët e fundit, xhihadistët kanë filluar të largohen nga forumet dhe të fillojnë të hapin “llogari” në platformat e hapura mediatike në internet. Për shkak të kësaj tendence, YouTube ka shtuar një opsion për përdoruesit, të cilët tani mund të shënojnë materiale të caktuara të postuara si me përmbajtje terroriste.^[198]

Problemet dhe metodat për operacione të tilla bashkëpunimi të organeve të ndjekjes penale dhe këtyre kompanive duhet të trajtohen me një plan paraprak, fillimisht të përcaktohen të dhënat kompjuterike që mund t'u nevojiten autoriteteve gjyqësore gjatë procedurës penale; të shqyrtojë dhe të marrë informacion për llojin e të dhënave kompjuterike që mund të merren, ku ndodhen dhe si mund të sigurohen gjatë procedurës paraprake hetimore, sipas kornizës ligjore vendore ndërkombëtare, dhe së fundi, të nxjerrë metodën dhe procedurën që duhet të ndiqet gjatë sigurimit të të dhënave kompjuterike që mund të jenë prova potenciale në procedurë dhe të përgatiten formularët për paraqitjen e kërkesave për të dhëna nga operatorët vendas ose të huaj të shërbimeve të internetit.^[199]

Gjatë procedurës paraprake, sigurimi i të dhënave të nevojshme kompjuterike mund të jetë i pasigurt, kurse pasiguria lind nëse: Prokuroria Publike dhe policia nuk janë të sigurt nëse ekzistojnë të dhënat e kërkuara; nëse e njëjta do të jepet në bazë të procedurës së nisur dhe cili është afati real në të cilin mund të pritet që të dhënat e kërkuara të dorëzohen.

198. Në vitin 2009, Facebook ndërmori një veprim të ngjashëm, por më rigoroz për të eliminuar përmbajtjen terroriste, edhe nëse ajo ishte e mbyllur për akses nga publiku i gjerë. Ekstremistët reagues duke krijuar me shpejtësi profile të reja me emra të rinj. Ky është veçanërisht rasti me operacionin e indoktrinimit të rekrutëve të rinj nga ISIS. Shih artikullin: „Xhihadistët rekrutohen në internet“, Utrinski Vesnik, 30.08.2016.

199. Burimi: Stoilkovski/Cvetanovski, Op. cit., fq.5.

Për qëllime të hetimit penal, zakonisht është e nevojshme të sigurohen llojet e mëposhtme të të dhënave:

- “Të dhënat e abonuesit” - informacioni i identifikimit të përdoruesit të një protokolli specifik të Internetit (adresa IP) ose adresat IP të përdorura nga një person specifik;
- “Të dhënat e trafikut të internetit” - përfaqësojnë skedarët e regjistrimit (log) ku regjistrohen aktivitetet e sistemit operativ të një sistemi të caktuar kompjuterik ose të programeve të tjera ose të komunikimeve ndërmjet kompjuterëve, veçanërisht burimi dhe destinacioni i mesazheve.
- “Të dhënat e përmbajtjes” - Ky lloj përfshin mesazhe, imazhe, filma, muzikë, dokumente ose të dhëna të tjera. Ekziston një ndryshim midis përmbajtjes që ruhet, domethënë të dhënave që janë tashmë të disponueshme në një sistem kompjuterik, dhe përmbajtjes që duhet të ruhet në një periudhë të ardhshme, e cila nuk është ende e disponueshme dhe e cila do të duhet të merret në kohë reale.^[200]

Nga të gjitha operacionet dhe llojet e të dhënave të lartpërmendura, të dhënat e abonuesve janë të dhënat kompjuterike më të kërkuara në hetimet vendase dhe ndërkombëtare. Pa këtë informacion, shpesh është e pamundur të fillohet ose të vazhdohet një hetim, kështu që sigurimi i tij është i rëndësishëm vendimtar. Operatorët shumë shpesh (nëse jo gjithmonë) shfaqen në treg si persona juridikë të përbashkët, rrjeti i të cilëve që mbulon mundësinë e komunikimit elektronik është i madh dhe në shumicën e rasteve lidhet drejtpërdrejt me persona juridikë të huaj. Në atë moment, të dhënat duhet të kërkohen nga operatori i cili është caktuar të përdorë adresën IP që është me interes për procedurën dhe më pas të shkohet hap pas hapi duke kërkuar se ku dhe me cilën pajisje tjetër elektronike nga ajo adresë IP është komunikuar, që në fund për të arritur në vendin e kërkuar ku janë ruajtur ose transmetuar të dhënat.^[201]

Të dhënat e abonentëve zakonisht përpunohen dhe ruhen nga ofruesit e shërbimeve, respektivisht operatorët e shërbimeve të internetit që janë pjesë e sektorit privat, që do të thotë se të gjitha të dhënat duhet të kërkohen me

200. Njësoj, fq.11.

201. Koneska dhe të tjerë., Op. cit., fq.32.

kërkesë ose fletëthirrje (nëse adresuesi është jashtë vendit) të dorëzuar nga prokurori publik. Lëshimi i urdhrave të të dhënave shpesh mund të trajtohet si një kërcënim për të drejtat e njeriut dhe të drejtën e privatësisë, siç mund të bëhet kërkimi dhe sekuestrimi i sistemeve kompjuterike ose monitorimi i komunikimeve. Në këtë kontekst, Konventa Evropiane për Krimin Kibernetik e Këshillit të Evropës bën një dallim dhe miraton klasifikimin e mëposhtëm: të dhënat e abonentëve, të dhënat e trafikut të internetit dhe të dhënat e përmbajtjes.^[202]

Mbledhja e provave elektronike nga mbajtësit e huaj të pavarur të të dhënave mund të marrë shumë kohë dhe ekziston rreziku që në kohën kur marrësi i informacionit, që është ofruesi i shërbimit, të marrë kërkesën, sipas ligjit të tyre kombëtar të dhënat e kërkuara do të duhej tashmë të ishin fshirë. Ofruesit e shërbimeve të komunikimit, internetit dhe telefonisë nuk i ruajnë përgjithmonë të dhënat për trafikun e komunikimit dhe shpeshherë të dhëna të tilla nuk mbahen për më shumë se koha e nevojshme për të përmbushur detyrimet e pagesës ose detyrime të ngjashme.

Prokuroria Publike gjatë paraqitjes së kërkesës për dorëzimin e të dhënave kompjuterike mund t'i drejtohet drejtpërdrejt ofruesit vendas të shërbimit të internetit me një kërkesë në bazë të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale^[203] ose ta bëjë këtë me urdhër nëpërmjet Departamentit të krimeve kompjuterike dhe forenzikës digjitale pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Procesi i sigurimit të të dhënave nga operatorët e huaj të shërbimeve të internetit në përgjithësi përcaktohet nga protokollet dhe procedurat e operatorëve të huaj të shërbimeve të internetit për bashkëpunim me autoritetet e zbatimit të ligjit. Nëse lëvizja e të dhënave është brenda një shteti, atëherë është e lehtë sepse personat juridikë të vendit janë të detyruar t'ia japin të dhënat autoritetit që udhëheq procedurën, kurse për shkak të periudhës së shkurtër të zbulimit të komunikimit ndërmjet adresave IP, shanset për të marrë dhe rikuperuar të dhënat janë të larta. Gjithashtu, nëse bëhet fjalë për nevojën për të zbuluar pronësinë e një mediumi vendas online nga i cili është zhvilluar komunikimi, atëherë mjafton që autoriteti të kërkojë dhe marrë informacionin nga Marnet.^[204] Por fatkeqësisht këto janë raste të rralla sepse është mënyra më e rrallë e komunikimit ndërmjet adresave IP.

202. Stoilkovski/Cvetanovski, Op. cit., fq.12.

203. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut

204. <https://marnet.mk/>

Operatorët e shërbimeve të internetit që janë të regjistruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në përputhje me legjislacionin aktual për krimet më të rënda kanë autoritetin të bashkëpunojnë drejtpërdrejt me përfaqësuesit e autoriteteve të zbatimit të ligjit nga vendet e tjera dhe në të njëjtën kohë të ofrojnë të dhëna për përdoruesit e shërbimeve të tyre të internetit në lidhje me aktivitetet e përdoruesit, si dhe për përmbajtjet e krijuara nga përdoruesit e një shërbimi të caktuar. Bashkëpunimi ndërmjet këtyre operatorëve dhe autoriteteve të zbatimit të ligjit është mbi baza vullnetare, por duhet theksuar se çdo operao individualisht ka specifikat e tij të protokollit të cilat publikohen në formën e “procedurave” për sigurimin e të dhënave për qëllime të zbatimit të ligjit, për të cilat procedura më detajisht do të diskutohet më poshtë. Në fund, duhet pasur parasysh se hendeku institucional në trajtimin e gjuhës së urrejtjes është më i madhi nëse bëhet fjalë për ndërveprim ndërkombëtar mes subjekteve dhe institucioneve.

Për sa i përket eksperiencave të huaja, duhet thënë se ka edhe kompani ndërkombëtare që janë të specializuara në ruajtjen e të dhënave, por selitë e tyre janë në më shumë shtete, ndaj të dhënat shpërndahen në të gjithë botën në të ashtuquajturat “Clouds”. Në atë moment lind një problem serioz se ku mund të gjenden të dhënat, në çfarë mënyre dhe nga të merren ato dhe vallë do të ketë kohë që këto të dhëna të sigurohen gjatë fazës së hetimit. Përkatësisht, një numër i madh i subjekteve juridike, sipas legjislacionit të tyre kombëtar, i ruajnë të dhënat fillestare për një kohë shumë të shkurtër, që do të thotë se adresat IP dhe vendndodhja e tyre duhet të përcaktohet në një periudhë të shpejtë sepse një numër i madh legjislacionesh i detyrojnë personat e tyre juridikë që këto të dhëna ti ruajnë për një periudhë 6 mujore. Megjithatë, për fat të mirë, trendi europian, madje edhe ai botëror, tregon se legjislacionet po ndërgjegjësohen për këtë problem dhe po e zgjasin afatin e ruajtjes së adresave IP deri në dy vjet. Kjo ka të bëjë me iniciativat për të reformuar internetin për të mirë, siç është ajo e një prej shpikësve të internetit – inxhinierit anglez Tim Berners-Lee, i cili ofroi një kontratë, të cilën do të mund

ta nënshkruanin të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e internetit.^[205]

Si vend kandidat për anëtarësim në BE, qëndrimi i BE-së dhe bashkëpunimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me Bashkimin Evropian në këtë fushë është gjithashtu i rëndësishëm për ne.^[206] Sa i përket kompanive që drejtojnë rrjetet sociale, duhet thënë se kompanitë më të mëdha si: Facebook, Microsoft, Twitter dhe YouTube kanë lidhur një “Kod Marrëveshjeje” me BE-në në vitin 2016.^[207] Ndër të tjera, në të parafrazohet se: marrin përsipër të krijojnë një proces efektiv për shqyrtimin e njoftimeve që përmbajnë gjuhë urrejtjeje dhe brenda 24 orëve nga publikimi të heqin ose çaktivizojnë aksesin në to; Më tej, Kompanitë e TI-së bien dakord të zhvillojnë “Rregullat ose Udhëzimet e Komunitetit” që deklarojnë se promovimi i urrejtjes ose dhunës është i ndaluar; Ata gjithashtu marrin përsipër të marrin masa për edukimin e përdoruesve dhe zhvillimin e ndërgjegjësimit të tyre për të njohur përmbajtjen e gjuhës së urrejtjes; Të jenë të shpejtë sa i përket bashkëpunimit me autoritetet e drejtësisë të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian; Të bëjnë një trajnim të tillë të përshtatshëm për punonjësit e tyre; Të kenë parasysh ekzistimin e “gazetarëve të besuar” si burime të besueshme për vendosjen e informacionit dhe që të njëjtit të shpallin se bëhet fjalë për informacion të verifikuar etj.^[208]

Për sa i përket respektimit të këtyre angazhimeve nga kompanitë e TI-së, është bërë vlerësimi i katërt nga BE-ja në vitin 2019 dhe është konstatuar se ka progres; se deri në 89% të rasteve që janë shënuar si gjuhë urrejtjeje nga

205. Parimet për të cilat ai angazhohet janë: Qeveritë marrin përsipër të sigurojnë që të gjithë qytetarët të mund të lidhen me internetin, që ai të jetë i disponueshëm për ta gjatë gjithë kohës dhe se të drejtat themelore për privatësinë e të dhënave do të respektohen. Kompanitë që bëhen nënshkruese duhet të sigurojnë që interneti të jetë i aksesueshëm për të gjithë, të respektojnë privatësinë, të krijojnë një atmosferë besimi dhe të zhvillojnë teknologji që nxisin më të mirën tek njerëzit dhe luftimin e asaj që është e keqe në ta. Përdoruesit individualë angazhohen të jenë krijues dhe kontribues të përmbajtjes në faqe interneti, duke krijuar komunitete që respektojnë dinjitetin njerëzor dhe debatin e civilizuar. Burimi: <https://contractfortheweb.org/> (17.10.2020).

206. Kohët e fundit, Bashkimi Evropian ka sponsorizuar projekte që synojnë të luftojnë gjuhën e urrejtjes, bartë dhe implementues të të cilëve janë organizatat joqeveritare. I tillë është programi “Evropa për qytetarët 2014-2020”. Këto projekte duhet të ndihmojnë në destigmatizimin e emigrantëve dhe ndërtimin e dialogut ndërkulturor dhe mirëkuptimit të ndërsjellë. Iniciativa të tilla u bënë veçanërisht të zakonshme në BE pas fushatës #MeToo dhe protestave “Black Lives Matter”. Burimi: <https://www.politico.eu/article/commission-to-move-forward-with-european-hate-speech-plan/> (25,05,2023).

207. Shih më shumë në: CODE OF CONDUCT ON COUNTERING ILLEGAL HATE SPEECH ONLINE, http://ec.europa.eu/justice/fundamental-rights/files/hate_speech_code_of_conduct_en.pdf

208. https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_20_1135

kompanitë e TI-së janë rishikuar brenda 24 orëve. Nga rastet e raportuara të gjuhës ilegale të urrejtjes (4392 raporte për periudhën e monitoruar 6 mujore në fund të vitit 2018) në formë komentesh apo njoftimesh, janë hequr deri në 72%.^[209] Kritikat sigurisht që ekzistojnë, kështu që kritika kryesore është se i gjithë procesi paraqet autocensurë parandaluese në hapësirën digjitale dhe shtypje të lirisë së fjalës, si dhe faktin se është ende e paqartë se kush është gjyqtari përfundimtar i cili do të vlerësojë se çfarë përfaqëson gjuha e urrejtjes në internet. Lidhur me procedurën në të cilën kompanitë e TI-së ndalojnë apo fshijnë përmbajtjen e publikuar, ka kritika se e njëjta nuk është objekt ankimi apo kundërshtimi nga botuesit/publikuesit.^[210] Më në fund, në vitin 2022, hyri në fuqi një Rregullore e rëndësishme, për të cilën do të bëhet fjalë në tekstin e mëposhtëm.

Por edhe para Kodit dhe para Rregullores, në Bashkimin Evropian ka pasur një legjislacion që ka pasur efekt në drejtim të luftimit të gjuhës së urrejtjes, përkatësisht Direktiva e Bashkimit Evropian, 2000/31/EC për tregtinë elektronike, e cila në mënyrë efektive përjashtonte operatorët e internetit dhe rrjetet sociale nga çdo përgjegjësi për përmbajtjen që ata nuk e kanë miratuar, modifikuar, redaktuar ose autorizuar. Megjithatë, nëse ata janë të vetëdijshëm për përmbajtje të paligjshme të vendosura në shërbimet e tyre, kjo mbrojtje është e pavlefshme dhe ata kanë mundësinë të heqin një përmbajtje të tillë ose të përballen me mundësinë që të mbahen përgjegjës për çdo shkelje të mundshme në përputhje me legjislacionin kombëtar.^[211]

209. https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/MEMO_19_806 (25,05,2023).

210. Shih më shumë në: Chavleski, A., "European Union's response to hate speech: Recent developments", "Zbornik radova: Moć komunikacije 2017", p.25-26. https://apeiron-uni.eu/wp-content/uploads/2020/04/MOC-KOMUNIKACIJE-Zbornik-radova_2017.pdf

211. Milo, D., „Përmbledhje e kornizës ligjore, praktikës gjyqësore dhe mjeteve joligjore të përdorura në parandalimin e gjuhës së urrejtjes në internet“ , „16 NËNTORI dita ndërkombëtare...“, Op. cit., fq.23.

SIGURIMI I PROVAVE NGA OPERATORËT E SHËRBIMEVE TË INTERNETIT NGA SHBA-ja

Numri dominues i operatorëve të shërbimeve të internetit janë nga Shtetet e Bashkuara.^[212] Para së gjithash, këto janë: Facebook, Google, Yahoo dhe Microsoft. Në mënyrë që Facebook të dorëzojë të dhënat e nevojshme tek autoritetet ligjzbatuese, është e nevojshme të parashtrohet një kërkesë për ndihmë juridike ndërkombëtare ose një kërkesë nga një shërbim kompetent (nëse kërkuesi është një autoritet/institucion amerikan).^[213] Facebook publikon informacion mbi procedurat dhe mekanizmat për sigurimin e të dhënave kompjuterike në faqen e tij të internetit, së bashku me informacionin e përgjithshëm për numrin total të kërkesave të parashtruara nga secili vend.

Ekziston edhe mundësia e një kërkesë paraprake nga organet ligjzbatuese për mbajtjen e të dhënave nga Facebook. Në situatat kur kërkon një kohë të caktuar për të përpunuar procedurën formale ligjore nga shteti që kërkon të dhënat, Facebook mund të mbajë të dhënat e kërkuara kompjuterike. Një kërkesë (më shumë si një lutje) për të ruajtur të dhëna të caktuara deri në mbërritjen e dokumentacionit zyrtar ligjor mund të bëhet përmes një sistemi kërkesash online nga Zyra e Prokurorit Publik ose policia,^[214] përmes postës elektronike, faksit ose postës së rregullt. Periudha e ruajtjes së të dhënave

212. Ndonëse kohët e fundit është aktuale edhe shprehja “Cyber-Balkanizim”, që nënkupton fragmentizimin e internetit global në disa internete më të vogla, të administruara në nivel kombëtar, të ndarë sipas sferave të ndikimit gjeopolitik. Procesi po vazhdon në Federatën Ruse, RP të Kinës dhe Bashkimin Evropian. Shih: [https://medium.com/skycoin/cyberbalkanization-and-the-future-of-the-internets-f03f2b590c39#:~:text=Cyberbalkanization%20\(also%20termed%20'internet%20balkanization,internets%20aligned%20along%20geopolitical%20boundaries](https://medium.com/skycoin/cyberbalkanization-and-the-future-of-the-internets-f03f2b590c39#:~:text=Cyberbalkanization%20(also%20termed%20'internet%20balkanization,internets%20aligned%20along%20geopolitical%20boundaries).

213. Shih më shumë në: <https://mk.globalvoices.org/02/18/20277/>

214. Për shembull, në Maqedoni, Departamenti për Krimin Kompjuterik dhe Forenzikën Digjitale pranë SPSH-së së MPB-së, kërkoi, dhe u realizua, heqjen nga Facebook-u të grupeve që përhapnin urrejtje dhe bënin thirrje për dhunë në lidhje me konfliktin në Kala të vitit 2011. Me rastin e kësaj ngjarjeje, Ministria e Punëve të Brendshme bëri thirrje publike që të përmbahen nga gjuha e urrejtjes, për të cilën kanë marrë mirënjohje nga ECRI.

është maksimalisht 90 ditë.^[215]

“Në rastet që përfshijnë dëmtim të menjëhershëm të një fëmije ose rrezik vdekjeje ose lëndimi të rëndë trupor të çdo personi për të cilën kërkohet zbulim i menjëhershëm informacioni, pa vonesë, një oficer policie ose prokurori publik mund të bëjë një kërkesë përmes një sistemi të kërkesave online. Në praktikë, shpesh ndodh që përdoruesi të cilit i kërkohen të dhënat të mos njoftohet për kërkesën sepse njoftimi i tij mund të rrezikojë hetimin ose të çojë në rrezik të një forme tjetër. Në raste të tilla, Facebook duhet të marrë një vendim gjyqësor të përshtatshëm që kërkon që Facebook të mos njoftojë përdoruesin.”^[216] Sa i përket Facebook-ut, me anë të një lutjeje/kërkese nga një autoritet gjyqësor kompetent i huaj mund të dorëzohen: emri dhe mbiemri, informacioni i kartës së kreditit, informacione të tjera të llogarisë, titulli i plotë i mesazheve të dërguara dhe të marra, adresa e postës elektronike dhe adresat IP të fundit të hyrjeve/ daljeve, nëse të dhënat e kërkuara janë të disponueshme.^[217]

Në rastin e Google, për kërkesat nga vendet e huaja, duhet të përdoret Mekanizmi i ndihmës ligjore ndërkombëtare (MNLN). Megjithatë, përveç kësaj, në baza vullnetare, Google mund të ofrojë të dhëna të përdoruesit me kërkesë adekuate nga agjenci qeveritare joamerikane. Ky disponim i Google është një lloj arbitrariteti që është pasqyrim i faktit të diskutueshëm se Google mbledh të dhëna për përdoruesit e tij mbi baza të ndryshme dhe për motive të ndryshme që nuk janë domosdoshmërisht të natyrës altruiste. Për këto arsye, BE-ja në vitin 2019 nisi një procedurë për vlerësimin e punës së kompanisë Google,^[218] pas së cilës vendosi një gjolibë prej 50 milionë eurosh.^[219]

Kërkesat drejtuar Google nëpërmjet mekanizmit MNLN duhet të jenë në përputhje me normat ndërkombëtare, ligjin amerikan, politikat e Google dhe ligjin e vendit të origjinës së kërkesës. Të gjitha kërkesat për të dhënat e përmbajtjes duhet të dorëzohen në formë elektronike, dmth. përmes asistencës juridike ndërkombëtare (MLAT). Të dhënat e kompanisë mund të

215. <https://www.facebook.com/safety/groups/law/guidelines/>

216. Cit. Stoilkovski/Cvetanovski, Op. cit., fq.26-27.

217. Njësoj, fq.31.

218. <https://www.pravdiko.mk/eu-ke-proveruva-kako-fejsbuk-i-gugl-gi-koristat-podatotsite-nar-korisnitsite/>

219. https://edpb.europa.eu/news/national-news/2019/cnils-restricted-committee-imposes-financial-penalty-50-million-euros_en (23,05,2023).

merren gjithashtu nëse kryhen hetime të përbashkëta midis autoriteteve të zbatimit të ligjit në SHBA dhe ato kombëtare ose nëse kërkesat u referohen rasteve urgjente.

Kompania Google publikon informacion mbi procedurat dhe mekanizmat për sigurimin e të dhënave kompjuterike në faqen e saj të internetit së bashku me informacionin e përgjithshëm për numrin total të kërkesave të parashtuara nga secili vend veç e veç. Sipas një parimi të ngjashëm me operatorët e tjerë të huaj të internetit, Google nuk përpunon kërkesa shumë të përgjithësuara ose të paqarta.^[220] Kërkesat duhet të jenë me shkrim dhe të nënshkruara nga një zyrtar i autorizuar i kërkuesit. Mund të kërkohen gjithashtu të dhëna në formën e një videoje ose një lloj tjetër materiali të publikuar në: YouTube, Web Search dhe Blogger. Në faqen e Google çdo 6 muaj publikohet “Raporti i Google për transparencën”, në të cilin ofrohen të dhëna: për numrin e kërkesave, nga vijnë dhe cila është natyra e tyre, ndërsa e njëjta tregohet mirë e pasqyruar dhe me diagrame.^[221]

Sa i përket Microsoft-it, ekziston gjithashtu një procedurë për zbatimin e kërkesave nga autoritetet e zbatimit të ligjit, e cila është e shpallur publikisht.^[222] Një parim i rëndësishëm të cilit i përmbahet Microsoft është se ai refuzon të bashkëpunojë me autoritetin shtetëror kërkues nëse bëhet fjalë për të kërkuar akses të drejtpërdrejtë ose të papenguar të atij autoriteti në të dhënat e përdoruesit, si dhe nëse “çelësat” për enkriptimin ose mundësinë e thyerjes së enkriptimit. Të gjitha kërkesat duhet të lidhen në mënyrë specifike me llogari ose identitete specifike. Parimet, politikat dhe praktikat e përmbajtura në këtë dokument zbatohen edhe për Skype.^[223] Sipas procedurës Microsoft për të dhënat e kërkuara kërkon një urdhër gjykatë ose dokument tjetër ekuivalent të nënshkruar zyrtarisht në varësi të llojit të të dhënave të kërkuara. Microsoft siguron lloje të ndryshme të dhënash për kërkuesit në SHBA dhe ata nga vende të tjera. Kërkesat duhet t'i drejtohen drejtpërdrejt zyrës së tyre në Irlandë. Kërkesat për të dhëna që arrijnë në Microsoft nga vende jo anglishtfolëse i dërgohen një ekipi ose individit lokal (zakonisht një avokat ose dikush që punon sipas udhëzimeve ligjore) për të përcaktuar pajtueshmërinë me ligjet lokale, në të cilin rast kërkesa do të

220. Stoilkovski/Cvetanovski, Op. cit., fq.28-29.

221. <https://transparencyreport.google.com/government-removals/overview>

222. <https://blogs.microsoft.com/datalaw/our-practices/>

223. Skype është tërësisht në pronësi të Microsoft.

përkthehet dhe do t'i dërgohet ekipeve të Microsoft në SHBA ose Irlandë.^[224]

Ashtu si Google, edhe Microsoft publikon raporte të detajuara gjysmë-vjetore mbi të dhënat kompjuterike të ofruara autoriteteve të ndryshme qeveritare.^[225] Microsoft bën një dallim të qartë midis të dhënave që paraqesin përmbajtje dhe atyre pa përmbajtje. “Në procedurën e lartpërmendur nuk janë të përcaktuara konkretisht kushtet për trajtimin e kërkesave urgjente. Por dokumenti thotë se Microsoft mund t’u japë informacion të kufizuar për përdoruesit autoriteteve të zbatimit të ligjit, domethënë, ai ofron vetëm informacione për të cilat vetë ofruesi ka arsye të besojë se përdoruesi synon të dëmtojë veten ose dikë tjetër duke publikuar publikisht të njëjtin informacion. Kërkesat që nuk janë dorëzuar siç duhet ose janë shumë të përgjithshme refuzohen si nga Microsoft ashtu edhe nga Skype.”^[226]

Firma amerikane Yahoo gjithashtu bashkëpunon me autoritetet ligjzbatuese të vendeve të huaja. Për kërkesën për sigurimin e të dhënave kompjuterike kryhet një procedurë për ndihmë juridike ndërkombëtare, por në raste të jashtëzakonshme, nëse është emergjente (p.sh.: rrëmbim ose kërcënime të menjëhershme me bombë) është i mundur edhe bashkëpunimi i drejtpërdrejtë. Kompania Yahoo jo gjithmonë i ofron të dhënat e kërkuara. Nëse ata konsiderojnë se vëllimi i të dhënave është i madh ose të dhënat nuk mund të ndihmojnë në procedurë, atëherë sipas politikave të tyre nuk mund t’i përgjigjen kërkesës ose të japin vetëm pjesërisht të dhëna.^[227] Për kërkesat e drejtpërdrejta nga jashtë (që do të thotë jo nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës) mund të sigurohen të dhënat bazë të parapaguesve. Kjo procedurë është e njëjtë edhe për Flickr.^[228]

Sa për krahasim, Google mund të ruajë gjithashtu të dhëna bazë pas kërkesave të tilla të drejtpërdrejta. Kërkohet një kërkesë formale e dërguar përmes emailit. Google do të ruajë të dhënat e kërkuara deri në mbërritjen e kërkesës zyrtare përmes procedurës për ndihmë juridike ndërkombëtare. Microsoft, megjithatë, mund të mbajë të dhëna bazuar në kërkesat e marra drejtpërdrejt nga autoritetet e huaja të zbatimit të ligjit dhe kërkon që

224. Stoilkovski/Cvetanovski, Op. cit., fq.30.

225. <https://www.microsoft.com/en-us/corporate-responsibility/law-enforcement-requests-report>

226. Cit. Stoilkovski/Cvetanovski, Op. cit., fq.29-30.

227. Njësoj, fq.30-31.

228. https://www.eff.org/files/filenode/social_network/yahoo_sn_leg-doj.pdf (16.10.2020)

paraprkisht të dërgohet me faks një shkresë e nënshkruar. Microsoft mund të ruajë të dhënat për një periudhë prej 180 ditësh dhe, përveç kësaj, për një periudhë prej 90 ditësh, deri në mbërritjen e një kërkesë zyrtare përmes procedurës për ndihmë juridike ndërkombëtare. Është njësoj si në Microsoft ashtu edhe në Yahoo.^[229]

Por përveç kërkesave të drejtpërdrejta, ka edhe raste urgjente. Prandaj, në raste urgjente, duke përfshirë lëndimin e menjëhershëm të një fëmije ose rrezikun e vdekjes ose lëndimit të rëndë fizik të ndonjë personi, Facebook do t'i japë pa vonesë të dhëna një zyrtari të autorizuar të zbatimit të ligjit. Kërkesat duhet të dorëzohen përmes sistemit online për marrjen e kërkesave nga autoritetet ligjzbatuese në: <https://www.facebook.com/records/x/login/> ose përmes postës elektronike (email). Ky konstelacion vlen edhe për Google, Microsoft dhe Yahoo, por për ta, kërkesat për raste urgjente duhet të përmbajnë një përshkrim të arsyes së urgjencës dhe një shpjegim se si informacioni i kërkuar mund të parandalojë dëmtimin, duke pasur parasysh se kërkesat për Yahoo dhe Microsoft duhet të jetë me shkrim dhe të nënshkuara nga një zyrtar i autorizuar i institucionit/autoritetit. Yahoo dhe Google janë të prirur të ndajnë vetëm informacionin që ata besojnë se është i nevojshëm për të parandaluar një emergjencë të jashtëzakonshme.^[230] Veprimet janë të ngjashme edhe në raport me Twitter-in^[231], por i cili rrjet social tani ka kritika serioze se nuk është objektiv në qasjen dhe njohjen e gjuhës së urrejtjes, e gjithë kjo pas ndryshimit të strukturëpronësore të Twitter, kështu që tani pronarë janë miliarderi Elon Musk (i cili e quan veten “absolutist i lirisë së shprehjes”)^[232] dhe Mbretëria e Arabisë Saudite,^[233] e cila nuk është një shtet me imazhin e mbështetjes së lirisë së fjalës, duke pasur parasysh legjislacionin e saj për veprën penale - blasfemi dhe skandalin e vitit 2018 me vrasjen tinëzare të gazetarit Jamal Khashoggi në Ambasadën e Mbretërisë në Stamboll të Republikës së Turqisë^[234].

Së fundi, ka situata të paparashikuara për shkak të kompleksitetit të

229. Stoilkovski/Cvetanovski, Op. cit., fq.33.

230. Njësoj, fq.34.

231. <https://help.twitter.com/en/rules-and-policies/enforcement-options>

232. Burimi: Punim i Xhakoviq, T., „Rregullimi dhe lufta kundër gjuhës së urrejtjes në Bashkimin Evropian dhe në Kroaci – një qasje nga pozita e të drejtave të njeriut?“, Rishikimi vjetor i sundimit të ligjit në BE, Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 2022, fq.38. E disponueshme në: <https://epi.org.mk/post/23042> (25,05,2023).

233. <https://biz.crast.net/alarm-on-capitol-hill-over-saudi-investment-in-twitter/> (23,05,2023).

234. E disponueshme në: <https://www.bbc.com/news/world-europe-45812399>

marrëdhëniet ndërkombëtare, kur kompanitë e mëdha janë “humbur në përkthim” në marrëdhëniet me autoritetet e disa shteteve më të vogla si Maqedonia e Veriut, kështu që për arsye misterioze, në vitin 2018, pati një moratorium pothuajse gjatë gjithë vitit sa i përket bashkëpunimit mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe kompanisë Facebook, kështu që prokuroria publike është penguar të marrë të dhëna në lidhje me rrjetet sociale Facebook dhe Instagram.

Praktika e Prokurorisë Publike 2 vite më parë në Republikën e Maqedonisë së Veriut është që Prokuroria Publike, Prokurorisë Themelore Publike, në rast se ndeshet me nevojën e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale, i drejtohet departamentit të specializuar për ndihmë juridike ndërkombëtare të Prokurorisë Publike të Maqedonisë së Veriut, dhe jo drejtpërdrejt kompanive - operatorëve dhe kompanive të hostingut në shtetet e huaja. Departamenti është themeluar në janar të vitit 2021 me qëllim të përmirësimit, standardizimit dhe përshejtimit të procedurës për kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare. Tani ky departament kalon kërkesat apo lutjet në Ministrinë e Drejtësisë, ku ato i përcillen në mënyrë elektronike ministrive të drejtësisë të vendeve përkatëse (sidomos në Shtetet e Bashkuara, ku ndodhet numri më i madh i operatorëve të internetit dhe kompanive hosting) dhe prej andej, në një afat relativisht të shpejtë, vjen përgjigja nga kompanitë për të dhënat e kërkuara. Ekziston edhe një alternativë në rastin kur bëhet fjalë për shtetet me të cilat Ministria e Punëve të Brendshme e RMV-së ka krijuar bashkëpunim ndërpolicor, kështu që departamenti për bashkëpunim ndërkombëtar i PPR-së ia parashton kërkesën Ministrisë së Punëve të Brendshme prej nga ku pritet edhe përgjigja, por praktika ka treguar se kjo rrugë është më e gjatë dhe ndoshta dhe për arsye se korrespondenca nuk bëhet ekskluzivisht me mjete elektronike, por me dërgesa me shkrim, respektivisht me postë të rregullt. Në fakt, nevoja për të pasur një përgjigje në një dokument “hard-copy” duhet të theksohet në kontaktin fillestar në lidhje me çështjen në çdo rast dhe pavarësisht nga qasja që ka zgjedhur Prokuroria Publike.

RUAJTJA E TË DHËNAVE

U përmend më parë se vendet e BE-së në *acquis communautaire* kanë parashikuar tashmë propozime për afatet kohore deri në të cilat ata mund të kërkojnë nga operatorët të mbajnë informacionin e tyre digjital që më pas do të përdorej si provë, por një dispozitë e tillë është edhe neni 16 i Konventës Evropiane për Krimin Kibernetik e cila u mundëson shteteve anëtare të kërkojnë ruajtjen e të dhënave kompjuterike, si p.sh.: përmbajtja e llogarisë së e-mailit, edhe para marrjes së autorizimit ligjor për shkëmbimin e të dhënave. Neni 17 për të dhënat e trafikut të internetit gjithashtu lejon zbulimin e pjesëshëm të informacionit në mënyrë të përsheptuar. Një vend i caktuar mund t'i kërkojë një anëtar tjetër të ruajë të dhënat përmes “rrjetit të kontaktit” i cili, siç u tha, funksionon 24/7.

Rekomandohet që kur bëhet një kërkesë për mbajtjen e të dhënave, agjencia kërkuuese e zbatimit të ligjit të kërkojë konfirmimin se të dhënat janë ruajtur dhe t'i jepet një numër reference për të dhënat e ruajtura. Megjithatë, sipas Konventës Evropiane për Krimin Kibernetik, sa i përket kërkesave për ruajtjen e të dhënave nuk është e detyrueshme përdorimi i rrjetit të kontaktit 24/7. Nëse ligji procedural kombëtar e lejon këtë, bashkëpunimi i drejtpërdrejtë midis operatorëve dhe autoriteteve të zbatimit të ligjit është gjithashtu i mundur. Potencialisht, “bashkëpunimi i drejtpërdrejtë midis këtyre dy subjekteve në lidhje me kërkesat e ruajtjes së të dhënave, në vend të një rrjeti 24/7, i cili është më shumë me karakter plotësues, është shpesh një zgjidhje më fleksibël sesa pikat formale të kontaktit të parashikuara të Konventës...”^[235]

MASAT DHE POLITIKAT E TJERA PËR LUFTIMIN E GJUHËS SË

235. Citim: Stoilkovski/Cvetanovski, Op. cit., fq.36.

URREJTJES NË INTERNET

Masat dhe politikat për të parandaluar gjuhën e urrejtjes në internet janë thelbësore. Përndryshe, si pasojë e mungesës së përgjigjes nga organet e rendit dhe incensisë së tyre, viktimat mund të hakmerret, me sulm ndaj autorit në hapësirën virtuale, kështu që viktimat do të ndjejë pak “lehtësim”, por përgjigja e viktimës ka të ngjarë të shihet nga një audiencë e tërë e njohur paraprakisht me mesazhet fyese në internet, kurse viktimat do të vazhdojnë të vuajë ankth mendor. Në fund të fundit, sjellja destruktive nuk mund të jetë një përgjigje ndaj një sjelljeje tjetër të tillë.

Së fundmi, si pasojë e keqpërdorimeve të shumta në sferën e mediave online në Maqedoni, bëhet thirrje për të ashtuquajturin “rregullim të portaleve”. Standardet dhe praktikatat botërore dhe publiku profesionist^[236], nga ana tjetër, thonë të kundërtën – se rregullimi i përmbajtjes së mediave online është i pamundur dhe i panevojshëm. Është e nevojshme vetëm që ligjet ekzistuese të zbatohen me përgjegjësi.

Megjithatë, është evidente se ekzistojnë probleme – sfera maqedonase online është e vërshuar me ueb faqe informative që prezantohen si media. Nuk mungojnë gjuha e urrejtjes, diskriminimi, shpifja, fyerjet, skualifikimet. Zgjidhja, ndonëse e papërsosur, ende qëndron te vetërregullimi, jo te rregullimi. Dallimi themelor ndërmjet përmbajtjes mediatike dhe informimit të qytetarëve duhet të bëhet, veçanërisht i përfaqësuar në rrjetet sociale dhe blogjet, por specifike për Maqedoninë dhe me faqe interneti që prezantohen si media dhe që nuk përmbushin as standardet minimale. Për shkak të

236. Shih më shumë në: Publikim elektronik: „ Liria e medias kundrejt presioneve dhe propagandës politike, dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes: Si të vepohet?“, tekst i Milladen Çadikovskit, Burimi: [104](https://ima.mk/wp-content/uploads/2023/05/%D0%A1%D0%BB%D0%BE%D0%B1%D0%BE%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%BC%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%83%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%BD%D0%B0%D1%81%D0%BF%D1%80%D0%BE%D1%82%D0%B8-%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D0%B8%D1%82%D0%B8%D1%87%D0%BA%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%BF%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B8%D1%81%D0%BE%D1%86%D0%B8-%D0%B8-%D0%BF%D1%80%D0%BE%D0%BF%D0%B0%D0%B3%D0%B0%D0%BD%D0%B4%D0%B0-%D0%B4%D0%B5%D0%B7%D0%B8%D0%BD%D1%84%D0%BE%D1%80%D0%BC%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B8-%D0%B3%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%80%D0%BE%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%BE%D0%BC%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%B0-%D0%9A%D0%B0%D0%BA%D0%BE-%D0%BF%D0%BE%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%B0%D0%BC%D1%83.pdf (21.05.2023)</p></div><div data-bbox=)

faktit se rregullimi shtetëror i përmbajtjes së mediave online nuk është as i dëshirueshëm, as teknikisht dhe as ligjërisht i mbështetur dhe në një gjendje me keqpërdorime të shumta, është e nevojshme të shtohen përpjekjet në drejtim të vetërregullimit, dhe ky proces në Maqedoni tashmë ka filluar me krijimin e Regjistrit profesional të mediave online të përmendur më parë. Organet vetërregulluese përcaktojnë kufijtë midis të drejtave legjitime të medias së lirë dhe të drejtave legjitime të njerëzve që tërheqin vëmendjen e medias.^[237] Organ vetërregullues në Maqedoni është Këshilli i Etikës në Media në Maqedoni (KEMM) si dhe Gjykata e Nderit në SHGM, të cilat tashmë janë përmendur më parë. Gjykata e Nderit trajton ankesat e qytetarëve kundër sjelljes joetike të një gazetari të caktuar. Këto dy organe janë mbështetës të “vetërregullimit” të sipërpërmendur të mediave online.

